



Republika e Shqipërisë  
Ministria e Integritimit



# Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

## Fjalorth i Termave Kryesorë



Federal Ministry  
for Economic Cooperation  
and Development

**gtz**

Projekt i financuar nga Bashkimi Europian  
(IPA 2008) dhe Qeveria Gjermane

Mbështetje për Ministrinë e Integritimit Europian - SMEI II



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INTEGRIMIT

**MARRËVESHJA E  
STABILIZIM ASOCIIMIT**  
**FJALORTH I TERMAVE KRYESORË**

TIRANË, PRILL 2010

<i>Botim i:</i>	Ministrisë së Integrimit
<i>Kontribuan:</i>	Stafi i Ministrisë së Integrimit. Koordinatore: Elda Kalaja, MA
<i>Ekspert Ligjor:</i>	Prof. As. Dr. Xhezair Zaganjori
<i>Përgatiti për botim:</i>	Blerina Raça, MBA
<i>Ky botim u mundësua me mbështetjen financiare të:</i>	Bashkimit European (IPA 2008) dhe Qeverisë Gjermane në kuadër të Projektit të GTZ “Mbështetje për Ministrinë e Integrimit European - SMEI II”
<i>Përpunimi Grafik:</i>	Erald Lamja, Vignette Marketing Agency

*Mospranim i përgjegjesisë:*

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të  
Bashkimit European

## **PËRMBAJTJA:**

<b>I.</b>	<b>L I G J Nr. 9590, datë 27.7.2006 PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETEVE EUROPIANE E SHTETEVE TË TYRE ANËTARE” .....</b>	<b>5</b>
<b>II.</b>	<b>TERMAT KRYESORË TË “MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT” .....</b>	<b>53</b>
<b>III.</b>	<b>FJALORTH I “MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT” (SHQIP - ANGLISHT) .....</b>	<b>97</b>
<b>IV.</b>	<b>FJALORTH I “MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT” (ANGLISHT - SHQIP) .....</b>	<b>129</b>



**L I G J**  
**Nr. 9590, datë 27.7.2006**

**PËR RATIFIKIMIN E**  
**“MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT**  
**NDËRMJET**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETEVE EUROPIANE**  
**E SHTETEVE TË TYRE ANËTARE”**



**L I G J\*****Nr. 9590, datë 27.7.2006****PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETEVE  
EUROPIANE E SHTETEVE TË TYRE ANËTARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****V E N D O S I:****Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 5010, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT  
NDËRMJET KOMUNITETEVE EUROPIANE E SHTETEVE TË TYRE ANËTARE  
DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

MBRETËRIA E BELGJIKËS,  
REPUBLIKA ÇEKE,  
MBRETËRIA E DANIMARKËS,  
REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISË,  
REPUBLIKA E ESTONISË,  
REPUBLIKA HELENE,  
MBRETËRIA E SPANJËS,  
REPUBLIKA E FRANCËS,  
IRLANDA,  
REPUBLIKA E ITALISË,  
REPUBLIKA E QIPROS,  
REPUBLIKA E LETONISË,  
REPUBLIKA E LITUANISË,

---

\*Shënim: Shpjegimi i termave të numëruar në tekstin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit jepet në Pjesën e dytë: “Termat Kryesorë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit”, fq. 53



DUKATI I MADH I LUKSEMBURGUT,  
 REPUBLIKA E HUNGARISË,  
 REPUBLIKA E MALTËS,  
 MBRETËRIA E HOLLANDËS,  
 REPUBLIKA E AUSTRISË,  
 REPUBLIKA E POLONISË,  
 REPUBLIKA E PORTUGALISË,  
 REPUBLIKA E SLLOVENISË,  
 REPUBLIKA SLLOVAKE,  
 REPUBLIKA E FINLANDËS,  
 MBRETËRIA E SUEDISË,  
 MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT,  
 Palët kontraktuese të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe të Traktatit themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Atomike, si dhe të Traktatit të Bashkimit Europian, referuar më poshtë si “Shtete Anëtare”,

dhe

KOMUNITETI EUROPIAN<sup>1</sup>, KOMUNITETI EUROPIAN I ENERGJISË ATOMIKE,  
 referuar më poshtë si “Komuniteti”,

nga njëra anë, dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË, referuar më poshtë si “Shqipëria”,

nga ana tjetër,

DUKE MARRË PARASYSH lidhjet e forta ndërmjet Palëve dhe vlerat që i bashkojnë, dëshirën e tyre për të forcuar këto lidhje dhe për të vendosur marrëdhënie të ngushta e të qëndrueshme, bazuar në reciprocitet dhe interesat e ndërsjellë, të cilat duhet t’i japin mundësinë Shqipërisë të forcojë dhe zgjerojë më tej marrëdhëniet – të vendosura më parë me Komunitetin nëpërmjet Marrëveshjes mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar e Ekonomik të vitit 1992 – me Komunitetin dhe Shtetet e tij Anëtare;

DUKE MARRË PARASYSH rëndësinë e kësaj Marrëveshjeje në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit me vendet e Europës juglindore, për vendosjen dhe konsolidimin e një rendi të qëndrueshëm europian bazuar në bashkëpunim, për të cilin Bashkimi Europian është një shtyllë kryesore, si dhe në kuadër të Paktit të Stabilitetit<sup>2</sup>;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të kontribuar me të gjitha mënyrat për stabilizimin politik, ekonomik e institucional të Shqipërisë dhe rajonit, nëpërmjet zhvillimit të shoqërisë civile<sup>3</sup> dhe demokratizimit, ndërtimit të institucioneve dhe reformës së administratës publike, integritit në tregtinë rajonale dhe rritjes së bashkëpunimit ekonomik, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit në një gamë të gjerë fushash, veçanërisht në drejtësi dhe çështjet e brendshme dhe në forcimin e sigurisë kombëtare dhe rajonale;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për rritjen e lirive politike e ekonomike që janë bazat themelore të kësaj marrëveshjeje, si dhe angazhimin e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut<sup>4</sup> dhe shtetin e së drejtës, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare, si dhe parimet demokratike nëpërmjet një sistemi shumëpartiak me zgjedhje të lira e të ndershme<sup>5</sup>;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të zbatuar plotësisht të gjitha parimet dhe dispozitat e Kushtetutës së OKB-së, të OSBE-së, veçanërisht ato të Aktit Final të Helsinkit, dokumentet përfundimtare të Konferencave të Madridit dhe Vjenës, Kartën e Parisit për një Europë të Re, dhe të Paktit të Stabilitetit për Europën juglindore, në mënyrë që të kontribuojnë në stabilitetin rajonal dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve ndaj parimeve të ekonomisë së tregut të lirë dhe gatishmërinë e Komunitetit për të kontribuar për reformat ekonomike në Shqipëri;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve ndaj tregtisë së lirë, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga OBT-ja;

DUKE MARRË PARASYSH dëshirën e Palëve për të zhvilluar më tej një dialog politik të rregullt për çështje dypalëshe dhe ndërkombëtare me interes të ndërsjellë, përfshirë aspektet rajonale, duke pasur parasysh Politikën e Jashmte dhe e Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Europian;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të luftuar krimin e organizuar dhe për të forcuar bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit në bazë të deklaratës së nxjerrë nga Konferenca Europiane më 20 tetor 2001;

ME BINDJEN që Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit krijon një klimë të re për marrëdhëniet ekonomike ndërmjet tyre dhe, mbi të gjitha, për zhvillimin e tregtisë dhe investimeve, që janë faktorë kryesorë për modernizimin dhe ristrukturimin ekonomik;

DUKE RIKUJTUAR angazhimin e Shqipërisë për të përafuar legjislacionin në sektorët përkatës me atë të Komunitetit dhe për ta zbatuar atë me efektivitet;

DUKE MARRË PARASYSH gatishmërinë e Komunitetit për të dhënë një mbështetje vendimtare për zbatimin e reformave dhe për të përdorur për këtë qëllim të gjitha instrumentet e disponueshme të bashkëpunimit dhe asistencës teknike, financiare e ekonomike mbi një bazë gjithëpërfshirëse shumëvjeçare për këtë përpjekje;

DUKE KONFIRMUAR që dispozitat e kësaj Marrëveshjeje që përfshihen në fushën e veprimit të Pjesës III, Titulli IV të Traktatit themelues të Komunitetit Europian e angazhojnë Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën si Palë Kontraktuese të veçanta, dhe jo si pjesë të Komunitetit Europian, derisa Mbretëria e Bashkuar ose Irlanda (sipas rastit) të njoftojë Shqipërinë se është angazhuar si pjesë e Komunitetit Europian në përputhje me Protokollin mbi pozicionin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës, i aneksuar Traktatit të Bashkimit Europian<sup>6</sup> dhe Traktatit themelues të Komunitetit Europian. E njëjta gjë zbatohet edhe për Danimarkën, në përputhje me Protokollin mbi pozicionin e Danimarkës i aneksuar këtyre Traktateve;

DUKE RIKUJTUAR Samitin e Zagrebit, që bëri thirrje për konsolidim të mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet vendeve të Procesit të Stabilizim-Asociimit dhe Bashkimit Europian, dhe për rritjen e bashkëpunimit rajonal;

DUKE RIKUJTUAR që Samiti i Selanikut e përforcoi Procesin e Stabilizim-Asociimit si një kuadër politikash të Bashkimit Europian në marrëdhëniet me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe nënvizoi perspektivën e integritetit të tyre në Bashkimin Europian në bazë të përparimit të reformave dhe meritave individuale;

DUKE RIKUJTUAR Memorandumin e Mirëkuptimit për Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë, nënshkruar në Bruksel më 27 qershor 2001, nëpërmjet të cilit Shqipëria, së bashku me vende të tjera të rajonit, u angazhua të negociojë një rrjet Marrëveshjesh dypalëshe për Tregtinë e Lirë, me qëllim rritjen e aftësisë së rajonit për të tërhequr investime dhe të perspektivës së integritetit të tij në ekonominë globale;

DUKE RIKUJTUAR gatishmërinë e Bashkimit European për ta integruar Shqipërinë sa më plotësisht të jetë e mundur në rrjedhën e përgjithshme politike dhe ekonomike të Europës, si dhe statusin e saj si kandidat i mundshëm për anëtarësimin në BE në bazë të Traktatit të Bashkimit European dhe plotësimin e kriterëve të përcaktuara nga Këshilli European<sup>7</sup> në qershor të vitit 1993, që janë kusht për zbatimin me sukses të kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht për sa i përket bashkëpunimit rajonal,

BIEN DAKORD SI VIJON:

#### NENI 1

1. Në këtë mënyrë është vendosur një Asociim<sup>8</sup> ndërmjet Komunitetit dhe Shteteve të tij Anëtare<sup>9</sup>, nga njëra anë, dhe Shqipërisë, nga ana tjetër.
2. Synimet e këtij Asociimi janë:
  - të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për forcimin e demokracisë<sup>10</sup> dhe shtetin e së drejtës<sup>11</sup>;
  - dhënia e kontributit për stabilitetin politik, ekonomik e institucional në Shqipëri, si dhe për stabilizimin e rajonit;
  - të sigurojë një strukturë të përshtatshëm për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve;
  - të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, gjithashtu dhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit<sup>12</sup> të saj me atë të Komunitetit;
  - të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi tregu funksionale, të nxisë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë;
  - të nxisë bashkëpunimin rajonal<sup>13</sup> në të gjitha fushat të trajtuara në këtë Marrëveshjeje.

### TITULLI I

#### PARIME TË PËRGJITHSHME

##### NENI 2

Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut<sup>14</sup> dhe siç janë përkufizuar në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut<sup>15</sup>, në Aktin Final të Helsinkit<sup>16</sup> dhe në Kartën e Parisit për një Europë të Re<sup>17</sup>, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, ato të shtetit të së drejtës si edhe për parimet e ekonomisë së tregut, siç pasqyrohen në Dokumentin e Konferencës së Bonit të KSBE-së për Bashkëpunimin Ekonomik<sup>18</sup>, formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të Palëve dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj Marrëveshjeje.

##### NENI 3

Shqipëria angazhohet të vazhdojë dhe të nxisë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e tjera të rajonit, duke përfshirë një nivel të përshtatshëm konçesionesh të ndërsjella lidhur me lëvizjen e personave<sup>19</sup>, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, veçanërisht të atyre që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar<sup>20</sup>, korrupsionit<sup>21</sup>, pastrimit të parave<sup>22</sup>, emigrimit të paligjshëm dhe

trafikimit<sup>23</sup>, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore dhe të drogave të paligjshme. Ky angazhim përbën një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Palëve, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal.

#### NENI 4

Shqipëria angazhohet të vazhdojë dhe të nxisë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e tjera të rajonit, duke përfshirë një nivel të përshtatshëm konçesionesh të ndërsjella lidhur me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, veçanërisht të atyre që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore dhe të drogave të paligjshme. Ky angazhim përbën një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Palëve, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajona.

#### NENI 5

Palët pohojnë edhe njëherë rëndësinë që i japin luftës kundër terrorizmit<sup>24</sup> dhe zbatimit të detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë.

#### NENI 6

Asociimi zbatohet në mënyrë progresive dhe realizohet plotësisht gjatë një periudhe tranzitore deri në dhjetë vjet maksimumi, e ndarë në dy faza të njëpasnjëshme.

Dy fazat nuk janë të aplikueshme nën Titullin IV të kësaj Marrëveshjeje (Lëvizja e Lirë e Mallrave), për të cilin në atë Titull të Marrëveshjes përcaktohet një kalendar specifik.

Qëllimi i kësaj ndarjeje në faza të njëpasnjëshme është që të bëhet një rishikim i hollësishëm afatmesëm i zbatimit të Marrëveshjes. Në fushën e përafrimit dhe zbatimit të ligjeve<sup>25</sup>, synimi është që Shqipëria të përqendrohet gjatë fazës së parë në elementët themelorë të acquis<sup>26</sup>, me tregues specifikë, ashtu siç përshkruhet në Titullin VI të kësaj Marrëveshjeje.

Këshilli i Stabilizim-Asociimit i krijuar sipas nenit 116 do të shqyrtojë rregullisht zbatimin e Marrëveshjes dhe realizimin e reformave ligjore, administrative, institucionale dhe ekonomike nga ana e Shqipërisë, duke marrë parasysh çfarë është thënë më sipër dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të parashtruara në këtë Marrëveshje.

Faza e parë fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Gjatë vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Këshilli i Stabilizim-Asociimit<sup>27</sup> do të vlerësojë përparimin e bërë nga Shqipëria, dhe do të vendosë nëse ky përparim ka qenë i mjaftueshëm për kalimin në fazën e dytë në mënyrë që të arritjë asociimin e plotë. Ai do të vendosë gjithashtu edhe për dispozitat të veçanta që konsiderohen të nevojshme për t'u zbatuar në fazën e dytë.

#### NENI 7

Marrëveshja duhet të përputhet plotësisht dhe zbatohet në përputhje me dispozitat përkatëse të OBT-së<sup>28</sup>, në veçanti Nenin XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë për Shërbime (GATS)<sup>29</sup> 1994 dhe Nenin V të GATS.

## TITULLI II

## DIALOGU POLITIK

## NENI 8

1. Dialogu politik ndërmjet Palëve zhvillohet më tej brenda kontekstit të kësaj Marrëveshjeje. Ai do të shoqërojë dhe konsolidojë marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit Europian dhe Shqipërisë dhe kontribuojë në vendosjen e lidhjeve të ngushta të solidaritetit dhe formave të reja të bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

2. Dialogu politik ka për qëllim të nxisë veçanërisht:

- integrimin e plotë të Shqipërisë në bashkësinë e kombeve demokratike dhe afrimin gradual me Bashkimin Europian;
- një përputhje në rritje e pozicionimeve të Palëve për çështjet ndërkombëtare, gjithashtu nëpërmjet shkëmbimit të duhur të informacionit, dhe në veçanti, lidhur me ato çështje që pritet të kenë efekte të ndjeshme mbi Palët;
- bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë;
- pikëpamje të përbashkëta për sigurinë dhe stabilitetin në Europë, duke përfshirë dhe bashkëpunimin në fushat që mbulohen nga Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët e Bashkimit Europian<sup>30</sup>.

3. Palët vlersojnë që armëve të shkatërrimit në masë (ASHM) dhe i mjeteve për shpërndarjen e tyre, në drejtim të aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë, përfaqëson një nga kërcënimet më serioze për stabilitetin dhe sigurinë ndërkombëtare. Për këtë arsye palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe kontribuojnë kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe të mjeteve për shpërndarjen e tyre, nëpërmjet respektimit të plotë dhe zbatimit në nivel kombëtar të detyrimeve të tyre ekzistuese, detyrime këto që rrjedhin nga traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare për çarmatimin dhe mospërhapjen, si dhe detyrime të tjera ndërkombëtare. Palët bien dakord, që kjo dispozitë përbën një element thelbësor të kësaj Marrëveshjeje dhe do të jetë pjesë e dialogut politik që shoqëron dhe konsolidon këta elementë.

Palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe kontribuojnë kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe mjeteve të shpërndarjes së tyre:

- duke ndërmarrë hapa për të nënshkruar, ratifikuar, miratuar dhe zbatuar plotësisht të gjithë instrumentet e tjera përkatëse ndërkombëtare;
- duke vendosur një sistemi efikas kontrolli të eksportit kombëtar, që kontrollon eksportin ashtu edhe tranzitin e mallrave që lidhen me armët e shkatërrimit në masë (ASHM), përfshi kontrollin e qëllimit përfundimtar të ASHM-ve prodhuar nga teknologji me qëllime përdorimi të dyfishta; dhe që përmban sanksione efektive për mosrespektimin e kontrollit të eksporteve.

Dialogu politik mbi këtë çështje mund të zhvillohet në nivel rajonal.

## NENI 9

1. Dialogu politik<sup>31</sup> zhvillohet në Këshillin e Stabilizim-Asociimit, i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme për çdo çështje që Palët mund të dëshirojnë ta shtrojnë përpara tij.

2. Me kërkesë të Palëve, dialogu politik mund të zhvillohet edhe në formatet e mëposhtme:

- takime, kur është e nevojshme, të zyrtarëve të lartë që përfaqësojnë Shqipërinë, nga njëra anë, dhe Presidenca e Këshillit të Bashkimit European<sup>32</sup> dhe Komisionit<sup>33</sup>, nga ana tjetër;
- shfrytëzimi i plotë i të gjithë kanaleve diplomatike ndërmjet Palëve, përfshirë kontaktet e përshtashtme në vendet e treta dhe brenda Kombeve të Bashkuara, OSBE-së<sup>34</sup>, Këshillit të Europës dhe forumeve të tjera ndërkombëtare;
- çdo mjet tjetër që do të jepte një kontribut të vlefshëm për konsolidimin, zhvillimin dhe thellimin e këtij dialogu.

#### NENI 10

Dialogu politik në nivel parlamentar zhvillohet brenda kuadrit të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit<sup>35</sup> ngritur në bazë të nenit 122.

#### NENI 11

Dialogu politik mund të zhvillohet brenda një kuadri shumëpalësh, dhe si dialog rajonal duke përfshirë vende të tjera të rajonit.

### TITULLI III

#### BASHKËPUNIMI RAJONAL

#### NENI 12

Në përputhje me angazhimet e saj për paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar e rajonal, si dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, Shqipëria duhet të promovojë bashkëpunimin rajonal në mënyrë aktive.

Programet e asistencës të Komunitetit European mund të mbështesin projekte që përmbajnë dimension rajonal ose ndërkufitar, nëpërmjet programeve të tij për asistencë teknike.

Në rastet kur Shqipëria parashikon të përforcojë bashkëpunimin e saj me njërin nga vendet e përmendura në nenet 13 deri në 15 si më poshtë, ajo do të informojë dhe do të konsultohet me Komunitetin dhe Shtetet Anëtare të tij, në përputhje me dispozitat e Titullit X, Dispozitat Institucionale, të Përgjithshme dhe Përfundimtare.

Shqipëria rishikon Marrëveshjet dypalëshe ekzistuese me të gjitha vendet përkatëse, ose përfundon marrëveshje të reja, në mënyrë që të sigurojë përputhjen e tyre me parimet e Memorandumit të Mirëkuptimit mbi Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë<sup>36</sup> nënshkruar në Bruksel më 27 qershor 2001.

#### NENI 13

##### Bashkëpunimi me vende tjera që kanë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociim

Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do të nisë negociatat me vendet që tashmë kanë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi me qëllim nënshkrimin e

konventave e konventave dypalëshe mbi bashkëpunimin rajonal, synimi i të cilave është rritja e fushave të bashkëpunimit ndërmjet vendeve në fjalë.

Elementet kryesorë të këtyre konventave jenë:

- dialogu politik;
- vendosja e një zone të tregtisë së lirë ndërmjet Palëve, në përputhje me dispozitat përkatëse të OBT-së;
- konçesione të ndërsjella lidhur me lëvizjen e punonjësve, vendosjen, ofrimin e shërbimeve, pagesat rrjedhëse dhe lëvizjen e kapitalit, si dhe politika të tjera që kanë të bëjnë me lëvizjen e personave në një nivel të barabartë me atë të kësaj Marrëveshjeje;
- dispozitat për bashkëpunimin në fusha të tjera të cilat trajtohen ose jo nga kjo Marrëveshje, dhe veçanërisht në fushën e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme<sup>37</sup>.

Këto konventa do të përmbajnë dispozita për krijimin e mekanizmave të duhur institucionalë.

Shqipëria i nënshkruan këto konventa brenda dy vitesh pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Gatishmëria e Shqipërisë për të nënshkruar konventa të tilla është kusht për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian.

Shqipëria do të nisë negociata të ngjashme me vendet e tjera të rajonit, pasi këto vende të kenë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi.

#### NENI 14

Bashkëpunimi me vendet e tjera që marrin pjesë në procesin e stabilizim-asociimit

Shqipëria ndjek bashkëpunimin rajonal me vendet e tjera, që marrin pjesë në Procesin e Stabilizim-Asociimit, në disa ose të gjitha fushat e bashkëpunimit që mbulon kjo Marrëveshje, dhe veçanërisht në fushat me interes të përbashkët. Një bashkëpunim i tillë duhet të jetë gjithmonë në përputhje me parimet dhe objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

#### NENI 15

Bashkëpunimi me vendet candidate<sup>38</sup> për aderim në BE

1. Shqipëria mund të nxisë bashkëpunimin dhe të përfundojë një konventë për bashkëpunimin rajonal me cilindo vend kandidat për aderim në BE, në cilëndo nga fushat e bashkëpunimit që mbulon kjo Marrëveshje.

Një konventë e tillë ka për synim futjen graduale të marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe këtij vendi drejt një linje të përbashkët me marrëdhëniet që ka ai vend në këtë fushë me Komunitetin Europian dhe Shtetet Anëtare.

2. Shqipëria do të fillojë negociatat me Turqinë me synimin për të përfunduar, bazuar në avantazhe reciproke, një marrëveshje që vendos një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet të dy palëve në përputhje me Nenin XXIV të GATT (Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë), si dhe për të liberalizuar vendosjen dhe ofrimin e shërbimeve ndërmjet tyre në një nivel të barabartë me këtë marrëveshje në përputhje me Nenin V të GATS.

Këto negociata duhet të fillojnë sa më shpejt të jetë e mundur, me synimin për të përfunduar marrëveshjen e sipërpërmendur përpara fundit të periudhës tranzitore të përmendur në nenin 16(1).

## TITULLI IV

LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE<sup>39</sup>

## NENI 16

1. Komuniteti dhe Shqipëria do të vendosin gradualisht një zonë të tregtisë së lirë<sup>40</sup> gjatë një periudhe maksimumi dhjetëvjeçare duke nisur nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me dispozitat e GATT 1994 dhe të OBT. Duke bërë këtë, ato marrin parasysh kërkesat specifike të parashtruara më poshtë.
2. Nomenklatura e Kombinuar<sup>41</sup> e mallrave do të zbatohet për klasifikimin e mallrave në tregtinë ndërmjet të dyja Palëve.
3. Për çdo produkt, tarifa<sup>42</sup> bazë mbi të cilin zbatohen reduktimet pasuese të vendosura në këtë Marrëveshje, është tarifa që faktikisht zbatohet erga omnes ditën para nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.
4. Tarifat e reduktuara që zbatohen nga Shqipëria, të llogaritura ashtu siç parashikohet në këtë Marrëveshje, rumbullakosen në numra të plotë duke përdorur parime aritmetike të zakonshme. Si rrjedhojë, të gjithë numrat që kanë 50 ose më pak pas presjes dhjetore, rumbullakosen në zbritje drejt numrit të plotë më të afërt, dhe të gjitha numrat që kanë më shumë se 50 pas presjes dhjetore, rumbullakosen në ngjitje të numrit të plotë më të afërt.
5. Nëse, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, zbatohet ndonjë reduktim tatimor mbi bazën erga omnes, në veçanti reduktimet që rrjedhin prej negociatave për tarifrat në OBT, tarifa të tilla të reduktuara zëvendësojnë tarifën bazë të përmendur në paragrafin 3, që nga data kur zbatohen reduktime të tilla.
6. Komuniteti dhe Shqipëria do t'i komunikojnë njëri-tjetrit tarifrat bazë përkatëse të tyre.

## KAPITULLI I

PRODUKTET INDUSTRIALE<sup>43</sup>

## NENI 17

1. Dispozitat e këtij Kapitulli janë të aplikueshme për produktet që e kanë origjinën në Komunitet ose Shqipëri, të renditura në Kapitujt 25 deri 97 të Nomenklaturës së Kombinuar, me përjashtim të produkteve të renditura në Shtojcën I. § I, (ii) të Marrëveshjes për bujqësinë (GATT 1994)<sup>44</sup>.
2. Tregtia ndërmjet Palëve të produkteve të përcaktuara nga Traktati themelues i Komunitetit Europian të Energjisë Atomike<sup>45</sup> do të zhvillohet në përputhje me dispozitat e atij Traktati.

## NENI 18

1. Detyrimet doganore<sup>46</sup> për importet drejt Komunitetit të produkteve që e kanë origjinën në Shqipëri, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.



2. Kufizimet sasiore<sup>47</sup> për importet drejt Komunitetit, dhe masat me efekt të njëjtë me to për produktet që e kanë origjinën në Shqipëri, shfuqizohen në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

#### NENI 19

1. Detyrimet doganore për importet drejt Shqipërisë së mallrave që e kanë origjinën në Komunitet, përveç atyre të renditura në Shtojcën<sup>48</sup> I, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Detyrimet doganore për importet drejt Shqipërisë të mallrave që e kanë origjinën në Komunitet, të cilat janë renditur në Shtojcën I, reduktohen në mënyrë progresive në përputhje me kalendarin e mëposhtëm:

- në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 80% të detyrimit bazë;
- më 1 janar të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 60% të detyrimit bazë;
- në 1 janar të vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 40% të detyrimit bazë;
- në 1 janar të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 20% të detyrimit bazë;
- në 1 janar të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 10% të detyrimit bazë;
- në 1 janar të vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimet e mbetura për importin shfuqizohen.

3. Kufizimet sasiore për importet drejt Shqipërisë së mallrave që e kanë origjinën në Komunitet dhe masat me efekt të barabartë me to, shfuqizohen në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

#### NENI 20

Komuniteti dhe Shqipëria, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, shfuqizojnë në tregtinë ndërmjet tyre çdo detyrim që ka efekt të barabartë me detyrimet doganore për importet.

#### NENI 21

1. Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti dhe Shqipëria shfuqizojnë tarifatat doganore për eksportet dhe tarifatat me efekt të njëjtë me to.

2. Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti dhe Shqipëria shfuqizojnë ndërmjet tyre të gjitha kufizimet sasiore për eksportet, dhe masat me efekt të njëjtë me to.

#### NENI 22

Shqipëria deklaron gatishmërinë e saj për të reduktuar tarifatat doganore në tregtinë me Komunitetin më shpejt se sa parashikohet në nenin 19, në rast se situata ekonomike e përgjithshme e saj dhe situata e sektorit ekonomik në fjalë e lejojnë këtë.

Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të analizojë situatën në këtë aspekt dhe do të japë rekomandimet e nevojshme.

#### NENI 23

Protokolli<sup>49</sup> 1 parashtron rregullimet e zbatueshme për produktet e hekurit dhe çelikut të Kapitujve 72 dhe 73 të Nomenklaturës së Kombinuar.

### KAPITULLI II

#### BUJQËSIA DHE PESHKIMI

#### NENI 24

##### Përkufizim

1. Dispozitat e këtij Kapitulli zbatohen për tregtinë e produkteve bujqësore dhe të peshkimit, që e kanë origjinën në Komunitet ose në Shqipëri.
2. Termi ‘‘produkte bujqësore dhe të peshkimit’’<sup>50</sup> u referohet produkteve të renditura në Kapitujt 1 deri 24 të Nomenklaturës së Kombinuar, si dhe produkteve të renditura në Shtojcën I, §I, (ii) të Marrëveshjes për bujqësinë (GATT, 1994)
3. Ky përkufizim përfshin peshkun dhe produktet e peshkimit të mbuluara nga kapitulli 3, titujt 1604 dhe 1605, dhe nëntitujt 0511 91, 2301 20 00 dhe 1902 20 10

#### NENI 25

Protokolli 2 parashtron rregullimet për tregtinë e produkteve bujqësore të përpunuara<sup>51</sup>, që renditen aty.

#### NENI 26

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti shfuqizon të gjitha kufizimet sasiore, dhe masat me efekt të njëjtë me to, për importet e produkteve bujqësore dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Shqipëri.
2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria shfuqizon të gjitha kufizimet sasiore, dhe masat me efekt të njëjtë me to, për importet e produkteve bujqësore dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Komunitet.

#### NENI 27

##### Produktet bujqësore

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti shfuqizon detyrimet doganore dhe tarifatat me efekt të njëjtë me to për importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Shqipëri, përveç atyre të titujve nr. 0102, 0201, 0202, 1701, 1702 dhe 2204 të Nomenklaturës së Kombinuar.

Për produktet e trajtuara në Kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinuar, për të cilat

Tarifa Doganore e Përbashkët parashikon zbatimin e tarifave doganore ad valorem dhe një tarifë doganore specifike, eliminimi zbatohet vetëm ndaj pjesës ad valorem të tarifës.

2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti zbaton hyrjen pa barra doganore për importet në Komunitet të produkteve që e kanë origjinën në Shqipëri të përfshira në titujt 1701 dhe 1702 të Nomenklaturës së Kombinuar, brenda kufirit të një kuote tarifore vjetore prej 1000 tonësh.

3. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria:

- (a) shfuqizon detyrimet doganore të aplikueshme për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në Shtojcën II (a);
- (b) redukton në mënyrë progresive detyrimet doganore për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në Shtojcën II (b) në përputhje me kalendarin e treguar për çdo produkt në atë Shtojcë;
- (c) shfuqizon detyrimet doganore për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në Shtojcën II (c) brenda kufirit të kuotës tarifore<sup>52</sup> të paraqitur për produktet në fjalë.

4. Protokollin 3 parashtron rregullimet që zbatohen për verërat dhe pijet alkoolike të përmendura aty.

#### NENI 28

##### Produktet e peshkimit

1. Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti heq të gjitha detyrimet doganore për importet e produkteve të peshkut dhe të peshkimit, përveç atyre të renditura në Shtojcën III që e kanë origjinën në Shqipëri. Produktet e renditura në Shtojcën III rregullohen nga dispozitat e paraqitura aty.

2. Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria nuk zbaton asnjë detyrim importi ose tarifa me efekt të njëjtë me to, për produktet e peshkut dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Komunitetin Europian.

#### NENI 29

Duke marrë parasysh volumin e tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkimit ndërmjet Palëve, ndjeshmëritë e veçanta të tyre, rregullat e politikave të përbashkëta të Komunitetit dhe politikave të Shqipërisë për bujqësinë dhe peshkimin, rolin e bujqësisë dhe peshkimit në ekonominë e Shqipërisë, si dhe pasojat e negociatave shumëpalëshe për tregtinë në kuadër të OBT-së, Komuniteti dhe Shqipëria do të shqyrtojnë në Këshillin e Stabilizim-Asociimit, jo më vonë se gjashtë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, produktet një nga një dhe mbi një bazë të ndërsjellë të rregullt dhe të përshtatshme, shqyrton gjithashtu mundësitë për t'i bërë konçesione të mëtejshme njëri-tjetrit me synim zbatimin e një liberalizimi më të madh të tregtisë<sup>53</sup> së produkteve bujqësore dhe të peshkimit.

#### NENI 30

Dispozitat e këtij Kapitulli nuk ndikojnë në asnjë mënyrë në aplikimin, mbi baza individuale, të masave më favorizuese të bëra prej njëres apo tjetres Palë.

## NENI 31

Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti nenet 38 dhe 43, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e veçantë të tregjeve të bujqësisë dhe peshkimit, në rast se importet e produkteve që e kanë origjinën në njërin nga të dyja Palët, të cilat u nënshtrohen konçsioneve të dhëna sipas neneve 25, 27 dhe 28, shkaktojnë çrregullime serioze në tregjet ose mekanizmat rregullatorë të brendshëm në Palën tjetër, të dyja Palët do të fillojnë menjëherë konsultimet për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme. Në pritje të kësaj zgjidhjeje, Pala përkatëse mund të marrë masat që ajo i konsideron si të nevojshme.

## KAPITULLI III

## DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

## NENI 32

Dispozitat e këtij Kapitulli zbatohen për tregtinë e të gjitha produkteve ndërmjet Palëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe këtu ose në Protokollat 1, 2 dhe 3.

## NENI 33

Pezullimi<sup>54</sup>

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen detyrime doganore të reja për importet ose eksportet, ose tarifa të reja me efekt të njëjtë me to, dhe nuk rriten as ato që zbatohen tashmë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.
2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen kufizime sasiore të reja për importet ose eksportet, apo masa të reja me efekt të njëjtë me to, dhe as nuk bëhen kufizime të metejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.
3. Pa çënuar konçsionet e bëra ë bazë të nenit 26, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk kufizojnë në asnjë lloj mënyre ushtrimin e politikave bujqësore përkatëse të Shqipërisë dhe Komunitetit, ose marrjen e masave në kuadër të atyre politikave, për sa kohë që këto veprime nuk ndikojnë në regjimin e importeve<sup>55</sup> në Shtojcat II dhe III.

## NENI 34

Ndalimi i diskriminimit fiskal<sup>56</sup>

1. Palët shmangin marrjen e masave ose shfuqizojnë praktikatat me natyrë fiskale të brendshme, ose ato ekzistuese që shkaktojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi diskriminim ndërmjet produkteve të njërit Palë, dhe produkteve të ngjashme që e kanë origjinën në territorin e Palës tjetër.
2. Produktet e eksportuara në territorin e njërit nga Palët nuk mund të përfitojnë nga rimbursimi për tatimin e tërthortë të brendshëm që kalon shumën e tatimit të tërthortë<sup>57</sup> të vendosur mbi to.

## NENI 35

Dispozitat lidhur me shfuqizimin e tarifave doganore për importet zbatohen gjithashtu edhe për tarifatat doganore me natyrë fiskale.

## NENI 36

Bashkimet doganore<sup>58</sup>, zonat e tregtisë së lirë, rregullimet ndërkufitare

1. Kjo Marrëveshje nuk pengon mbajtjen apo krijimin e bashkimeve doganore, zonave të tregtisë së lirë apo rregullimet për tregtinë kufitare, përveçse në rastet kur ato ndryshojnë rregullimet tregtare të parashikuara nga kjo Marrëveshje.
2. Gjatë periudhave tranzitore të përcaktuara në nenin 19, kjo Marrëveshje nuk ndikon në zbatimin e rregullimeve privilegjuese specifike që rregullojnë lëvizjen e mallrave, qoftë të parashtruara në marrëveshjet kufitare të përfunduara më parë ndërmjet një ose më shumë Shtetesh Anëtare dhe Shqipërisë, ose që kanë rrjedhur prej marrëveshjeve dypalëshe të përcaktuara në Titullin III, të përfunduara nga Shqipëria për të promovuar tregtinë rajonale.
3. Konsultimet ndërmjet Palëve zhvillohen në Këshillin e Stabilizim-Asociimit lidhur me marrëveshjet që përshkruhen në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni dhe, sipas kërkesës, për çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me politikatat e tyre përkatëse të tregtisë me vendet e treta. Veçanërisht në rastin e një vendi të tretë aderues në Komunitet, konsultime të tilla do të zhvillohen në mënyrë që të garantohet marrja parasysh e interesave të ndërsjella të Komunitetit dhe Shqipërisë të parashtruara në këtë Marrëveshje.

## NENI 37

Dumpingu<sup>59</sup> dhe Subvencioni<sup>60</sup>

1. Asnjëra nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk i pengon palët që të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e tregtisë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni dhe nenit 38.
2. Nëse njëra nga Palët zbulon se në tregtinë me Palën tjetër po ndodh dumpingu dhe/ose subvencionim kundërvepruese, kjo palë mund të ndërmarrë masat e duhura ndaj kësaj praktike në përputhje me Marrëveshjen e OBT-së për Zbatimin e Nenit VI të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifatat dhe Tregtinë 1994 dhe Marrëveshjen e OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese dhe legjislacionin e saj të brendshëm lidhur me të.

## NENI 38

Klauzola të përgjithshme për masat mbrojtëse<sup>61</sup>

1. Dispozitat e Nenit XIX GATT 1994<sup>62</sup> dhe Marrëveshja e OBT-së për Masat Mbrojtëse<sup>63</sup> zbatohen ndërmjet palëve.
2. Kur cilido produkt i njëres Palë që importohet në territorin e Palës tjetër në sasi të tilla dhe në kushte të tilla që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë:
  - dëme serioze ndaj industrisë vendase të produkteve të ngjashme ose që janë drejtpërsëdrejti konkurruese, në territorin e Palës importuese; ose
  - çrregullime serioze në cilindo sektor të ekonomisë apo vështirësi që mund të sjellin përkeqësim serioz të situatës ekonomike në një rajon të Palës importuese,

Palat importuese mund të marrë masat e përshtatshme sipas kushteve dhe në përputhje me procedurat e parashtruara në këtë nen.

3. Masat mbrojtëse dypalëshe kundrejt importeve të Palës tjetër nuk duhet të kapërcejnë nivelin e nevojshëm për riparimin e vështirësive që kanë lindur, dhe normalisht duhet të konsistojë në pezullimin e reduktimit të mëtejshëm të çdo norme tarifore të aplikueshëm të parashikuar në këtë Marrëveshje për produktin përkatës, ose në rritjen e normës tarifore për atë produkt deri në një kufi maksimal që i korrespondon normës tarifore të statusit të Kombit Më Të Favorizuar (MFN) të aplikueshëm për të njëjtin produkt. Masa të tilla përmbajnë elementë të qartë që sjellin në mënyrë progresive eliminimin e tyre në fund të periudhës së vendosur si afat përfundimtar, dhe nuk merren për një periudhë më të gjatë se një vit. Në rrethana shumë të jashtëzakonshme mund të merren masa maksimale për një periudhë deri në tre vjet. Asnjë masë mbrojtëse dypalëshe nuk zbatohet për importin e një produkti që më parë i është nënshtruar një mase të tillë, për një periudhë të paktën prej tre vjetësh që nga skadimi i masës.

4. Në rastet e përcaktuara në këtë nen, përpara marrjes së masave të parashikuara në të, ose në rastet kur aplikohet paragrafi 5 (b) i këtij neni, sapo të jetë e mundur, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, i japin Këshillit të Stabilizim-Asociimit të gjithë informacionin e përshtatshëm për të kërkuar një zgjidhje të pranueshme nga të dy Palët.

5. Për zbatimin e paragrafëve të mësipërm aplikohen dispozitat e mëposhtme:

(a) Vështirësitë që lindin nga situata e përmendur në këtë nen i kalohen për shqyrtim Këshillit të Stabilizim-Asociimit, i cili mund të marrë çfarëdolloj vendimi të nevojshëm për t'i dhënë fund këtyre vështirësive.

Në rast se Këshilli i Stabilizim-Asociimit ose Pala eksportuese, brenda tridhjetë ditëve pasi çështja i është kaluar për shqyrtim Këshillit të Stabilizim-Asociimit, nuk ka marrë një vendim për t'i dhënë fund këtyre vështirësive, ose kur nuk është arritur ndonjë zgjidhje tjetër e kënaqshme, Pala importuese mund të miratojë masat e duhura për të zgjidhur problemin në përputhje me këtë nen. Në përzgjedhjen e masave mbrojtëse u duhet dhënë përparësi atyre që ndikojnë më pak negative në funksionimin e rregullimeve të vendosura në këtë Marrëveshje. Masat mbrojtëse të zbatuara në përputhje me Nenin XIX GATT dhe Marrëveshjen e OBT-së për Masat Mbrojtëse ruajnë nivelin/hapësirën e preferencave të ofruara nga kjo Marrëveshje.

(b) Kur rrethanat e jashtëzakonshme dhe shumë serioze që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë të pamundur informacionin ose shqyrtimin paraprak, sipas rastit, Pala përkatëse, në situatat e përcaktuara në këtë nen, mund të aplikojë menjëherë masa të përkohshme të nevojshme për të trajtuar situatën dhe informon njëherësh Palën tjetër për këtë.

Masat mbrojtëse i njoftohen menjëherë Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe do të nënshtrohen konsultimeve periodike brenda këtij organi, në veçanti me synimin për të përcaktuar një kalendar veprimesh për anulimin e tyre sapo ta lejojnë rrethanat.

6. Në rast se Komuniteti ose Shqipëria ia nënshtron importet e produkteve që rrezikojnë të shkaktojnë vështirësitë e përmendura në këtë nen, një procedure administrative që ka për qëllim sigurimin e shpejtë të informacionit për tendencën e rrjedhave tregtare, informon Palën tjetër.

#### NENI 39

##### Klauzola e pamjaftueshmërisë<sup>64</sup>

1. Kur pajtueshmëria me dispozitat e këtij Titulli sjell:

(a) një pamjaftueshmëri serioze, ose një rrezik për pamjaftueshmëri, artikujve ushqimorë ose produkteve të tjerë thelbësorë për Palën eksportuese; ose

- (b) ieksportimin në një vend të tretë të një produkti ndaj të cilit Pala eksportuese ruan kufizime sasiore për eksportin, tarifa, ose masa për eksportin që kanë efekt të njëjtë, dhe kur situatat e përmendura më sipër shkaktojnë, ose mund të shkaktojnë vështirësi të mëdha për Palën eksportuese, kjo Palë mund të marrë masat e duhura në përputhje me kushtet dhe me procedurat e vendosura në këtë nen.
2. Në përzgjedhjen e masave u duhet dhënë përparësi atyre që ndikojnë më pak negativisht në funksionimin e rregullimeve të kësaj Marrëveshjeje. Këto masa nuk zbatohen në mënyrë të atillë që të përbëjnë diskriminim arbitrar e të pajustificueshëm, kur mbizotërojnë të njëjtat kushte, ose një kufizim i tërthortë për tregtinë dhe eliminohen kur kushtet nuk e justifikojnë më mbajtjen e tyre.
3. Përpara marrjes së masave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni ose, sapo të jetë e mundur, në rastet kur zbatohet paragrafi 4 i këtij neni, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, do t'i japin Këshillit të Stabilizim-Asociimit të gjithë informacionin përkatës, me qëllim për të kërkuar një zgjidhje të pranueshme për Palët. Palët brenda Këshillit të Stabilizim-Asociimit, mund të bien dakord për mjetet e nevojshme për t'i dhënë fund vështirësive. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje brenda tridhjetë ditëve pasi çështja i është kaluar Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Pala eksportuese mund të zbatojë masat e përmendura në këtë nen për eksportimin e produktit përkatës.
4. Kur rrethanat e jashtëzakonshme dhe shumë serioze që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë të pamundur informimin ose shqyrtimin paraprak, sipas rastit, Komuniteti ose Shqipëria cilado qoftë e interesuar, mund të zbatojnë sa më parë masa parandaluese të nevojshme për të trajtuar situatën dhe të informojnë Palën tjetër menjëherë për këtë.
5. Çdo masë e zbatuar sipas këtij neni i njoftohet menjëherë Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe i nënshtrohet konsultimeve periodike brenda këtij organi, në veçanti për të përcaktuar një kalendar veprimesh për eliminim e tyre sapo ta lejojnë rrethanat.

#### NENI 40

##### Monopolet shtetërore<sup>65</sup>

Shqipëria do të përshtatë në mënyrë progresive të gjitha monopolet shtetërore me karakter tregtar për tu siguruar, që nga fundi i vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të mos ekzistojnë diskriminime ndërmjet qytetarëve të Shteteve Anëtare dhe Shqipërisë lidhur me kushtet sipas të cilave sigurohen dhe tregtohen mallrat. Këshilli i Stabilizim-Asociimit informohet për masat e miratuara për arritjen e këtij objektivi.

#### NENI 41

Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshjeje, Protokollin 4 parashtron rregullat e origjinës<sup>66</sup> për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

#### NENI 42

##### Kufizimet e autorizuara

Kjo Marrëveshje nuk përjashton ndalimet apo kufizimet e importeve, eksporteve ose mallrave tranzit të justifikuar në bazë të moralit publik, politikave publike, ose sigurisë publike; mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve; mbrojtjes së thesareve kombëtare me vlerë artistike, historike ose arkeologjike, ose mbrojtjes

së pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, ose të rregullave lidhur me arin dhe argjendin. Megjithatë, ndalime ose kufizime të tilla nuk përbëjnë diskriminim arbitrar ose kufizim të tërthortë në tregtinë ndërmjet Palëve.

#### NENI 43

1. Palët bien dakord që bashkëpunimi administrativ është i domosdoshëm për zbatimin dhe kontrollin e trajtimit të privilegjuar të dhënë sipas këtij Titulli dhe nënvizojnë angazhimin e tyre për të luftuar parregullsitë dhe mashtrimin në dogana dhe çështje që lidhen me to.

2. Kur njëra Palë, në bazë të informacionit objektiv, ka konstatuar mungesën e bashkëpunimit administrativ dhe/ose parregullsi apo mashtrim sipas këtij Titulli, Pala e prekur mund të pezullojë përkohësisht trajtimin privilegjuar të produktit/produkteve përkatës në përputhje me këtë nen.

3. Për qëllimet e këtij neni, mungesa e bashkëpunimit administrativ do të thotë, përveç të tjerash:

- (a) mosrespektimi i përsëritur i detyrimeve për të verifikuar statusin e origjinës së produktit/produkteve përkatës;
- (b) refuzim i përsëritur ose vonesa të panevojshme për të kryer dhe/ose komunikuar rezultatet e një verifikimi pasues për vërtetësinë e origjinës;
- (c) refuzim i përsëritur ose vonesa të panevojshme në marrjen e autorizimit për kryerjen e misionëve të bashkëpunimit administrativ për të verifikuar vërtetësinë e dokumenteve ose saktësinë e informacionit të nevojshëm për dhënien e trajtimit preferencial në fjalë.

Për qëllimet e këtij neni, konstatimi i parregullsive ose mashtrimit mund të bëhet, përveç të tjerash, kur ka një rritje të shpejtë, pa shpjegime të kënaqshme, të importeve të mallrave, që tejkalon nivelin e zakonshëm të prodhimit dhe kapacitetin eksportues të Palës tjetër, dhe që lidhet me informacionet objektive që kanë të bëjnë me parregullsitë ose mashtrimet.

4. Zbatimi i pezullimit të përkohshëm u nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

- (a) Pala që ka bërë një konstatim, mbi bazën e informacionit objektiv, të mungesës së bashkëpunimit administrativ dhe/ose parregullsive ose mashtrimit, njofton, pa vonesa të panevojshme, Komitetin e Stabilizim-Asociimit për konstatimin e saj së bashku me informacionin objektiv dhe fillon konsultimet pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit, në bazë të gjithë informacioneve përkatëse dhe konstatimeve objektive, me synim arritjen e një zgjidhjeje të pranueshme nga të dyja Palët.
- (b) Në rast se Palët kanë filluar konsultimet pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit si më sipër dhe kanë dështuar të bien dakord për një zgjidhje të pranueshme brenda tri muajsh pas njoftimit, Pala e interesuar mund të pezullojë përkohësisht trajtimin preferencial përkatës të produktit/produkteve përkatëse. Pezullimi i përkohshëm do të njoftohet Komitetit të Stabilizim-Asociimit pa vonesa të tepruara.
- (c) Pezullimet e përkohshme në bazë të këtij neni kufizohen deri në atë që masë është e nevojshme për të mbrojtur interesat financiare të Palës së interesuar. Ato nuk zgjasin për më shumë se gjashtë muaj, periudhë e cila mund të rinovohet. Pezullimet e përkohshme i njoftohen Komitetit të Stabilizim-Asociimit menjëherë pas miratimit të tyre. Ato u nënshtrohen konsultimeve periodike pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit, veçanërisht me synimin për t'i përfunduar ato sapo të mos ketë më kushte për zbatimin e këtyre pezullimeve.



5. Njëkohësisht me njoftimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit sipas paragrafit 4a) të këtij neni, Pala e interesuar duhet të publikojë një njoftim për importuesit në Fletoren e saj Zyrtare. Njoftimi për importuesit duhet të tregojë se në bazë të informacionit objektiv, për produktin përkatës është bërë një konstatim i mungesës së bashkëpunimit administrativ dhe/ose i parregullsive ose mashtrimeve.

#### NENI 44

Në rast gabimi të bërë nga autoritetet kompetente gjatë menaxhimit të duhur të sistemit privilegjuar të eksportit dhe në veçanti gjatë zbatimit të dispozitave të protokollit të kësaj marrëveshjeje në lidhje me përkufizimin e origjinës së produkteve dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, kur ky gabim çon në pasoja lidhur me tarifën e importit, pala kontraktuese që përballet me këto pasoja mund t'i kërkojë Këshillit të Stabilizim-Asociimit shqyrtimin e mundësive për miratimin e të gjitha masave të duhura që synojnë zgjidhjen e situatës.

#### NENI 45

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet pa cënuar aplikimin e dispozitave të së drejtës Komunitare për Ishujt Kanarie.

### TITULLI V

#### LËVIZJA E PUNONJËSVE, NDËRMARRJE, OFRIMI I SHËRBIMEVE, KAPITALI

#### KAPITULLI I

#### LËVIZJA E PUNONJËSVE<sup>67</sup>

#### NENI 46

1. Në përputhje me kushtet dhe modalitetet e zbatueshme në çdo Shtet Anëtar:
  - trajtimi i akorduar punonjësve që janë shtetas shqiptarë të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar nuk përmban asnjë formë diskriminimi bazuar në kombësi, për sa u përket kushteve të punës, shpërblimit apo shkarkimit nga puna, krahasuar këto me shtetasit e tij;
  - bashkëshorti/bashkëshortja dhe fëmijët rezidentë të ligjshëm të një punonjësi të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar, me përjashtim të punonjësve sezonalë dhe të punonjësve që i nënshtrohen marrëveshjet dypalëshe nën përcaktimin e nenit 47, në rast se nuk parashikohet ndryshe nga marrëveshjet e tilla, gëzojnë akses në tregun e punës<sup>68</sup> së Shtetit Anëtar përkatës, gjatë periudhës së qëndrimit të autorizuar për punësim të punonjësit.
2. Shqipëria, në përputhje me kushtet dhe modalitetet në atë vend, u akordon të njëjtin trajtim siç përcaktohet në paragrafin 1 punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar dhe janë ligjërisht të punësuar në territorin e saj, ashtu si edhe bashkëshortit/bashkëshortes dhe fëmijëve të tyre që janë rezidentë të ligjshëm në atë vend.

## NENI 47

1. Duke marrë parasysh situatën e tregun e punës në Shtetet Anëtare, në varësi të legjislacionit të tyre dhe në pajtueshmëri me rregullat në fuqi në Shtetet Anëtare në fushën e lëvizjes së punonjësve:

- lehtësirat ekzistuese të akseseve për punësim për shtetasit shqiptarë të akorduara nga Shtetet Anëtare, me anë të marrëveshjeve dypalëshe, duhet të ruhen dhe nëse është e mundur të përmirësohen;
- Shtetet e tjera Anëtare shikojnë mundësitë e realizimit të marrëveshjeve të tilla të ngjashme.

2. Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të shikojë mundësinë për përmirësime të tjera, duke përfshirë lehtësira për akses në trajnimet profesionale, në përputhje me rregullat dhe procedurat në fuqi në Shtetet Anëtare, dhe duke marrë parasysh situatën në tregun e punës në Shtetet Anëtare dhe në Komunitet.

## NENI 48

1. Do të vendosen rregulla për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit me nënshtetësi shqiptare, të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar dhe për pjesëtarët e familjeve të tyre që janë ligjërisht rezidentë aty. Për këtë qëllim, një vendim i Këshillit të Stabilizim-Asociimit, i cili nuk duhet të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje dypalëshe ku këto të fundit parashikojnë një trajtim më të favorshëm, do të vendosin dispozitat e mëposhtme:

- të gjitha periudhat e sigurimeve, punësimit apo qëndrimit të përfunduara nga punonjës të tillë në Shtete të ndryshme Anëtare duhet të mbliidhen bashkë për qëllimin e dhënies së pensioneve dhe pagave vjetore në lidhje me pleqërinë, paaftësinë fizike dhe vdekjen dhe për qëllim përkuqdesjeje shëndetësore për këtë kategori punonjësish dhe familjarët e tyre;
- pensionet ose pagesat vjetore në lidhje me pleqërinë, vdekjen, aksidentet në punë ose sëmundjet profesionale, ose invaliditeti që shaktohet nga puna, me përjashtim të përfitimeve jo-kontribuuese, transferohen pa pengesë në masën e aplikuar sipas legjislacionit të Shtetit ose Shteteve Anëtare debitor;
- punonjësit në fjalë marrin asistencë financiare për pjesëtarët e familjeve të tyre siç përcaktohet më sipër;

2. Shqipëria u akordon punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar dhe ligjërisht të punësuar në territorin e saj, dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre rezidentë të ligjshëm aty, të njëjtin trajtim siç specifikohet në pikën e dytë dhe të tretë të paragrafit 1.

## KAPITULLI II

## NDËRMARRJE

NENI 49<sup>69</sup>

Për qëllimet e kësaj Marrëveshje:

- (a) “Shoqëri Komunitare”<sup>70</sup> ose “shoqëri shqiptare” nënkupton përkatësisht një shoqëri të themeluar në bazë të legjislacionit, përkatësisht të një Shteti Anëtar ose të Shqipërisë, dhe që ka zyrat e saj ose administratën qendrore apo vendin parësor

të biznesit të regjistruara përkatësisht në territorin e Komunitet ose të Shqipërisë.

Megjithatë, në rast se shoqëria, e krijuar në përputhje me legjislacionin, përkatësisht të një Shteti Anëtar ose të Shqipërisë, ka vetëm zyrat e saja të regjistruara në përkatësisht në territorin e Komunitetit ose të Shqipërisë, atëherë shoqëria konsiderohet si një shoqëri përkatësisht Komunitare ose shqiptare, n.q.s veprimtaritë e saj vendosin një lidhje të vazhdueshme dhe të vërteta me ekonominë përkatësisht të një prej Shteteve Anëtare ose të Shqipërisë.

- (b) “Filial”<sup>71</sup> të një shoqërie nënkupton një shoqëri e cila kontrollohet efektivisht nga kompania e parë.
- (c) “Degë”<sup>72</sup> e një shoqërie nënkupton një vend biznesi i cili nuk gëzon personalitet juridik dhe që ka pamjen e vazhdimësisë, si një shtrirje të shoqërisë mëmë, që ka një menaxhim dhe është e pajisur materialisht për të negociuar çështje biznesi me Palët e treta, kështu që këto të fundit, ndonëse janë në dijeni se në rast nevojë do të ekzistojë një lidhje juridike me organin mëmë, zyra qendrore e së cilës ndodhet jashtë vendit, nuk janë të detyruara të bashkëpunojnë direkt me një organ të tillë mëmë, por mund të përfundojnë veprimtaritë e biznesit në vendin e biznesit që përbën shtrirjen e shoqërisë mëmë.
- (d) “Ndërmarrje” nënkupton:
  - (i) për sa u përket shtetasve, të drejtën për të ndjekur veprimtari ekonomike si persona të vetëpunësuar dhe për të krijuar sipërmarrje, veçanërisht shoqëri, të cilat faktikisht kontrollohen prej tyre. Vetë-punësimi dhe sipërmarrjet tregtare nga shtetasit nuk shtrihen në kërkimin apo pranimin e punësimit në tregun e punës ose të arkordojnë të drejtën e aksesit në tregun e punës të një pale tjetër. Dispozitat e këtij Kapitulli nuk zbatohen mbi personat të cilët nuk janë ekskluzivisht të vetë-punësuar;
  - (ii) për sa u përket shoqërive Komunitare dhe shqiptare, të drejtën për të ndjekur veprimtari ekonomike nëpërmjet ngritjes së filialeve dhe degëve përkatësisht në Shqipëri ose Komunitet.
- (e) “Veprimtari” nënkupton ushtrimin e veprimtarive ekonomike.
- (f) “Veprimtari ekonomike”<sup>73</sup> në parim përfshin veprimtaritë me një karakter industrial, tregtar dhe profesional, si dhe veprimtaritë artizanale.
- (g) “Shtetas Komunitar”<sup>74</sup> dhe “shtetas shqiptar” nënkuptojnë përkatësisht një person fizik i cili është shtetas i një prej Shteteve Anëtare ose i Shqipërisë.
- (h) Për sa i përket transportit detar ndërkombëtar, duke përfshirë veprime intermodale që përfshijnë një transport tranzit me anë të detit,, shtetasit e Shtetit Anëtar ose të Shqipërisë të vendosur jashtë Komunitetit ose Shqipërisë përkatësisht, ashtu si dhe kompanitë detare të vendosura jashtë Komunitetit ose Shqipërisë dhe të kontrolluara nga shtetas të një Shteti Anëtar apo shtetas të Shqipërisë respektivisht, jenë gjithashtu përfitues të dispozitave të këtij Kapitulli dhe të Kapitullit III, në qoftë se mjetet e tyre të lundrimit janë regjistruar në atë Shtet Anëtar ose në Shqipëri përkatësisht, në përputhje me legjislacionet e tyre përkatës.
- (i) “Shërbime financiare”<sup>75</sup> nënkuptojnë ato veprimtari të përshkruara në Shtojcën IV. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të zgjerojë ose ndryshojë fushën e zbatimit të kësaj Shtojce.

## NENI 50

1. Shqipëria lehtësonë ngritjen e veprimtarive, nga shoqëri dhe shtetas Komunitarë, në territorin e saj.

Për këtë qëllim, ajo garanton me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje:

- (i) për sa i përket ndërmarrjeve të shoqërive Komunitare, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar shoqërive të saj ose shoqërive të një vendi të tretë, cilido qoftë më i mirë, dhe;
- (ii) për sa u përket veprimtarive të filialeve dhe degëve të shoqërive Komunitare në Shqipëri, pas vendosjes së tyre, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar degëve dhe shoqërive të saj ose të një filiali dhe dege të një shoqërie të një vendi të tretë, cilido qoftë më i mirë.

2. Palët nuk miratojnë asnjë rregull apo masa të reja të cilat sjellin diskriminim për sa i përket ndërmarrjeve të shoqërive Komunitare ose shqiptare në territorin e tyre ose në lidhje me veprimtaritë e këtyre shoqërive, pas vendosjes, në krahasim me shoqëritë e tyre.

3. Komuniteti dhe vendet e tij Anëtare garantojnë, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje:

- (i) për sa i përket vendosjes së shoqërive shqiptare, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar nga Shtetet Anëtare shoqërive të tyre ose shoqërive të një vendi të tretë, cilido të jetë më i mirë; dhe
- (ii) për sa u përket veprimtarive të filialeve dhe degëve të shoqërive shqiptare, të vendosura në territorin e tyre, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar nga Shtetet Anëtare degëve dhe shoqërive të tyre ose të një filiali dhe dege të një shoqërie të një vendi të tretë, të vendosura në territorin e tyre, cilido të jetë më i mirë.

4. Pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit vendos modalitetet për shtrirjen e dispozitave të mësipërme në lidhje me ndërmarrjet e shtetasve të të dyja Palëve të kësaj Marrëveshjeje për të filluar veprimtari ekonomike si persona të vetë-punësuar.

5. Pavarësisht nga parashikimet e këtij Neni:

- (a) Filialet dhe degët e shoqërive Komunitare, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje gëzojnë të drejtën për të përdorur dhe marrë me qira pasuri të patundshme në Shqipëri;
- (b) Filialet dhe degët e shoqërive Komunitare gëzojnë gjithashtu të drejtën për të fituar dhe gëzuar të drejta pronësie mbi pasuritë e patundshme ashtu si shoqëritë shqiptare, si edhe për sa u përket të mirave publike me interes të përbashkët, aty kur këto të drejta konsiderohen të nevojshme për kryerjen e veprimtarive ekonomike për të cilat ato janë themeluar, duke përfshirë burimet natyrore, tokat bujqësore, pyjet, toka pyjore. Shtatë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të vendosë modalitetet për shtrirjen e të drejtave sipas këtij paragrafi dhe në sektorët e përfshiruar.

## NENI 51

1. Në përputhje me dispozitat e nenit 50, me përjashtim të shërbimeve financiare të përshkruara në Shtojcën IV, secila Palë mund të rregullojë ngritjen dhe veprimtarinë e kompanive dhe shtetasve në territorin e saj, për sa kohë që këto rregulla nuk krijojnë diskriminim për shoqëritë dhe shtetasit e Palës tjetër në krahasim me shtetasit dhe shoqëritë e saj.

2. Për sa u përket shërbimeve financiare, pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, njëra Palë nuk ndaloheq që të marrë masa për arsye kujdesi paraprak, përfshirë mbrojtjen e investitorëve, depozituesve, personave të siguruar ose personave të cilët kanë detyrime financiare për të shlyer tek një ofruer i shërbimeve financiare, ose për të siguruar integritetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Masa të tilla nuk përdoren si një mënyrë për të shmangur detyrimet e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Në këtë Marrëveshje asgjë nuk interpretohet në mënyrë të atillë që të detyrojë një Palë për të bërë publike informacione lidhur me punët dhe llogaritë e klientëve të veçantë ose informacione konfidenciale që disponojnë entet publike.

#### NENI 52

1. Pa cënuar Marrëveshjen Shumëpalëshe për Vendosjen e një Zone të Përbashkët Europiane të Aviacionit dispozitat e këtij Kapitulli nuk zbatohen për shërbimet e transportit ajror, shërbimet e transportit në ujërat e brendshme dhe shërbimet detare të kabotazhit.

2. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të bëjë rekomandime për përmirësimin e ndërmarrjeve dhe veprimtarive në zonat e trajtuara nga paragrafi 1.

#### NENI 53

1. Dispozitat e nenit 50 dhe 51 nuk përjashtojnë zbatimin nga një Palë të rregullave të veçanta lidhur me vendosjen dhe veprimtarinë në territorin e saj të degëve të kompanive të një Pale tjetër jo të krijuara në territorin e Palës së parë, të cilat justifikohen me dallime legjislative ose teknike ndërmjet këtyre degëve krahasuar këto me degët e shoqërive të vendosura në territorin e saj ose për sa u përket shërbimeve financiare, për arsye kujdesi paraprak.

2. Trajtimi i diferencuar nuk kalon përtej masës që shihet e nevojshme si rrjedhojë e këtyre dallimeve legjislative dhe teknike, ose për sa u përket shërbimeve financiare, për arsye kujdesi paraprak.

#### NENI 54

Në mënyrë që të lehtësojë shtetasit e Komunitetit dhe shtetasit shqiptarë për të filluar dhe ndjekur veprimtari profesionale të përshtatshme përkatësisht në Shqipëri dhe në vendet e Komunitetit, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të shqyrtojë se cilat janë hapat e nevojshëm për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve. Këshilli mund të marrë të gjithë masat e nevojshme për këtë qëllim.

#### NENI 55

1. Një kompani Komunitare ose një kompani shqiptare e vendosur në territorin e Shqipërisë ose të Komunitetit përkatësisht gëzon të drejtën të punësojë, ose të ketë të punësuar nëpërmjet një prej filialeve ose degëve të saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin pritës të vendosjes së kompanisë, përkatësisht në territorin e Shqipërisë ose të Komunitetit, punonjës të cilët janë përkatësisht shtetas të Shteteve Anëtare dhe të Shqipërisë, me kusht që të jenë personel kyç siç përcaktohet në paragrafin 2 dhe që janë të punësuar ekskluzivisht nga kompani, filiale ose degë. Leja e punës dhe e qëndrimit e këtyre punonjësve mbulon vetëm periudhën e punësimit.

2. Personeli kyç i kompanive të sipërpërmendura, referuar më poshtë si “organizata”, janë “të transferuar brenda-kompanisë” siç përcaktohet në pikën c) të këtij paragrafi në kategoritë e mëposhtme, me kusht që organizata të jetë një person juridik dhe që personat e interesuar të kenë qenë të punësuar prej saj ose partnerë me të (por jo aksionerë me shumicën e aksioneve), të paktën gjatë atij viti që paraprin një lëvizje e tillë:

- (a) Personat që punojnë në një pozicion drejtues në një organizatë, të cilët drejtojnë kryesisht menaxhimin e ndërmarrjes, dhe që mbikëqyrin në mënyrë të përgjithshme ose marrin udhëzime kryesisht nga bordi i drejtorëve ose i aksionerëve të biznesit ose ekuivalentëve të tyre, duke përfshirë këtu:
  - drejtimin e ndërmarrjes ose të një departamenti apo nënndarjeje te saj;
  - mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së nëpunësëve të tjerë si të mbikëqyrësve, specialistëve ose menaxherëve;
  - kompetencës që personalisht të të punësojë dhe shkarkojë, ose të rekomandojë rekrutimin, shkarkimin ose veprime të tjera në lidhje me personelin;
- (b) Persona të punësuar në një organizatë, të cilët zotërojnë njohuri të veçanta që janë thelbësore në shërbimet e ndërmarrjes, mjetet kërkimore, teknika ose menaxhim. Vlerësimi i njohurive të tilla mund të pasqyrojë, përveç njohurive specifike të cilat lidhen me ndërmarrjen, një nivel të lartë kualifikimi që i referohet një lloj pune ose tregtie ku nevojiten njohuri teknike të veçanta, përfshirë edhe anëtarësimin në një profesion të akredituar;
- (c) Një “i transferuar brenda-kompanisë” përkufizohet si person fizik i punësuar brenda një organizate në territorin e një Pale, dhe i cili përkohësisht është transferuar në kontekst e vazhdimit të veprimtarive ekonomike në territorin e Palës tjetër; organizata përkatës duhet të ketë vendin parësor të biznesit të saj në territorin e njëres Pale dhe transferimi të ndodhë në një ndërmarrje (degë, filial) të asaj organizate, e cila ndjek me efikasitet veprimtari ekonomike të ngjashme në territorin e Palës tjetër.

3. Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm në territorin e Komunitetit ose Shqipërisë, përkatësisht i shtetasve shqiptarë ose Komunitarë, lejohet, atëherë kur këta përfaqësues të kompanive janë persona të punësuar në një pozicion drejtues, të përcaktuar në paragrafin 2 (a) më sipër, brenda një kompanie dhe janë përgjegjës për ngritjen e një filiali Komunitar, ose dege të një kompanie shqiptare, ose të një filiali shqiptar, ose degë të një kompanie Komunitare përkatësisht në një Shtet Anëtar ose në Shqipëri, atëherë kur:

- këta përfaqësues nuk janë të angazhuar në shitjet e drejtpërdrejta apo në ofrimin e shërbimeve, dhe
- kompania ka vendin parësor të biznesit të saj, përkatësisht jashtë Komunitetit ose Shqipërisë, dhe nuk ka përfaqësues, zyrë, degë ose filiale të tjera, përkatësisht në atë Shtet Anëtar ose në Shqipëri.

#### NENI 56

Gjatë pesë viteve të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria mund të zbatojë, mbi bazë kalimtare, masa të cilat devijojnë nga dispozitat e këtij Kapitulli, për sa i përket ndërmarrjeve të kompanive Komunitare dhe shtetasve të industrive të caktuara të cilat:

- janë në proces ristrukturimi, ose janë duke u përballur me vështirësi serioze, veçanërisht ku këto sjellin probleme sociale të rënda në Shqipëri, ose
- përballen me humbjen ose reduktimin drastik të tregut të zotëruar nga kompanitë ose shtetasit shqiptarë, në një sektor të caktuar ose industri në Shqipëri, ose
- janë industri të cilat po krijohen rishtas në Shqipëri.

Masa të tilla:

- (i) pushojnë së vepruari jo më vonë se shtatë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;
- (ii) duhet të jenë të arsyeshme dhe të nevojshme për të përmirësuar situatën, dhe
- (iii) nuk sjellin diskriminim ndaj aktiviteteve të kompanive ose shtetasve Komunitare të vendosura tashmë në Shqipëri në kohën e fillimit të një mase të dhënë, në krahasim me kompanitë ose shtetasit shqiptarë.

Në hartimin dhe zbatimin e masave të tilla, Shqipëria u akordon trajtim të privilegjuar kompanive dhe shtetasve Komunitare kurdoherë që është e mundur, dhe në asnjë rast trajtim më pak të favorshëm se sa ai që i është akorduar kompanive dhe shtetasve të cilido vendi të tretë. Para se të miratojë masa të tilla, Shqipëria konsultohet me Këshillin e Stabilizim-Asociimit dhe i vë në zbatim vetëm pas përfundimit të një periudhe një mujore, pasi është njoftuar Këshilli i Stabilizim-Asociimit për masat konkrete që do të zbatojë Shqipëria, me përjashtim të rasteve kur rreziku i dëmeve të riparueshme kërkon marrjen e masave urgjente, rast në të cilin Shqipëria konsultohet me Këshillin e Stabilizim-Asociimit menjëherë pas marrjes së këtyre masave.

Me përfundimin e vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria mund të paraqesë ose mbajë masa të tilla vetëm me autorizimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe sipas kushteve të përcaktuara nga ky i fundit.

### KAPITULLI III

#### OFRIMI I SHËRBIMEVE<sup>76</sup>

##### NENI 57

1. Palët angazhohen, në përputhje me dispozitat e mëposhtme që të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të lejuar në mënyrë progresive ofrimin e shërbimeve nga kompanitë ose shtetasit Komunitarë ose shqiptarë, të cilët janë vendosur në një Palë të ndryshme nga ajo e personit për cilin synohet shërbimi.

2. Në përputhje me procesin e liberalizimit të përmendur në paragrafin 1, Palët lejojnë lëvizjen e përkohshme të personave fizikë të cilët japin shërbime ose që janë punësuar nga afruesi i shërbimeve si personel kyç, sië përcaktohet në nenin 55, përfshirë personat fizikë të cilët janë përfaqësues të një kompani Komunitare ose shqiptare apo të një shtetasi Komunitar ose shqiptar dhe të cilët kërkojnë hyrje të përkohshme për të negociuar shitjen e shërbimeve ose lidhjen e marrëveshjeve për shitjen e shërbimeve për afruesin e shërbimeve në fjalë, ku këta përfaqësues nuk merren vetë me shitje të drejtpërdrejta për publikun e gjerë ose me ofrimin e shërbimeve.

3. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të marrë masat e nevojshme për të zbatuar në mënyrë progresive dispozitat në paragrafin 1. Do të merret parasysh progresi i arritur nga Palët në përafrimin e legjislacionit të tyre.

## NENI 58

1. Palët nuk ndërmarrin masa ose veprime të tilla, që i bëjnë kushtet për ofrimin e shërbimeve nga shtetasit ose shoqëritë Komunitare ose shqiptare të cilët janë vendosur në një Palë të ndryshme nga ajo e personit të cilit i drejtohet shërbimi, më kufizuese krahasuar këto me situatën ekzistuese ditën përpara hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

2. Nëse një prej Palëve është e mendimit se masat e zbatuara nga Pala tjetër pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes çojnë në një situatë e cila kufizon në mënyrë më të ndjeshme ofrimin e shërbimeve krahasuar këto me situatën ekzistuese ditën hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Pala e parë mund t'i kërkojë Palës tjetër që të konsultohet.

## NENI 59

Në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transportit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë, aplikohen dispozitat e mëposhtme:

1. Lidhur me transportin e brendshëm tokësor, Protokollin 5 parashtron rregullat e aplikueshme në marrëdhëniet ndërmjet Palëve për të siguruar, sidomos trafik rrugor tranzit të pakufizuar përmes Shqipërisë dhe Komunitetit në tërësi, zbatimin efektiv të parimit të mos-diskriminimit dhe harmonizimit progresiv të legjislacionit shqiptar për transportin me atë Komunitar.

2. Lidhur me transportin ndërkombëtar detar, Palët angazhohen të zbatojnë me efektivitet parimin e lejimit të aksesit të pakufizuar në treg dhe trafik mbi baza tregtare, si edhe të respektojnë detyrimet ndërkombëtare dhe europiane në fushën e standardeve të sigurisë, sigurimit dhe të mjedisit.

Palët konfirmojnë angazhimin e tyre për një mjedis të lirë konkurrues, si një veçori thelbësore në transportin detar ndërkombëtar.

3. Në zbatimin e parimeve të paragrafit 2, Palët 2:

- (a) nuk do të paraqesin klauzola për ngarkesa të përbashkëta në marrëveshjet e ardhshme dypalëshe me vendet e treta;
- (b) shfuqizojnë, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha masat e njëanshme si dhe pengesat administrative, teknike dhe të tjera të cilat mund të kenë efekte kufizuese apo diskriminuese në ofrimin e lirë të shërbimeve në transportin detar ndërkombëtar.
- (c) secila Palë nuk duhet të ofrojë përveç të tjerash, një trajtim jo më pak të favorshëm për anijet e zotëruara nga shtetas ose shoqëri të Palës tjetër, krahasuar kjo me trajtimin e dhënë ndaj anijeve të Palës në fjalë, për sa i përket aksesit në porte të hapura për tregtinë ndërkombëtare, përdorimit të infrastrukturës dhe shërbimeve ndihmëse detare në porte, ashtu si dhe tarifave dhe taksave, lehtësirave doganore e caktimin e vendeve të ankorimit dhe të lehtësirave për ngarkim-shkarkim.

4. Me qëllim sigurimin e një zhvillimi të bashkërenduar dhe liberalizim progresiv të transportit ndërmjet Palëve të përshtatur sipas nevojave tregtare të përbashkëta, kushtet për aksesin e ndërsjellë në tregun e transportit ajror do të trajtohen në marrëveshje të veçanta të cilat do të negociohen ndërmjet Palëve.

5. Para se të bëhet përfundimi i marrëveshjes së përmendur në paragrafin 4, Palët nuk marrin asnjë masë ose veprim që është më kufizues ose diskriminues krahasuar këto me situatën ekzistuese para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.



6. Shqipëria do të përshtasë legjislacionin e saj, duke përfshirë gjithashtu rregullat administrative, teknike dhe të tjera, me ato Komunitare ekzistuese në çdo kohë, në fushën e transportit ajror, detar dhe tokësor të brendshëm për aq kohë sa kjo u shërben qëllimeve të liberalizimit dhe aksesit të ndërsjellë në tregjet e Palëve dhe lehtëson lëvizjen e pasagjerëve dhe të mallrave.

7. Bazuar në progresin e përbashkët në arritjen e objektivave të këtij Kapitulli, Këshilli i Stabilizim-Asociimit shqyrton mënyrat për krijimin e kushteve të nevojshme për përmirësimin e lirisë në ofrimin e shërbimeve në transportin ajror dhe tokësor të brendshëm.

## KAPITULLI IV

### PAGESAT RRJEDHËSE DHE LËVIZJA E KAPITALIT<sup>77</sup>

#### NENI 60

Palët angazhohen të autorizojnë, në monedha të këmbyeshme lirshëm, çdo pagesë apo transfertë në llogarinë rrjedhëse<sup>78</sup> të bilancit të pagesave ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë ,në përputhje me dispozitat e Nenit VIII të Neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

#### NENI 61

1. Në lidhje me transaksionet e kapitalit dhe llogaritë financiare të bilancit të pagesave, që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, Palët sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investime të drejtpërdrejta<sup>79</sup> të kryera nga kompani të krijuara në përputhje me legjislacionin e vendit pritës, dhe me investime të kryera në përputhje me dispozitat e Kapitullit II të Titullit V, si dhe likuidimin ose riatdhesimin e këtyre investimeve dhe të çdo përfitimi që rrjedh prej tyre.

2. Në lidhje me transaksionet në e kapitalit dhe llogaritë financiare të bilancit të pagesave<sup>80</sup>, nga hyrja në fuqi të Marrëveshjes, Palët sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit për sa u përket kredive që lidhen me transaksionet tregtare ose me sigurimin e shërbimeve ku merr pjesë një rezident i një prej Palëve, dhe të huave financiare e kredive, me afat maturimi më të gjatë se një vit.

Që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria autorizon, duke shfrytëzuar në mënyrë maksimale dhe të përshtatshme procedurat dhe kuadrin ligjor, blerjen e pasurive të patundshme në Shqipëri nga shtetas të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian, me përjashtim të kufizimeve të parashikuara në Kalendarin e Shqipërisë për Angazhime Specifike sipas Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë për Shërbime (GATS).

Brenda shtatë vitesh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria në mënyrë progresive do të përafrojë legjislacionin e saj lidhur me të drejtën e blerjes së pasurive të patundshme në Shqipëri nga shtetas të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian për t'iu siguruar trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që u sigurohet shtetasve shqiptarë. Pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të shqyrtojë modalitetet për eliminimin progresive të këtyre kufizimeve.

Palët gjithashtu do të sigurojnë, që nga viti i pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, lëvizjen e lirë të kapitalit për investimet në letrat me vlerë e huat financiare dhe kreditë me një afat maturimi më të shkurtër se një vit.

3. Pa çënuar paragrafin 1, Palët nuk do të paraqesin kufizime të reja në lëvizjen e kapitalit dhe pagesave rrjedhëse ndërmjet rezidentëve të Komunitetit dhe Shqipërisë, dhe nuk do t'i bëjnë marrëveshjet ekzistuese më tepër kufizuese.

4. Pa çënuar dispozitat e nenit 60 dhe as të këtij neni, në rrethana të jashtëzakonshme, kur lëvizjet e kapitalit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë shkaktojnë ose kërcënojnë të shkaktojnë vështirësi serioze për funksionimin e politikave të kursit të këmbimit ose politikave monetare në Komunitet ose Shqipëri, Komuniteti dhe Shqipëria përkatësisht, mund të marrin masa mbrojtëse lidhur me lëvizjet e kapitalit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë për një periudhë jo më të gjatë se një vit në qoftë se masa të tilla janë më se të nevojshme.

5. Në dispozitat e mësipërme asgjë nuk duhet interpretuar si kufizim i të drejtave të operatorëve ekonomikë të Palëve për të përfutur nga një trajtim më i favorshëm që mund të parashikohet në ndonjë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ekzistuese, pjesë e së cilës janë Palët e kësaj Marrëveshjeje.

6. Palët konsultohen ndërmjet tyre për të lehtësuar lëvizjen e kapitalit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë, në mënyrë që të promovohen objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

#### NENI 62

1. Gjatë tri viteve të para që nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët marrin masa që lejojnë krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e mëtejshëm gradual të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e lirë të kapitalit.

2. Në përfundim të vitit të tretë që nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit përcakton modalitetet për zbatimin e plotë të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e kapitalit.

### KAPITULLI V

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### NENI 63

1. Dispozitat e këtij Titulli zbatohen duke iu nënshtruar kufizimeve për arsye të politikave publike, sigurisë publike ose shëndetit publik<sup>81</sup>.

2. Ato nuk zbatohen për veprimtari të cilat kanë lidhje, edhe rastësisht, me ushtrimin e autoritetit zyrtar në territorin e secilës prej Palëve.

#### NENI 64

Për qëllimin e këtij Titulli, në këtë Marrëveshje asgjë nuk ndalon Palët të zbatojnë ligjet dhe aktet e tyre nënligjore për sa i përket hyrjes dhe qëndrimit, punësimit, kushteve të punës, vendosjes së personave fizikë dhe ofrimit të shërbimeve, me kusht që, duke vepruar në këtë mënyrë, ata nuk i zbatojnë këto masa në mënyrë të tillë që të anulojnë ose të dëmtojnë përfitimet e secilës prej Palëve sipas kushteve të një dispozite të veçantë të kësaj Marrëveshjeje. Kjo dispozitë nuk çënon zbatimin e nenit 63.

## NENI 65

Kompanitë të cilat kontrollohen dhe janë ekskluzivisht nën pronësinë e përbashkët të shtetasve ose kompanive shqiptare dhe të shtetasve ose kompanive Komunitare, janë gjithashtu subjekt i dispozitave të këtij Titulli..

## NENI 66

1. Trajtimi i Kombit më të Favorizuar<sup>82</sup>, i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij Titulli nuk zbatohet mbi avantazhet e tatimeve që Palët sigurojnë ose do të sigurojnë në të ardhmen në bazë të marrëveshjeve që kanë për qëllim shmangien e tatimit të dyfishtë ose rregullime të tjera tatimesh.

2. Asnjë prej dispozitave të këtij Titulli nuk duhet të interpretohen si masa që parandalojnë miratimin ose imponimin nga Palët, të masave të cilat synojnë parandalimin e shmangieve ose evazionin e tatimeve në vijim të dispozitave tarifore të marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe formave të tjera tatimore ose legjislacionin e brendshëm fiskal.

3. Asnjë prej dispozitave të këtij Titulli nuk duhet interpretuar si masa që parandalojnë Shtetet Anëtare ose Shqipërinë të zbatojnë dispozitat përkatëse të legjislacioneve të tyre fiskalë, për dallimin e taksapaguesve të cilët nuk gjenden në situata të njëjta, sidomos në lidhje me vendin e tyre të qëndrimit.

## NENI 67

1. Palët përpiqen kurdo të jetë e mundur, të shmangin vendosjen e masave kufizuese, përfshirë masat për kufizimin e importeve, për të mbrojtur bilancin e pagesave. Pala e cila miraton masa të tilla duhet t'i paraqesë sa më shpejt të jetë e mundur Palës tjetër një kalendar për heqjen e tyre.

2. Në rastin kur një ose më shumë Shtete Anëtare apo Shqipëria gjenden në një situatë tejet të vështirë të bilancit të pagesave, ose pranë një rreziku të afërt, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, në përputhje me kushtet e vendosura nga Marrëveshja e OBT-së, miratojnë masa kufizuese, përfshirë masa mbi importet, të cilat duhet të jenë për një kohë të kufizuar dhe nuk mund të masat veçanërisht të nevojshme për rregullimin e situatës së bilancit të pagesave. Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, informon menjëherë Palën tjetër.

3. Asnjë masë kufizuese nuk zbatohet për transfertat lidhur me investimet, dhe sidomos lidhur me riatdhësimin e shumave të investuara ose të riinvestuara apo çdo lloj të ardhurash që rrjedhin nga to.

## NENI 68

Dispozitat e këtij Titulli përshtaten progresivisht, veçanërisht në kuadër të kërkesave që vijnë nga Neni V i Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë në Shërbime (GATS).

## NENI 69

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk çenojnë zbatimin prej secilës Palë të masave të nevojshme për të parandaluar shmangien e masave lidhur me aksesin e vendeve të treta në tregun e tyre nëpërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

## TITULLI VI

## PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT, IMPONIMI I LIGJEVE DHE RREGULLAT E KONKURENCËS

## NENI 70

1. Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me acquis e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.

2. Ky përafrim fillon në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementët e acquis të Komunitetit të përmendura në këtë Marrëveshje brenda periudhës tranzitore të përcaktuar në Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjatë fazës së parë të përcaktuar në Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, përafrimi do të përqendrohet në elementët thelbësorë të acquis së Tregut të Brendshëm ashtu si dhe në fusha të tjera të rëndësishme si konkurrenca, të drejtat mbi pronësinë intelektuale, industriale dhe tregtare, prokurimi publik, standardet dhe certifikimi, shërbimet financiare, transporti detar dhe tokësor – duke i kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë dhe standardeve mjedisore si dhe aspekteve sociale –, ligji për kompanitë tregtare, kontabiliteti, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e të dhënave, shëndeti dhe siguria në punë dhe mundësi të barabarta. Gjatë fazës së dytë, Shqipëria përqendrohet në pjesët e mbetura të acquis.

Përafrimi kryhet në bazë të një programi, për të cilin do të bihet dakord, ndërmjet Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe Shqipërisë.

4. Shqipëria, në pajtim me Komisionin e Komuniteteve Europiane, do të përcaktojë modalitetet për monitorimin e zbatimit të veprimeve që ndërmerren për përafrimin e legjislacionit dhe imponimin e ligjeve.

## NENI 71

Konkurrenca<sup>83</sup> dhe dispozita të tjera ekonomike

1. Dispozitat në vijim nuk përputhen me funksionimin e duhur të Marrëveshjes, duke qenë se mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë:

- (i) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve të cilat kanë si objektiv të tyre ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës;
- (ii) abuzimi me pozicionin dominues<sup>84</sup>, nga një ose më shumë sipërmarrje, në territoret e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre;
- (iii) çdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara.

2. Praktikrat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.

3. Palët sigurojnë që një institucioni publik dhe funksionalisht të pavarur t'i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (i) dhe (ii) të këtij Neni, lidhur me sipërmarrjet private dhe publike dhe sipërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta.

4. Shqipëria do të ngrejë një autoritet funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (iii) të këtij neni brenda katër vjetësh, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Ky autoritet do të ketë veç të tjerash, kompetenca për të autorizuar skema të ndihmës shtetërore dhe grante ndihme individuale në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni, si dhe kompetenca për të urdhëruar rikthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme.

5. Secila prej Palëve garanton transparencë në fushën e ndihmës shtetërore<sup>85</sup>, duke i paraqitur, veç të tjerash Palës tjetër një raport të rregullt vjetor, ose i njëjtë me të, duke ndjekur metodologjinë dhe paraqitjen e sondazhit të Komunitet për ndihmën shtetërore. Me kërkesë të njëjës Palë, Pala tjetër do t'i japë informacione për çështje të veçanta të ndihmës publike.

6. Shqipëria harton një inventar gjithëpërfshirës të skemave të ndihmës të krijuara para ngritjes së autoritetit të përmendur në paragrafin 4, dhe i drejton këto skema ndihme në përputhje me kriteret e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, brenda një periudhe jo më shumë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

7. Me qëllim zbatimin e dispozitave të paragrafit 1 (iii), Palët pranojnë që gjatë dhjetë viteve të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo ndihmë publike e dhënë nga Shqipëria vlerësohet duke marrë parasysh faktin se ajo konsiderohet si një zonë e njëjtë me zonat e përshkuara në Nenin 87 (3)(a) të Traktatit themelues të Komunitetit Europian. Brenda pesë viteve që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit të Komuniteteve Europiane shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar me nivelin NUTS II<sup>86</sup>. Më pas, autoriteti i përmendur në paragrafin 4 dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane vlerëson bashkërisht kriteret për pranueshmërinë e zonave të Shqipërisë si dhe intensitetin maksimal të ndihmës në lidhje me to, në mënyrë që të hartohet harta rajonale e ndihmave në bazë të direktivave përkatëse të Komunitetit.

8. Në lidhje me prodhimet e përmendura në Kapitullin II të Titullit IV:

- paragrafi 1 (iii) nuk zbatohet;
- çdo praktikë në kundërshtim me paragrafin 1(i) vlerësohet sipas kriterëve të vendosura nga Komuniteti në bazë të Neneve 36 dhe 37 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve specifike të Komunitetit të miratuara mbi këtë bazë.

9. Në qoftë se një nga Palët është e mendimit se një praktikë e veçantë nuk përputhet me termat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, ajo mund të marrë masat e nevojshme pas konsultimeve të bëra me Këshillin e Stabilizim-Asociimit ose tridhjetë ditë pune pas kërkesës për konsultim. Asgjë në këtë nen nuk çënon ose ndikon në ndonjë mënyrë për marrjen, nga secila prej Palëve, të masave antidumping ose të masave kundëvepruese në përputhje me nenet përkatëse të GATT 1994 dhe Marrëveshjes së OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundëvepruese apo legjislacionit të brendshëm përkatës.

## NENI 72

### Sipërmarrjet publike<sup>87</sup>

Brenda vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria zbaton, për sipërmarrjet publike dhe sipërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta dhe ekskluzive, parimet e parashikuara në Traktatin themelues të Komunitetit Europian, duke iu referuar veçanërisht nenit 86.

Të drejtat e veçanta të sipërmarrjeve publike gjatë periudhës tranzitore nuk përfshijnë mundësinë e vendosjes së kufizimeve sasiore, ose masave me efekt të njëjtë, mbi importet nga Komuniteti në Shqipëri.

#### NENI 73

##### Pronësia intelektuale<sup>88</sup>, industriale dhe tregtare

1. Në përputhje me dispozitat e këtij Neni dhe Shtojcën V, Palët konfirmojnë rëndësinë që i japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si edhe imponimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.
2. Shqipëria merr masat e nevojshme për të garantuar brenda katër viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje një nivel mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të njëjtë me atë që ekziston në Komunitet, përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.
3. Shqipëria merr përsipër të bëhet palë brenda periudhës së përcaktuar më lart në konventat shumëpalëshe për të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të përmendura në Shtojcën VI, paragrafi 1. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të vendosë për të detyruar Shqipërinë të bëhet palë në Konventa të veçanta shumëpalëshe në këtë fushë.
4. Nëse ndodhin probleme në fushën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare që ndikojnë në kushtet e tregtisë, me kërkesë të një Pale, problemet i dërgohen urgjentisht Këshillit të Stabilizim-Asociimit, me synim arritjen e zgjidhjeve të kënaqshme për palët.

#### NENI 74

##### Kontratat publike<sup>89</sup>

1. Palët konsiderojnë si një objektiv të dëshirueshëm liberalizimin e kontratave publike në bazë të parimit të mos-diskriminimit dhe reciprocitetit, veçanërisht në kontekstin e OBT-së.
  2. Kompanive shqiptare, edhe nëse nuk janë vendosur në Komunitet, u jepet e drejta për të marrë pjesë për akordim kontrate në Komunitet sipas rregullave të prokurimit të Komunitetit, duke mos marrë trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë kompanive komunitare, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Dispozitat e mësipërme zbatohen gjithashtu në kontratat e shërbimeve publike, sapo qeveria shqiptare të ketë miratuar legjislacionin duke vendosur rregullat komunitare për këtë fushë. Komuniteti shqyrton periodikisht nëse Shqipëria ka miratuar vërtetë këtë legjislacion.
  3. Kompanitë komunitare që nuk janë vendosur në Shqipëri gëzojnë të drejtën e fitimit të kontratës në Shqipëri në bazë të Ligjit shqiptar për Prokurimin Publik duke mos marrë një trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë shoqërive shqiptare, jo më vonë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.
  4. Këshilli i Stabilizim-Asociimit shqyrton periodikisht mundësinë që Shqipëria të nisë lejimin për të marrë pjesë në procedurat e fitimit të kontratës në Shqipëri të gjitha kompanive komunitare. Shoqëritë komunitare të vendosura në Shqipëri sipas dispozitave të Kapitullit II të Titullit V, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, gëzojnë të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e fitimit të kontratës duke mos marrë trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë kompanive shqiptare.
- Në lidhje me ndërmarrjet, veprimtaritë, dhënien e shërbimeve ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë, si dhe punësimin dhe lëvizjen e punonjësve me qëllim përmbushjen e kontratave publike, aplikohen dispozitat e neneve 46 deri në 69.

## NENI 75

Standardizimi<sup>90</sup>, metrologjia<sup>91</sup>, akreditimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë

1. Shqipëria merr masat e nevojshme për siguruar gradualisht përputhshmërinë me rregulloret teknike të Komunitetit dhe procedurave europiane të vlerësimit të standardizimit, metrologjisë, akreditimit dhe përputhshmërisë.
2. Për këtë qëllim, Palët do të fillojnë në një fazë të hershme:
  - nxitjen e përdorimit të rregulloreve teknike të Komunitetit, standardeve europiane dhe procedurave të vlerësimit të përputhshmërisë,
  - dhënien e asistencës për të nxitur zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë: standardizimin, metrologjinë, akreditimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë;
  - nxitjen e pjesëmarrjes së Shqipërisë në veprimtarinë e organizatave që kanë të bëjnë me standardet, vlerësimin e përputhshmërisë, metrologjinë dhe funksione të ngjashme (p.sh. CEN, CENELEC, ETSI, EA, WELMEC<sup>92</sup>, EUROMET<sup>93</sup> etj).
  - përfundimin e Protokolleve Europiane të Vlerësimit të Përputhshmërisë<sup>94</sup>, aty ku shihet e arsyeshme, menjëherë pasi kuadri ligjor dhe procedurat shqiptare të jenë përafëruar ,në masë të mjaftueshme me ato komunitare dhe të ekzistojë ekspertiza e përshtatshme.

## NENI 76

Mbrojtja e konsumatorit<sup>95</sup>

Palët do të bashkëpunojnë për përafrimin e standardeve për mbrojtjen e konsumatorëve në Shqipëri me standardet komunitare. Mbrojtja e efektshme e konsumatorit është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të ekonomisë së tregut, mbrojtje e cila varet nga zhvillimi i një infrastrukture administrative për të siguruar mbikëqyrjen e tregut dhe zbatimin e ligjeve në këtë fushë.

Për këtë qëllim, dhe në kuadër të interesave të tyre të përbashkëta, Palët do të inkurajojnë dhe garantojnë:

- një politikë për mbrojtjen aktive të konsumatorëve, në përputhje me të drejtën komunitare;
- harmonizimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve në Shqipëri me atë ekzistues në Komunitet;
- mbrojtje efektive ligjore për konsumatorët në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mallrave të konsumit, dhe ruajtjen e standardeve të duhura të sigurisë;
- monitorimin e rregullave nga autoritetet kompetente dhe garantimin e aksesit tek drejtësia në rast mosmarrëveshjes.

## NENI 77

## Kushtet e punës dhe mundësitë të barabarta

Shqipëria do të harmonizojë në mënyrë progresive legjislacionin e saj me atë të Komunitetit në fushën e kushteve të punës, veçanërisht të shëndetit dhe sigurisë në punë, dhe mundësive të barabarta.

## TITULLI VII

## LIRIA, DREJTËSIA DHE SIGURIA

## HYRJE

## NENI 78

## Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës

Në bashkëpunimin e tyre në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme Palët i kushtojnë rëndësi të veçantë forcimit të shtetit të së drejtës, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si edhe imponimit të ligjeve e administrimit të drejtësisë në veçanti.

Bashkëpunimi synon veçanërisht në fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe në përmirësimin e efikasitetit të tij, në përmirësimin e funksionimit të policisë dhe organeve të tjera të imponimit të ligjeve duke siguruar trajnime të mjaftueshme dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

## NENI 79

## Mbrojtja e të dhënave personale

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do të harmonizojë legjislacionin për të dhënat personale me të drejtën komunitare, dhe me legjislacionin tjetër europian dhe ndërkombëtar mbi privatësinë. Shqipëria krijon organe mbikëqyrës të pavarur me burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të monitoruar dhe garantuar në mënyrë efikase imponimin e legjislacionit të brendshëm për mbrojtjen e të dhënave personale. Palët do të bashkëpunojnë për të arritur këtë qëllim.

## BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E LËVIZJES SË PERSONAVE

## NENI 80

Vizat<sup>96</sup>, menaxhimi i kufijve<sup>97</sup>, azili<sup>98</sup> dhe migracioni<sup>99</sup>

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e vizave, kontrollit të kufijve, azilit dhe migracionit dhe të ngrenë një kuadër bashkëpunimi përshtirë atë në nivel rajonal, në këto fusha, duke marrë parasysh dhe duke përdorur plotësisht nismat e tjera ekzistuese në këtë fushë siç mund të jetë e përshtatshme.

Bashkëpunimi në çështjet të sipërpërmendura bazohet në konsultimet e ndërsjella dhe bashkërendimin e ngushtë ndërmjet Palëve dhe duhet të përfshijë asistencë teknike dhe administrative për:

- shkëmbimin e informacionit mbi legjislacionin dhe praktikën;
- hartimin e legjislacionit;
- rritjen e efikasitetit të institucioneve;
- trajnimin e personelit;
- sigurinë e dokumenteve të udhëtimit dhe zbulimin e dokumenteve false;
- menaxhimin e kufijve.

Bashkëpunimi përqendrohet veçanërisht:

- në fushën e azilit për zbatimin e legjislacionit të brendshëm për përmbushjen e



standardeve të Konventës së Gjenevës<sup>100</sup> të vitit 1951 dhe Protokollit të Nju Jorkut<sup>101</sup> të vitit 1967 për të siguruar në këtë mënyrë respektimin e parimit të mos-kthimit<sup>102</sup> të individit në atë vend që përbën kërcënim për jetën e tij, si dhe të të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve<sup>103</sup>;

- në fushën e migracionit të ligjshëm, për rregullat e pranimit dhe të drejtat dhe statusin e personave të pranuar. Lidhur me migracionit Palët bien dakord për një trajtim të drejtë të shtetasve të vendeve të tjera të cilët janë rezidentë të ligjshëm në territoret e tyre dhe për të promovuar politika integrimi që synojnë të bëjnë të drejtat dhe detyrimet e tyre të krahasueshme me ato të shtetasve të vetë.

#### NENI 81

##### Parandalimi dhe kontrolli i imigrimit të paligjshëm; ripranimi<sup>104</sup>

Palët bashkëpunojnë për të parandaluar dhe frenuar imigrimin e paligjshëm. Për këtë qëllim, Palët, sipas kërkesës dhe pa formalitete të mëtejshme, bien dakord që Shqipëria dhe Shtetet Anëtare:

- do të ripranojnë çdo shtetas<sup>105</sup> të tyre që qëndron në mënyrë të paligjshme në territoret e tyre;
- do të ripranojnë çdo shtetas të vendeve të treta<sup>106</sup> dhe çdo person pa shtetësi që qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e tyre dhe që ka hyrë në territorin e Shqipërisë nëpërmjet një Shteti Anëtar, ose prej tij, apo që ka hyrë në territorin e një Shteti Anëtar nëpërmjet Shqipërisë, ose prej saj.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian dhe Shqipëria pajisin shtetasit e tyre me dokumente të përshtatshëm identifikimi dhe do t'u sigurojnë atyre lehtësirat administrative për këtë qëllim.

Procedura të veçanta për qëllimet e ripranimit të shtetasve, shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi janë përcaktuar në kuadrin e Marrëveshjes ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë mbi ripranimin e personave rezidentë pa autorizim, të nënshkruar më 14 prill 2005.

1. Shqipëria pranon të përfundojë marrëveshjet për ripranim me vendet e procesit të Stabilizim-Asociimit dhe merr përsipër të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin fleksibël dhe të shpejtë të të gjitha marrëveshjeve të ripranimit referuara në këtë nen. Këshilli i Stabilizim-Asociimit ndërmerr përpjekje të tjera të përbashkëta që mund të bëhen për të parandaluar dhe frenuar imigracionin e paligjshëm, duke përfshirë rrjetet e trafikimit dhe të migrimit të paligjshëm.

#### BASHKËPUNIMI NE LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE DROGAVE TË PALIGJSHME

#### NENI 82

##### Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit

1. Palët bashkëpunojnë ngushtësisht me qëllim parandalimin e përdorimit të sistemeve të tyre financiare për pastrimin e parave nga veprimtaritë kriminale<sup>107</sup> në përgjithësi dhe veprat penale të drogës në veçanti, si edhe për financimin e terrorizmit.
2. Bashkëpunimi në këtë fushë mund të përfshijë asistencë teknike dhe administrative me qëllim që të zhvillohet zbatimi i akteve normative, dhe funksionimi efikas i standardeve të përshtatshme dhe mekanizmave për luftën kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit të njëjtë me ato që përdoren nga Komuniteti e forumet ndërkombëtare në këtë fushë, veçanërisht Grupi i Përbashkët për Veprimin Financiar<sup>108</sup>.

## NENI 83

## Bashkëpunimi kundër drogave të paligjshme

1. Brenda mundësive dhe kompetencave të tyre, Palët bashkëpunojnë për të siguruar një qëndrim të balancuar dhe të integruar në drejtim të problemeve të drogës. Politikat dhe veprimet në lidhje me drogën do të përdoren për pakësimin e trafikimit, kërkesës për droga të paligjshme e furnizimit me to, si dhe për të ushtruar një kontroll më të efektshëm pas njoftimeve paralajmëruese.

2. Palët bien dakord mbi metodat e nevojshme të bashkëpunimit për arritjen e këtyre objektivave.

Veprimet bazohen në parime përgjithësisht të pranuar, në përputhje me Strategjinë e BE-së për Drogën<sup>109</sup>.

## BASHKËPUNIMI KUNDER TERRORIZMIT

## NENI 84

Palët bien dakord të bashkëpunojnë për të parandaluar dhe eliminuar aktet terroriste dhe financimet e tyre, veçanërisht ato që përfshijnë veprimtaritë ndërkufitare, që janë në përputhje me konventat ndërkombëtare ku ato bëjnë pjesë, si dhe me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse.:

- në kuadër të zbatimit të plotë të Rezolutës 1373 të Këshillit të Sigurimit<sup>110</sup> dhe rezolutave të tjera përkatëse të OKB-së, instrumenteve dhe konventave ndërkombëtare;
- nëpërmjet shkëmbimit të informacionit për grupet terroriste dhe rrjeteve të tyre mbështetëse, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe atë të brendshme;
- nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës në lidhje me mjetet dhe metodat për të luftuar terrorizmin si dhe në fushën teknike dhe të trajnimit, dhe përmes shkëmbimit të eksperiencës për parandalimin e terrorizmit.

## BASHKËPUNIMI NË ÇËSHTJET PENALE

## NENI 85

Parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme Palët bashkëpunojnë në luftën dhe parandalimin e veprimtarive kriminale dhe të paligjshme, të organizuara ose jo, të tilla si:

- kontrabanda<sup>111</sup> dhe trafikimi i qenieve njerëzore;
- aktivitete ekonomike të paligjshme, dhe në veçanti falsifikimi i monedhave<sup>112</sup>, transaksionet e paligjshme me prodhime të tilla si mbetje industriale, materiale radioaktive dhe transaksione që kanë lidhje me prodhime të paligjshme ose të falsifikuara<sup>113</sup>;
- korrupsioni, si në sektorin privat ashtu dhe në atë publik, veçanërisht kur ka të bëjë me praktika administrative jo-transparente;
- mashtrimi fiskal;
- trafikimi i paligjshëm i drogave dhe lëndëve psikotrope;
- kontrabanda;
- trafikimi i paligjshëm i armëve;

- falsifikimi i dokumenteve;
- trafikimi i paligjshëm i makinave;
- krimi kibernetik

Do të nxitet bashkëpunimi rajonal dhe respektimi i standardeve të njohura ndërkombëtare në luftën kundër krimit të organizuar.

## TITULLI VIII

### POLITIKAT E BASHKËPUNIMIT<sup>114</sup>

#### NENI 86

1. Komuniteti dhe Shqipëria do të vendosin një bashkëpunim të ngushtë për të kontribuar në potencialin e zhvillimit dhe rritjes së Shqipërisë. Një bashkëpunim i tillë do të forcojë lidhjet ekonomike ekzistuese në një bazë sa më të gjerë, për përfitimin e të dyja palëve.

2. Do të hartohen politika dhe masa të tjera të hartuara për të sjellë zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm në Shqipëri. Këto politika duhet të sigurojnë që çështjet e mjedisit të jenë të përfshira që nga fillimi dhe të lidhura me kërkesat për zhvillimin e harmonizuar social.

3. Politikat e bashkëpunimit do të integrohen në një kuadër rajonal bashkëpunimi. Kujdes i veçantë duhet t'u kushtohet masave që mund të nxisin bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve fqinje të saj duke përfshirë Shtetet Anëtare, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të përcaktojë përparësitë ndërmjet dhe brenda politikave të bashkëpunimit të përshkruara në vijim.

#### NENI 87

##### Politikat ekonomike dhe tregtare

Komuniteti dhe Shqipëria do të lehtësojnë procesin e reformave ekonomike nëpërmjet bashkëpunimit për të përmirësuar mirëkuptimin e bazave të ekonomive të tyre përkatëse, si dhe formulimin dhe zbatimin e politikave ekonomike në ekonominë e tregut.

Me kërkesë të autoriteteve Shqiptare, Komuniteti mund të japë asistencë që synon mbështetjen e përpjekjeve të Shqipërisë për ndërtimin e një ekonomie funksionale tregu, si dhe për të përafruar gradualisht politikat e saj me politikat stabilizuese të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar<sup>115</sup>.

Bashkëpunimi ka si synim gjithashtu forcimin e shtetit të së drejtës në fushën e biznesit nëpërmjet një kuadri ligjor tregtar jo-diskriminues dhe të qëndrueshëm.

Bashkëpunimi në këtë fushë përfshin shkëmbim joformal të informacionit në lidhje me parimet dhe funksionimin e Bashkimit Europian Ekonomik dhe Monetar.

#### NENI 88

##### Bashkëpunimi statistikor<sup>116</sup>

Bashkëpunimi midis Palëve përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e statistikave. Ai synon veçanërisht zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna të krahasueshme, të besueshme,

objektive dhe të sakta, që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformës në Shqipëri. Ky sistem duhet gjithashtu të mundësojë Institutin Shqiptar të Statistikës për të përmbushur më mirë nevojat e klientëve vendas dhe ndërkombëtarë (si të administratës publike ashtu dhe sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të nxjerra nga OKB-ja dhe Kodi Statistikor Europian i Praktikës dhe parashikimet e se drejtës Statistike Europiane, dhe duhet të zhvillohet drejt *acquis* e Komunitetit.

#### NENI 89

##### Veprimtaritë bankare, sigurimet<sup>117</sup> dhe shërbime të tjera financiare

Bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit do të përqendrohet në fusha prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushat e veprimeve bankare, sigurimeve dhe shërbimeve financiare. Palët bashkëpunojnë me qëllim ngritjen dhe zhvillimin e një kuadri të përshtatshëm për nxitjen e sektorëve të shërbimeve bankare, sigurimeve dhe atyre financiare në Shqipëri.

#### NENI 90

##### Bashkëpunimi për auditimin<sup>118</sup> dhe kontrollin financiar<sup>119</sup>

Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushat e kontrollit financiar të brendshëm publik (KFBP) dhe auditimit të jashtëm. Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas të KFBP (Kontrolli i Financiar i Brendshëm Publik) dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuar botërisht si edhe me praktikatat më të mira të BE-së.

#### NENI 91

##### Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

Bashkëpunimi mes Palëve, në kuadër të përmbushjes së kompetencave përkatëse në fushën e nxitjes dhe mbrojtjes së investimeve, ka si synim krijimin e një klime të favorshme për investimet private, vendase dhe të huaja, e cila është thelbësore për rimëkëmbjen ekonomike dhe industriale të Shqipërisë.

#### NENI 92

##### Bashkëpunimi industrial<sup>120</sup>

Bashkëpunimi ka si synim të nxisë modernizimin dhe ristrukturimin e industrisë shqiptare dhe sektorëve të veçantë, ashtu si edhe bashkëpunimin industrial midis operatorëve ekonomikë, me synim forcimin e sektorit privat në kushte të cilat sigurojnë mbrojtjen e mjedisit.

Iniciativat e bashkëpunimit industrial do të reflektojnë përparësitë e përcaktuara nga të dy Palët. Ata do të marrin në konsideratë aspektet rajonale të zhvillimit industrial, duke nxitur partneritetet ndërkombëtare kur është e përshtatshme. Iniciativat duhet të synojnë në mënyrë të veçantë ngritjen e një kuadri të përshtatshëm për sipërmarrjet, përmirësimin e menaxhimit dhe ekspertizës, dhe promovimin e tregjeve, transparencës së tregut dhe mjedisit të biznesit.

Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë *acquis* e Komunitetit në fushën e politikave industriale.

## NENI 93

## Ndërmarrjet e vogla e të mesme

Bashkëpunimi mes Palëve synon forcimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme (SME-ve) të sektorit privat dhe merr parasysh fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e SME-ve, si edhe parimet e përfshira në Kartën Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla<sup>121</sup>.

## NENI 94

Turizmi<sup>122</sup>

Bashkëpunimi mes Palëve në fushën e turizmit kryesisht do të synojë përmirësimin e përcjelljes së informacionit mbi turizmin (nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare, bazave të të dhënave) dhe transferimin e ekspertizës (nëpërmjet trajnimeve, shkëmbimeve, seminareve). Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë pjesën e duhur nga *acquis* e Komunitetit që lidhet me këtë sektor.

Bashkëpunimi mund të integrohet në një kuadër rajonal bashkëpunimi.

## NENI 95

## Bujqësia dhe sektori agro-industrial

Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në sferat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e bujqësisë. Bashkëpunimi do të ketë si synim veçanërisht modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet komunitare.

## NENI 96

## Peshkimi

Palët do të shqyrtojnë mundësinë e identifikimit të fushave me përfitim të ndërsjellë dhe interes të përbashkët në sektorin e peshkimit. Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e peshkimit, duke përfshirë respektimin e detyrimeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me rregullat e menaxhimit të Organizatës Ndërkombëtare dhe Rajonale të Peshkimit dhe ruajtjen e burimeve të peshkimit.

## NENI 97

## Doganat

Palët do të vendosin një bashkëpunim në këtë fushë me synim garantimin e përputhjes me dispozitat që do të miratohen në fushën e tregtisë, dhe për të arritur përafrimin e sistemit doganor shqiptar me atë të Komunitetit, duke ndihmuar kështu në hapjen e rrugës për marrjen e masave liberalizuese të planifikuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar për doganat me atë të *acquis*.

Bashkëpunimi do të marrë parasysh në mënyrën e duhur fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushat e doganave.

Protokolli 6 vendos rregullat e asistencës të ndërsjellë administrative mes Palëve në fushën e doganave.

## NENI 98

## Tatimet

Palët vendosin bashkëpunim në fushën e tatimeve duke përfshirë masat që synojnë forcimin e reformave të mëtejshme në sistemin fiskal dhe në ristrukturimin e administratës së tatimeve me synimin që të sigurohet efikasitet në mbledhjen e taksave dhe në luftën kundër evazionit fiskal.

Bashkëpunimi do të marrë parasysh në mënyrën e duhur fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e tatimeve dhe të luftës kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Në këtë aspekt, Palët njohin rëndësinë e përmirësimit të transparencës dhe shkëmbimit të të dhënave ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, në mënyrë që të lehtësohet imponimi i masave që parandalojnë mospagimin ose evazionin e taksave. Për më tepër, Palët konsultohen me njëra-tjetrën, qysh nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, me synim që të eliminohet konkurrenca e dëmshme e tatimeve ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë me qëllim që të sigurohet një trajtim i barabartë në fushën e tatimit të biznesit.

## NENI 99

Bashkëpunimi social<sup>123</sup>

Palët bashkëpunojnë për të lehtësuar reformat e politikave shqiptare të punësimit, në kontekstin e forcimit të reformave ekonomike dhe të integritimit. Bashkëpunimi synon të mbështesë përshtatjen e sistemit shqiptar të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike dhe sociale, dhe përfshin përshtatjen e legjislacionit shqiptar për sa u përket kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për gratë, ashtu si dhe përmirësimin e nivelit të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë për punëtorët, duke ju referuar nivelit ekzistues të mbrojtjes në Komunitet. Bashkëpunimi merr parasysh fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në këtë fushë.

## NENI 100

Arsimi dhe trajnimi<sup>124</sup>

Palët bashkëpunojnë me synim ngritjen e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe trajnimit profesional në Shqipëri, ashtu si edhe të politikave për rininë dhe punës me rininë. Një nga përparësitë për sistemin e arsimit të lartë është arritja e objektivave të Deklaratës së Bolonjës. Palët bashkëpunojnë gjithashtu për të garantuar që aksesin në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Shqipëri të mos i nënshtrohet diskriminimit në bazë të gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë.

Programet dhe instrumentet përkatës të Komunitetit do të kontribuojnë për rritjen e nivelit të strukturave dhe veprimtarive arsimore dhe trajnuese në Shqipëri.

Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në këtë fushë.

## NENI 101

Bashkëpunimi kulturor<sup>125</sup>

Palët marrin përsipër të nxisin bashkëpunimin kulturor. Ky bashkëpunim shërben, vec të tjerash për të rritur mirëkuptimin e ndërsjellët dhe vlerësimin midis individëve, komuniteteve dhe popujve. Palët marrin gjithashtu përsipër të nxisin shumëllojshmërinë kulturore, veçanërisht në kuadrin e Konventës së UNESCO-s për mbrojtjen dhe nxitjen e larmisë të shprehjeve kulturore.

## NENI 102

Bashkëpunimi në fushën audio-vizuale<sup>126</sup>

Palët bashkëpunojnë për të zhvilluar industrinë audio-vizive në Evropë, dhe për të përkrahur bashkëprodhimin në fushat e kinemasë dhe televizionit.

Bashkëpunimi mund të përfshijë, vec të tjerash programet dhe lehtësirat për trajnimin e gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias, ashtu si edhe asistencën teknike ndaj medias publike dhe private, me qëllim përforcimin e pavarësisë së tyre, profesionalizmin dhe lidhjeve me median evropiane.

Shqipëria do t'i përafrojë politikat e saj mbi rregullimin e aspekteve të përmbajtjes së transmetimeve ndërkufitare me ato të KE-së, dhe do të harmonizojë legjislacionin e saj me acquis e BE-së. Shqipëria do t'i kushtojë kujdes të veçantë përvetësimit të së drejtës së pronësisë intelektuale për programet dhe transmetimin me satelit, frekuenca tokësore dhe kablo.

## NENI 103

Shoqëria e informacionit<sup>127</sup>

Bashkëpunimi do të përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komuniteteve për shoqërinë e informacionit. Ai do të mbështesë kryesisht orientimin gradual të politikave dhe legjislacionit të Shqipërisë për këtë sektor me ato të Komunitetit. Palët do të bashkëpunojnë gjithashtu për të zhvilluar më tej Shoqërinë e Informacionit në Shqipëri. Objektivat globale do të përgatisin shoqërinë në tërësi për epokën dixhitale, duke tërhequr investimet dhe duke siguruar aftësinë e rrjeteve dhe shërbimeve për përdorimin e informacionit.

## NENI 104

Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik<sup>128</sup>

Bashkëpunimi do të përqendrohet së pari në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në këtë fushë.

Palët do të forcojnë, në veçanti bashkëpunimin në fushat e rrjeteve të komunikimit elektronik e shërbimeve të lidhura me to, me objektivin përfundimtar të miratimit nga Shqipëria të acquis të Komunitetit në këto sektorë një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

## NENI 105

Informacioni dhe komunikimi<sup>129</sup>

Komuniteti dhe Shqipëria do të marrin masat e nevojshme për të nxitur shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit. Përparësi do u jepet programeve që synojnë dhënien e informacionit bazë lidhur me Komunitetin për publikun e gjerë dhe dhënies së informacioneve më të specializuara për rrethet profesionale në Shqipëri.

## NENI 106

Transporti<sup>130</sup>

Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e transportit.

Bashkëpunimi mund të synojë, veçanërisht në ristrukturimin dhe modernizimin e metodave shqiptare të transportit, duke përmirësuar lëvizjen e lirë të pasagjerëve dhe mallrave, duke zgjeruar mundësinë për në tregun dhe mjetet e transporteve, duke përfshirë portet

dhe aeroportet, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturave multi-modale në lidhje me rrjetet kryesore Trans-Evropiane, në veçanti për të forcuar dukshëm lidhjet rajonale, duke arritur standardet operative të krahasueshme me ato të Komunitetit, duke zhvilluar një sistem transporti në Shqipëri në pajtim dhe të përafuar me atë të Komunitetit, si edhe duke përmirësuar mbrojtjen e mjedisit të transportit.

#### NENI 107

##### Energjia<sup>131</sup>

Bashkëpunimi do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e energjisë, duke përfshirë, sipas rastit, aspektet e sigurisë bërthamore. Ky bashkëpunim do të pasqyrojë parimet e ekonomisë së tregut dhe bazohet në Traktatin ,të nënshkruar, rajonal të Komunitetit për Energjinë me synim integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet Evropiane të energjisë.

#### NENI 108

##### Mjedisi<sup>132</sup>

Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor<sup>133</sup>, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit për fushën e mjedisit.

#### NENI 109

##### Bashkëpunimi në kërkimin shkencor<sup>134</sup> dhe zhvillimin teknologjik

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin në kërkimet civile shkencore dhe zhvillimin teknologjik mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë dhe duke marrë parasysh burimet e disponueshme, aksesin e duhur në programet e tyre përkatëse, të kushtëzuara këto nga nivelet e përshtatshme të mbrojtjes efikase të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik.

Bashkëpunimi do të zbatohet në bazë të marrëveshjeve specifike që do të negociohen dhe përfundohen në bazë të procedurave të miratuara nga secila Palë.

#### NENI 110

##### Zhvillimi rajonal dhe lokal

Palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkuftar, transkombëtar dhe interrajonal.

Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e zhvillimit rajonal.

#### NENI 111

##### Administrata publike<sup>135</sup>

- Bashkëpunimi do të synojë mundësimin e zhvillimit të një administrate publike efçente dhe të përgjegjshme në Shqipëri, e cila mbështet në veçanti vënien në zbatim të



shtetit të së drejtës funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore për të mirën e popullsisë shqiptare në tërësi dhe të zhvillimit normal të marrëdhënieve mes BE-së dhe Shqipërisë.

- Bashkëpunimi në këtë fushë do të përqendrohet kryesisht në ndërtimin e institucioneve, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave transparente dhe të paanshme të rekrutimit, menaxhimit e burimeve njerëzore, zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm dhe promovimin e etikës në administratën publike dhe qeverisjes elektronike. Bashkëpunimi përfshin si administratën qendrore, ashtu dhe atë vendore.

## TITULLI IX

### BASHKËPUNIMI FINANCIAR

#### NENI 112

Për të arritur objektivat e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me nenet 3, 113 dhe 115, Shqipëria mund të marrë asistencë financiare nga Komuniteti në formë granti dhe huaje, duke përfshirë hua nga Banka Evropiane e Investimeve<sup>136</sup>. Ndiurma Komunitare varet nga përmbushja e parimeve dhe kushteve të parashikuara në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme më 29 prill 1997, duke marrë parasysh rezultatet e raporteve vjetore të vendeve në Procesin e Stabilizim Asociimit, Partneriteteve Evropiane, dhe të konkluzioneve të tjera të Këshillit, të cilat i përkasin në mënyrë të veçantë respektimit të programeve rregulluese. Ndiurma që i jepet Shqipërisë do të orientohet drejt nevojave të konstatuara, përparësive të zgjedhura dhe kapacitetit për të thithur dhe për të dhënë rezultate, si edhe masave të marra për reformimin dhe ristrukturimin e ekonomisë.

#### NENI 113

Asistenca financiare<sup>137</sup>, në formën e granteve, duhet të trajtohet nga masat operationale të parashikuara në Rregulloren përkatëse të Këshillit brenda kuadrit të treguesve shumë vjeçarë të caktuar nga Komuniteti pas konsultimeve me Shqipërinë.

Asistenca financiare mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, përafrimit të legjislacionit dhe zhvillimit ekonomik.

#### NENI 114

Me kërkesë të Palës shqiptare dhe në rastet e nevojës së veçantë, Komuniteti, duke u koordinuar me institucionet ndërkombëtare financiare, mund të shqyrtojë mundësinë, duke bërë përjashtim,, e dhënies së asistencës makro-financiare, e cila varet nga kushte të caktuara dhe duke marrë parasysh disponimin e të gjitha burimeve financiare. Kjo asistencë mund të jepet vetëm kur përmbushen kushtet që do të vendosin në kontekstin e një programi për të cilin është rënë dakord mes Shqipërisë dhe FMN-së<sup>138</sup>.

#### NENI 115

Me qëllim që të realizohet përdorimi sa më optimal të burimeve ekzistuese, Palët garantojnë që kontributet e Komunitetit të bëhen në bashkëpunim të ngushtë me ato kontribute të ardhura nga burime të tjera si prej Shteteve Anëtare, vendeve të tjera dhe institucioneve financiare ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, informacioni për çdo burim të asistencës shkëmbehet rregullisht ndërmjet Palëve.

## TITULLI X

## DISPOZITAT INSTITUCIONALE, TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

## NENI 116

Me anë të kësaj Marrëveshjeje krijohet një Këshill i Stabilizim Asociimit, i cili mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e Marrëveshjes. Këshilli mblidhet në një nivel të përshtatshëm në intervale të rregullta kohe dhe kur ta kërkojnë rrethanat. Ai shqyrton çështjet më të rëndësishme që dalin në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe ato çështje dypalëshe ose ndërkombëtare me interes të përbashkët.

## NENI 117

1. Këshilli i Stabilizim Asociimit përbëhet nga anëtarë të Këshillit të Bashkimit Evropian<sup>139</sup> dhe anëtarë të Komisionit të Komuniteteve Evropiane, nga njëra anë, dhe anëtarë të Qeverisë së Shqipërisë, nga ana tjetër.
2. Këshilli i Stabilizim Asociimit vendos rregulloren e brendshme të tij.
3. Anëtarët e Këshillit të Stabilizim Asociimit mund të përfaqësohen, në përputhje me kushtet e parashikuara në rregulloren e brendshme.
4. Këshilli i Stabilizim Asociimit kryesohet me rotacion nga një përfaqësues i Komunitetit Evropian dhe një përfaqësues i Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në rregulloren e brendshme.
5. Banka Evropiane e Investimeve merr pjesë, si vëzhguese gjatë punimeve të Këshillit të Stabilizim Asociimit, për çështjet që lidhen me të.

## NENI 118

Këshilli i Stabilizim Asociimit, me qëllim arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje, ka kompetencën për të marrë vendime brenda objektit të Marrëveshjes, për çështjet e parashikuara në të. Vendimet e marra janë detyruese për Palët, të cilat do të marrin masat e nevojshme për t'i zbatuar vendimet e marra. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund të bëjë rekomandimet përkatëse. Ai harton vendimet dhe rekomandimet e tij me marrëveshje mes Palëve.

## NENI 119

Palët do t'i paraqesin Këshillit të Stabilizim Asociimit çdo mosmarrëveshje që lidhet me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund ta zgjidhë mosmarrëveshjen nëpërmjet një vendimi detyrues.

## NENI 120

1. Këshilli i Stabilizim Asociimit asistohet gjatë zbatimit të detyrave të tij nga Komiteti i Stabilizim Asociimit, i përbërë nga përfaqësues të Këshillit të Bashkimit Evropian e përfaqësues të Komisionit të Komunitetit Evropian, nga njëra anë, dhe përfaqësues të Shqipërisë, nga ana tjetër.
2. Në rregulloren e tij të brendshme, Këshilli i Stabilizim Asociimit vendos detyrat e Komitetit të Stabilizim Asociimit, të cilat përfshijnë përgatitjen e takimeve të Këshillit të Stabilizim Asociimit, dhe vendos për mënyrën e funksionimit të Komitetit
3. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund t'i delegojë Komitetit të Stabilizim Asociimit cilëndo kompetencë të tij. Në këtë rast Komiteti i Stabilizim Asociimit merr vendimet e tij duke ju përmbajtur kushteve të parashikuara në nenin 117.
4. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund të vendosë të ngrejë komitete ose organe të tjera të veçanta, që mund ta ndihmojë atë në kryerjen e detyrave të tij. Në rregulloren e tij

të brendshme, Këshilli i Stabilizim Asociimit vendos përbërjen dhe detyrat e komiteteve apo organeve të tilla dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

#### NENI 121

Komiteti i Stabilizim Asociimit mund të krijojë nën-komitete.

Para përfundimit të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Komiteti i Stabilizim Asociimit do të krijojë nën-komitetet e nevojshme për zbatimin e duhur të Marrëveshjes. Gjatë vendimmarrjes për krijimin e këtyre nën komiteteve dhe përcaktimit të termave të tyre të referencës, Komiteti i Stabilizim Asociimit merr parasysh në mënyrën e duhur rëndësinë e trajtimit të çështjeve të migrimit, veçanërisht në lidhje me zbatimin e dispozitave të neneve 80 dhe 81 të kësaj Marrëveshjeje dhe monitorimin e Planit të Veprimit të BE-së për Shqipërinë dhe rajonin fqinj.

#### NENI 122

Vendoset krijimi i Komitetit Parlamentar për Stabilizim Asociimin. Ky Komitet është forumi i Anëtarëve të Kuvendit Shqiptar dhe Parlamentit Europian për të diskutuar dhe shkëmbyer mendimet e tyre. Ai mbledhet në intervale kohore që vendosen nga ai vetë.

Komiteti Parlamentar për Stabilizim Asociimin përbëhet nga anëtarë të Parlamentit Evropian<sup>140</sup>, nga njëra anë, dhe anëtarë të Kuvendit shqiptar, nga ana tjetër.

Komiteti Parlamentar për Stabilizim Asociimin e vendos vetë rregulloren e brendshme.

Komiteti Parlamentar për Stabilizim Asociimin kryesohet me rotacion nga Parlamenti Europian dhe Parlamenti Shqiptar, sipas dispozitave që do të parashikohen nga rregullorja e brendshme.

#### NENI 123

Brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, çdo Palë merr përsipër t'u sigurojë personave fizikë dhe juridikë të Palës tjetër, pa i diskriminuar<sup>141</sup> në krahasim me shtetasit e vet, të drejtën për të mbrojtur të drejtat individuale dhe të drejtat e tyre të pronës tek organet kompetente gjyqësore dhe administrative të secilës prej Palëve.

#### NENI 124

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk pengon një Palë të marrë masa:

- a) të cilat ajo i konsideron të nevojshme për të parandaluar publikimin e informacionit në kundërshtim me interesat thelbësorë të sigurisë;
- b) të cilat lidhen me prodhimin ose tregtimin e armëve, municioneve ose materialeve luftarake, ose me kërkimin shkencor, zhvillimin ose prodhimin e domosdoshëm për çështjet e mbrojtjes, me kusht që këto masa të mos dëmtojnë kushtet e konkurrencës në lidhje me prodhimet që nuk destinohen për qëllime specifike ushtarake;
- c) të cilat ajo i konsideron thelbësore për sigurinë e saj, në rastin e trazirave serioze të brendshme që çenojnë ruajtjen e rendit dhe të ligjeve, në kohë lufte ose tensioni ndërkombëtar serioz që përbën një kërcënim lufte, ose me qëllim që të përmbushë detyrimet që ka pranuar për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

#### NENI 125

1. Në fushat që mbulon kjo Marrëveshje dhe pa cënuar asnjë dispozitë të veçantë të saj:
  - Rregullimet e zbatuara nga Shqipëria në lidhje me Komunitetin nuk duhet të jenë burim diskriminimi mes Shteteve Anëtare, qytetarëve të tyre, kompanive ose firmave;

- Rregullimet e zbatuara nga Komuniteti në lidhje me Shqipërinë nuk duhet të jenë burim diskriminimi mes qytetarëve, kompanive dhe firmave shqiptare.
- 2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk çenojnë të drejtën e Palëve për të zbatuar dispozitat përkatëse të legjislacionit të tyre fiskal për taksapaguesit, të cilët nuk gjenden në të njëjtën situatë për sa i përket vendbanimit të tyre.

#### NENI 126

1. Palët do të marrin të gjitha masat specifike ose të përgjithshme që duhen për të përmbushur detyrimet e dala nga kjo Marrëveshje. Ato do të kujdesen që objektivat e parashikuara në këtë Marrëveshje të përmbushen.
2. Nëse një nga Palët mendon se Pala tjetër ka dështuar në përmbushjen e një prej detyrimeve të kësaj Marrëveshje, ajo mund të marrë masat e duhura. Para se të veprojë në këtë mënyrë, me përjashtim të rasteve tepër urgjente, ajo i paraqet Këshillit të Stabilizim Asociimit një material me informacionin përkatës për një ekzaminim të plotë të situatës, me synim kërkimin e një zgjidhjeje të pranueshme për Palët.
3. Gjatë përzgjedhjes së masave, përparësi u jepet detyrimisht atyre që çenojnë më pak funksionimin e kësaj Marrëveshje. Këto masa i bëhen të ditura menjëherë Këshillit të Stabilizim Asociimit dhe bëhen objekt konsultimesh në Këshillin e Stabilizim Asociimit, nëse këtë e kërkon Pala tjetër.

#### NENI 127

Palët bien dakord që të konsultohen, sa më shpejt që të jetë e mundur nëpërmjet kanaleve përkatëse, me kërkesë të njërës prej Palëve, për të diskutuar çdo çështje që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje si dhe aspekte të tjera relevante të marrëdhënieve ndërmjet Palëve.

Dispozitat e këtij neni nuk ndikojnë aspak dhe nuk çenojnë nenet 31, 37, 38, 39 dhe 43.

#### NENI 128

Kjo Marrëveshje nuk çënon të drejtat e siguruara nëpërmjet marrëveshjeve ekzistuese ndërmjet një ose më shumë Shteteve Anëtare, nga njëra anë, dhe Shqipërinë, nga ana tjetër, deri atëherë kur të realizohen, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, të drejta të barazvlefshme të individëve dhe operatorëve ekonomikë

#### NENI 129

Protokollet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 dhe Shtojca I deri në VI përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Marrëveshja Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programet e Komunitetit, të nënshkruar më 22 nëntor 2004<sup>1</sup>, dhe Shtojca e saj janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje. Rishikimi i parashikuar në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje Kuadër kryhet nga Këshilli i Stabilizim Asociimit, që ka kompetencën të ndryshojë Marrëveshjen Kuadër nëse është e nevojshme.

---

<sup>1</sup> FZ L.192, 22 korrik 2005, fq.2

## NENI 130

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pakufizuar.

Secila Palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke njoftuar Palën tjetër. Kjo Marrëveshje shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së këtij njoftimi.

## NENI 131

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “Palët” nënkupton Komunitetin, ose Shtetet Anëtare të tij, ose Komunitetin dhe Shtetet Anëtare, në përputhje me kompetencat përkatëse të tyre, nga njëra anë, dhe Shqipërinë, nga ana tjetër.

## NENI 132

Kjo Marrëveshje zbatohet në territoret ku zbatohen Traktatet<sup>142</sup> themeluese të Komunitetit Evropian dhe të Komunitetit Evropian për Energjinë Atomike, sipas kushteve të parashikuara në këto Traktate, nga njëra anë, dhe në territorin e Shqipërisë, nga ana tjetër.

## NENI 133

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian do të jetë visari i Marrëveshjes.

## NENI 134

Kjo Marrëveshje hartohet në duplikatë në të gjitha gjuhët zyrtare<sup>143</sup> të Palëve në tekste njëlloj autentike.

## NENI 135

Palët e ratifikojnë ose miratojnë këtë Marrëveshje në bazë të procedurave të veta.

Instrumentet e ratifikimit dhe miratimit depozitohen tek Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose miratimit.

## NENI 136

Marrëveshja e përkohshme<sup>144</sup>

Në rastin kur në pritje të përfundimit të procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e disa pjesëve të Marrëveshjes, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me lëvizjen e lirë të mallrave ashtu dhe dispozitat përkatëse për Transportin, zbatohen në bazë të Marrëveshjeve të Përkohshme midis Komunitetit dhe Shqipërisë, Palët bien dakord, që në rrethana të tilla, për të përmbushur dispozitat e Titullit IV, nenit 40, 71, 72, 73 dhe 74 të kësaj Marrëveshjeje, Protokollit 1, 2, 3, 4 dhe 6, dhe dispozitat përkatëse të Protokollit 5 të kësaj Marrëveshjeje, fjalët “data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje” nënkuptojnë datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përkohshme në lidhje me detyrimet e parashikuara në dispozitat e sipërpërmendura.

## NENI 137

Prej datës së hyrjes së saj në fuqi, kjo Marrëveshje do të zëvendësojë Marrëveshjen ndërmjet Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi tregtinë dhe bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik, të nënshkruar në Bruksel më 11 maj 1992. Kjo nuk do të prekë asnjë të drejtë, detyrim apo situatë ligjore të palëve, të krijuara nëpërmjet ekzekutimit të asaj Marrëveshjeje.

**Termat Kryesorë**  
**të**  
**“MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT”**

Renditja dhe shpjegimi i termave është bërë sipas radhës së shfaqjes së tyre në tekstin e Marrëveshjes.



## ■ PREAMBULA

<sup>1</sup>**Komuniteti Europian / European Community** (shih nenin 12, 15, 28, 71, 72, 80, 116, 131) – Si term, që nga Traktati i Maastrichtit zëvendësoi atë të Komunitetit Ekonomik Europian, për shkak të dimensionit të ri të kompetencave dhe fushave që mbulon. Komuniteti Europian përfshin, ndër të tjera, fushat e mëposhtme të bashkëpunimit si: bujqësinë, bashkimin doganor, mjedisin, transportin, konkurrencën, lëvizjen e lirë (të njerëzve, mallrave shërbimeve dhe kapitaleve), mbrojtjen e konsumatorit, politikat monetare, politikën e përbashkët tregtare, punësimin, arsimin, kulturën, e tjerë. Të gjitha këto fusha përbëjnë atë që quhet kolona e parë e Bashkimit Europian. Nuk përfshihen politika e jashtme dhe e sigurisë së përbashkët (kolona e dytë e BE-së), si edhe bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet penale (kolona e tretë e BE-së).

<sup>2</sup>**Pakti i Stabilitetit / Stability Pact** – Miratuar si program i veçantë për vendet e Europës Juglindore në Këln të RFGjermane më 10 qershor 1999. Është strategjia e parë gjithëpërfshirëse e bashkësisë ndërkombëtare që synonte parandalimin e konflikteve, nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe integrimin e vendeve të Europës Juglindore në strukturat europiane dhe transatlantike. Në dokumentin themelues theksohej angazhimi i mbi 40 vendeve dhe organizatave partnere për të mbështetur vendet e këtij rajoni “.. në përpjekjet e tyre për paqen, demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe zhvillimin ekonomik...”. Si partnerë të këtij Pakti konsideroheshin vendet e Europës Juglindore (Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Moldavi, Mali i Zi, Serbi, Rumani dhe Maqedoni), Shtetet Anëtare të BE dhe Komisioni Europian, vende të tjera partnere (ShBA, Kanada, Japoni, Zvicër, Norvegji, Turqi dhe Rusi), organizata ndërkombëtare (OKB, OSBE, KE, NATO, UNHCR dhe OECD), institucione ndërkombëtare financiare (Banka Botërore, FMN, BERZH, BEI) dhe disa nga iniciativat rajonale. Nga pikëpamja organizative, Pakti i Stabilitetit mbështetej kryesisht në veprimtarinë koordinuese të Koordinatorit Special dhe ekuipit të tij me rreth 30 vetë (zyrat e punës ishin në Bruksel). Koordinatori Special kryesonte gjithashtu instrumentin më të rëndësishëm të Paktit të Stabilitetit, të ashtuquajturën Tryezë Rajonale, e cila ishte ndare në tre Tryeza Pune, respektivisht në a) Tryezën për Demokratizim dhe të Drejtat e Njeriut b) Tryezën për Zhvillim, Bashkëpunim dhe Rindërtim Ekonomik dhe c) Tryezën për Çështjet e Sigurisë. Roli udhëheqës i BE-së në Paktin e Stabilitetit shpjegohet edhe me synimin e përgatitjes së vendeve të këtij rajoni për anëtarësim të mundshëm në strukturat e tij, me kushtin që secili prej tyre të plotësojë të ashtuquajturat kriteret të Kopenhagenit (1993) lidhur me reformat demokratike, ekonomike dhe institucionale. Mbi këtë bazë BE konceptoi edhe Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit, si një kategori e vecantë e marrëveshjeve në kuptim të nenit 310 të Traktatit të Komunitetit Europian, të cilat do të përfundoheshin më pas me disa nga vendet e Europës Juglindore ( Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Maqedoni, Serbi dhe Mali i Zi). Takimi i tre Tryezave të Punës së Paktit të Stabilitetit dhe bilanci i arritur në sejcilen prej tyre është bërë me 3-4 dhjetor 2007 në Tiranë. Tryeza Rajonale e mbajtur më 27 shkurt 2008 në Sofje të Bullgarisë shënon zyrtarisht edhe takimin e fundit të Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore dhe transformimin e tij në organizatën vijuese, Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (Regional Cooperation Council – RCC).

<sup>3</sup>**Shoqëria civile / Civil society** - Emër kolektiv për të gjitha llojet e organizatave dhe shoqatave që nuk janë pjesë e qeverisë por që përfaqësojnë profesione, grupe interesash ose sektorësh të shoqërisë. Përfshijnë sindikata, shoqata të punonjësve, grupe ambientaliste, shoqata për mbrojtjen e grave, fëmijëve, fermerëve, e tjerë.

Një nga synimet kryesore të BE-së është që të nxisë pjesëmarrjen sa më aktive të shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave të saj.



*Organizatë e shoqërisë civile / Civil Society Organisation* – Nuk ka një përkufizim ligjor ose përgjithësisht të pranuar të termit “organizatë e shoqërisë civile”. Në politikën e tij të konsultimit, Komisioni Europian nuk bën dallim ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe formave të tjera të grupeve të interesit. Komisioni konsulton “palët e interesuara”, ku futen të gjithë ata që dëshirojnë të marrin pjesë në konsultimet për çështjet e ndryshme të organizuara nga Komisioni.

Organizatave e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm për zhvillimin e një dialogu të gjerë mbi politikën e BE-së. Në këtë kuadër Komisioni inkurajon një qasje sa më efektive dhe koherente për përfaqësimin e organizatave të shoqërisë civile në nivelin europian, siç parashikohet në nenin 12 të Kartës së Të Drejtave Themelore. Anëtarësia në një shoqatë është një tjetër mënyrë për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, jo vetëm në jetën politike të vendit, por edhe për ndikimin në politikën e BE-së.

**4Të drejtat e njeriut / Human Rights** - Të drejta që i njihen çdo individ për ta mbrojtur nga cënimet që mund ti vijnë nga organet shtetërore. Shteti ka për detyrë ti njohë dhe ti respektojë këto të drejta. Ato janë universale dhe të barabarta për të gjitha qëniet njerëzore. Të drejtat e njeriut janë ato të drejta dhe përfitime të cilat duhet ti gëzojnë të gjitha qëniet njerëzore. Pas Luftës II botërore të drejta e njeriut janë pjesë e rëndësishme e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ato konsistojnë në respektimin e të drejtave civile dhe politike, ekonomike dhe sociale, si: e drejta e jetës, ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues, ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar, e drejta për proces të rregullt, e drejta e mbrojtjes, liria e shprehjes dhe e organizimit, e drejta për jetë private dhe familjare, liria e besimit, e drejta për sigurim shoqëror, e drejta e lirisë sindikale, e drejta e grevës, e drejta për arsim etj.

Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut përmendet shprehimisht në Aktin Unik Europian të vitit 1986, i cili u përfshi më pas në nenin 6 të Traktatit të Bashkimit Europian.

Garancia e respektimit të të drejtave të njeriut ritheksohet më tej në Traktatin e Amsterdamin, i cili e shtrin jurisdiksonin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë edhe për të drejtat që rrjedhin nga Neni 6 i Traktatit të BE-së. Në të njëjtën kohë, një klauzolë e re pezullimi përcakton se çfarë veprimi mund të ndërmerret në rastet kur një Shtet Anëtar shkel seriozisht dhe në mënyrë të vazhdueshme parimet mbi të cilat është ngritur Bashkimi Europian, përfshirë këtu edhe çështjen e respektimit të të drejtave të njeriut.

BE ka gjithashtu një Kartë të të Drejtave Themelore të miratuar në Këshillin Europian të Nisës më 7 dhjetor 2000. Kjo Kartë përmbledh në një tekst të vetëm, për herë të parë në historinë e Bashkimit Europian, tërësinë e të drejtave civile, politike, ekonomike dhe sociale të qytetarëve europianë dhe të gjithë personave residentë në Bashkimin Europian. Këto të drejta janë të grupuara në 6 seksione të saj, respektivisht në titujt: dinjiteti, liritë, barazia, solidariteti, të drejtat e qytetarit dhe drejtësia. Sipas nenit 6 të Traktatit të Lisbonës, Karta e të Drejtave Themelore bëhet pjesë integrale e Traktateve dhe për këtë arsye ka fuqi detyruese të njëjtë me to.

**5Zgjedhje të lira dhe të ndershme / Free and fair elections** – Proces nëpërmjet të cilit qytetarët zgjedhin lirisht përfaqësuesit e tyre në institucionet demokratike. Standardi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme përbën një nga kriteret kryesore për të përcaktuar një vend demokratik. Së bashku me kërkesën për respektimin e parimeve të shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, zgjedhjet e lira dhe të ndershme përbëjnë të ashtuquajturat kritere politike të Kopenhagenit, të cilat janë kusht themelor që duhet të plotësojë një vend kandidat për anëtarësimin e tij në Bashkimin Europian.

**<sup>6</sup>Bashkimi Europian / European Union** – Bashkim i 27 Shteteve europiane përmes të cilit synohet bashkëpunim i ngushtë politik dhe ekonomik, përmirësimi i jetës së qytetarëve të tyre si edhe forcimi i zërit të Europës në botë. BE u krijua nga Traktati i Maastrichtit në vitin 1992. Kjo paraqitet në Traktat si “një fazë e re, në procesin e krijimit të një bashkimi gjithnjë e më të ngushtë ndërmjet popujve të Europës”. Bashkimi Europian shënon një fazë të re në procesin e integritimit europian, të filluar me krijimin e Komuniteteve Europiane. Bashkimi Europian mbështetet në tre “kolona”. Kolona e parë mbulon dimensionin komunitar “tradicional” (politikën bujqësore të përbashkët, transportin, tregun e përbashkët, etj.), kolona e dytë politikën e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, dhe kolona e tretë mbulon bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet penale.

**<sup>7</sup>Këshilli Europian / European Council** – Një nga institucionet kryesore të Bashkimit Europian. Nënkupton takimin e rregullt të Kryetarëve të Shteteve ose Qeverive të Shteteve Anëtare të BE-së, Presidentit të tij (Këshillit Europian) dhe Presidentit të Komisionit Europian. Në të merr pjesë edhe Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikën e jashtme dhe të sigurisë. Këshilli Europian i jep BE-së vulltin e nevojshëm për zhvillimin e tij si edhe përcakton prioritetet dhe drejtimet e përgjithshme politike. Ai nuk ushtron funksione legjislative.

Sipas Traktatit të Lisbonës, Këshilli Europian do të mbledhet si rregull të paktën dy herë në 6 muaj. Vendimet e Këshillit Europian merren me konsensus.

*Këshilli Europian i qershorit 1993 / June 1993 European Council* – Në Këshillin Europian të Kopenhagenit në 1993 u miratuan kriteret bazë që duhet të përmbushin vendet që synojnë anëtarësimin në BE. Këto kritere janë: institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve; ekonomi funksionale tregu, si edhe adoptimi i *acquis communautaire* (legjislacionit të BE-së).

## ■ NENI 1

**<sup>8</sup>Asociim / Association** – Një marrëdhënie e veçantë ndërmjet BE-së dhe një shteti të tretë. Në nenin 310 të Traktatit të Komunitetit Evropian (KE) parashikohet që Komuniteti mund të përfundojë me një ose më shumë shtete apo organizata ndërkombëtare marrëveshje, të cilat krijojnë një asociim, që përmban të drejta dhe detyrime të ndërsjella, veprime të përbashkëta dhe procedura të posaçme.

Duke patur parasysh marrëveshjet e asociimit të përfunduara nga KE, koncepti i asociimit mund të nënkuptojë:

- një marrëdhënie të veçantë që synon përgatitjen e vendeve të treta për aderim në BE.

- vullnetin për të vendosur marrëdhënie më të ngushta tregtare dhe bashkëpunimi, ose të privilegjuara ndërmjet KE me vendet e treta.

Fushat që përfshihen zakonisht në marrëveshje të tilla janë zhvillimi i marrëdhënieve politike, tregtare, sociale, kulturore dhe të sigurisë.

Si rregull, Marrëveshjet e Asociimit që përfundon BE me vendet e treta, synojnë realizimin prej këtyre të fundit të reformave politike, ekonomike, tregtare dhe respektimi i drejtave të njeriut. Vendit të asociuar i ofrohet akses në tregje, ndihmë teknike dhe financiare, etjerë.

Marrëveshjet e Asociimit duhet të ratifikohen nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së. Sipas nenit 1 të MSA-së, Shqipëria do të jetë pjesë e një asociimi me Komunitetin Europian dhe Shtetet e tij Anëtare, gjë që do të nxisë stabilitetin politik, ekonomik dhe institucional në vend dhe rajon, do të ndihmojë

Shqipërinë të konsolidojë demokracinë dhe shtetin e së drejtës, të përafrojnë legjislacionin e saj me atë të Komunitetit dhe të zhvillohet ekonomikisht.

**<sup>9</sup>Shtetet Anëtare / Member states** – Aktualisht BE ka 27 shtete anëtare që janë: Belgjika, Danimarka, Gjermania, Greqia, Spanja, Franca, Luksemburgu, Holanda, Austria, Portugalia, Irlanda, Italia, Finlanda, Suedia, Mbretëria e Bashkuar, Lituania, Letonia, Estonia, Polonia, Çekia, Sllovakia, Hungaria, Sllovenia, Malta, Qipro, Bullgaria dhe Rumania.

**<sup>10</sup>Demokracia / Democracy** – Në kuptimin e drejtpërdrejtë do të thotë pushtet i popullit. Në kuptim më të përgjithshëm, demokracia është formë e qeverisjes që realizohet në emër dhe për interes të shumicës. Komisioni European ka adoptuar një përkufizim më të ngushtë të demokracisë dhe e ka lidhur atë në mënyrë të pazgjydhshme me shtetin e së drejtës. Me fjalë të tjera, në rast se një vend arrin të realizojë zgjedhje të lira e të ndershme, bën përpjekje të luftojë korrupsionin dhe ka pushtet legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor funksional, ai konsiderohet demokratik. Në nenin 1 të MSA-së parashikohet që Komuniteti European do të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të konsoliduar demokracinë në vend.

**<sup>11</sup>Shtet i së drejtës / Rule of Law** – Një nga elementët më të rëndësishëm e më thelbësor për çdo shtet dhe shoqëri demokratike. Shteti i së drejtës nënkupton ushtrimin e pushtetit shtetëror në përputhje me ligjin. Ky parim synon ndër të tjera të vendosë një masë mbrojtëse ndaj vendimeve arbitrare. Në një shtet të së drejtës, shtetasit kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatave lirish dhe pa pengesë. Demokracia dhe shteti i së drejtës janë dy koncepte të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin.

Një nga qëllimet e BE-së në arenën ndërkombëtare është të forcojë shtetin e së drejtës. Në nenin 78 të MSA-së vendoset theksi tek bashkëpunimi midis Komunitetit dhe Shqipërisë për forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe strukturave që lidhen me zbatimin e ligjit (neni 1).

**<sup>12</sup>Përafrimi i legjislacionit / Approximation of legislation** (neni 70, 112, etj.) – Parim bazë i së drejtës së Komunitetit European, që do të thotë se legjislacioni kombëtar duhet të miratohet dhe strukturohet në përputhje me atë të Bashkimit European. Përafrimi i legjislacionit ndjek rrugën e mëposhtme të sanksionuar nga neni 94 i Traktatit Themelues të Komunitetit European: Me propozim të Komisionit dhe pasi ka konsultuar Parlamentin European dhe Komitetin Ekonomik e Social, Këshilli nxjerr direktiva për përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në vendosjen dhe funksionimin e tregut të përbashkët.

Përafrimi i legjislacionit është një nga objektivat kryesorë të asociimit midis Shqipërisë dhe Komunitetit European (neni 1 i MSA-së). Neni 70 i MSA-së e detyron Shqipërinë të përafrojë legjislacionin ekzistues me atë të BE-së.

**<sup>13</sup>Bashkëpunimi rajonal / Regional Cooperation** – Është një nga elementët më të rëndësishëm të MSA-së, i cili nënkupton bashkëpunimin dhe marrëdhënie të fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të rajonit. Përmes këtij bashkëpunimi synohet të nxitet paqja, stabiliteti dhe zhvillimi ekonomik. Bashkëpunimi rajonal parashikohet shprehimisht në Titullin III të MSA-së dhe përfshin vendet që kanë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi me BE-në, vendet e Procesit të Stabilizim-Asociimit dhe vendet kandidatë për anëtarësim në BE. Bashkëpunimi rajonal do të realizohet edhe përmes marrëveshjeve dypalëshe, të cilat do të nxisin dialogun politik, vendosjen e zonave të tregtisë së lirë ndërmjet palëve, lëshimeve reciproke lidhur me lëvizjen e punëtorëve, vendosjen e kompanive, ofrimin e shërbimeve dhe kapitaleve, si dhe bashkëpunimin në fushën e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme.

## ■ NENI 2

**<sup>14</sup>Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut / Universal Declaration of Human Rights** – Dokument shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i miratuar në kuadër të Këshillit të Europës. Konventa është një traktat ndërkombëtar, sipas të cilit shtetet anëtare të Këshillit të Europës angazhohen të garantojnë të drejtat themelore politike e civile, jo vetëm të shtetasve të tyre. Çdo person brenda juridiksionit të këtyre shteteve, pavarësisht nga seksi, raca, kombësia apo origjina etnike, mbrohet nga dispozitat e kësaj Konvente. Në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut përmenden të drejta të tilla themelore të tilla si e drejta e jetës, lirisë, sigurisë personale, ndalimi i skllavërisë, torturës dhe trajtimit ç'njerëzor e degradues, e drejta e ankimit efektiv, e drejta e mbrojtjes, e drejta për të patur shtetësi, e drejta e martesës dhe krijimit të familjes, e drejta e pronës, garanton lirinë e besimit dhe të shprehjes së lirë, të drejtën e pjesëmarrjes në drejtimin e çështjeve publike, të drejtën e organizimit, etj.

**<sup>15</sup>Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut / European Convention of Human Rights** – Dokument shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i miratuar në kuadër të Këshillit të Europës. Konventa është një traktat ndërkombëtar, sipas të cilit shtetet anëtare të Këshillit të Europës angazhohen të garantojnë të drejtat themelore politike e civile, jo vetëm të shtetasve të tyre. Çdo person brenda juridiksionit të këtyre shteteve, pavarësisht nga seksi, raca, kombësia apo origjina etnike, mbrohet nga dispozitat e kësaj Konvente. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut frymëzohet dhe bazohet kryesisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Konventa është nënshkruar në Romë në vitin 1950 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1953. Nga hyrja në fuqi janë miratuar edhe 13 Protokolle shtesë, që janë pjesë integrale e saj. Sipas Protokollit 11, mekanizmi kryesor për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore që parashikon Konventa, është Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Çdo individ që pretendon se i janë cënuar nga njëri prej shteteve palë, një ose disa prej të drejtave të garantuara nga Konventa, mund t'i drejtohet Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, pasi të jenë shteruar mjetet e brendshme juridike dhe brenda 6 muajve nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm. Të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet që synojnë anëtarësimin në të, e kanë nënshkruar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (aktualisht palë në këtë Konventë janë 47 shtete). Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut e ka selinë në Strasburg. Vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut janë të detyrueshme. Sipas Konventës, Komiteti i Ministrave të Punëve të Jashtme është i ngarkuar më mbikqyrjen e zbatimit të vendimeve të dhëna nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Sipas traktatit të Lisbonës, Bashkimi Europian, si subjekt i të drejtës ndërkombëtare, do të aderojë në një të ardhme të afërt në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Të drejtat themelore të garantuara prej kësaj Konvente konsiderohen njëkohësisht edhe si parime të së drejtës së Bashkimit Europian.

Në nenin 2 të MSA-së theksohet ndër të tjera edhe detyrimi i respektimit të të drejtave të njeriut, ashtu siç janë përkufizuar në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ato do të përbëjnë bazën e politikave të brendshme e të jashtme të Shqipërisë dhe Komunitetit Europian.

**<sup>16</sup>Akti Final i Helsinkit / Helsinki Final Act** – Dokumenti përfundimtar i miratuar në Samitin e Helsinkit të vitit 1975 të organizuar nga Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (KSBE-sot OSBE). Ky Akt i nevojshëm për paqen, sigurinë dhe drejtësinë në Evropë, përmbledh një sërë parimesh të rëndësishme mbi të cilat duhet të bazohen

marrëdhëniet mes shteteve si: respektimi i të drejtave që burojnë nga nocioni i sovraniteti shtetëror, shmangia nga kërcënimet ose përdorimi i forcës, respektimi i parimit të paprekshmërisë së kufijve dhe i integritetit territorial të shteteve, zgjidhja me mjete paqësore e konflikteve, mosndërhyrja në punët e brendshme, respekti i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të drejta të barabarta dhe vetëvendosja e popujve, bashkëpunimi ndërmjet shteteve, si dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare.

<sup>17</sup>**Karta e Parisit për një Europë të Re / Charter of Paris for a new Europe** – Dokument i rëndësishëm i miratuar nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare në Konferencën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (KSBE - sot OSBE) në Samitin e Parisit më 21 nëntor 1990. Dokumenti mbështetet gjerësisht dhe konkretizon më mirë parimet bazë të Aktit Final të Helsinkit. Karta e Parisit vë theksin kryesisht tek nevoja e respektimit të të drejtave të njeriut, parimeve të demokracisë dhe ndërtimit të shtetit të së drejtës, lirisë dhe përgjegjshmërisë ekonomike, krijimit të marrëdhënieve miqësore mes shteteve pjesëmarrëse, sigurisë, unitetit, dimensionit njerëzor, mjedisit, etj.

<sup>18</sup>**Konferenca e Bonit për Bashkëpunimin Ekonomik / Bonn Conference on Economic Co-operation** – U zhvillua në vitin 1990, në kohën e ndryshimeve të thella në sistemet politike dhe ekonomike të shteteve të Europës Qendrore dhe Lindore. Dokumenti bazë i miratuar në këtë Konferencë, synonte të nxiste bashkëpunimin ekonomik mes shteteve anëtare të KSBE (OSBE), veçanërisht për të përmirësuar kushtet e biznesit, shkëmbimet tregtare dhe industriale, etj.

### ■ NENI 3

<sup>19</sup>**Lëvizja e lirë e personave / Movement of persons** – Një e drejtë themelore që buron nga shtetësia e BE-së, të cilën e ka çdo person që ka shtetësinë e njërit prej shteteve anëtare të Bashkimit Europian. Sipas saj, çdo shtetas i BE-së ka të drejtë të udhëtojë, jetojë dhe punojë lirish brenda territoreve të shteteve anëtare në BE.

Në nenet 80 dhe 81 të MSA-së parashikohet që Shqipëria dhe Komuniteti Europian do të bashkëpunojnë për ta patur nën kontroll lëvizjen e personave në territoret përkatëse. Nga ana tjetër, palët do t'u sigurojnë një trajtim të drejtë dhe jo diskriminues personave që banojnë ligjërisht në territoret e tyre, si dhe do të bëjnë përpjekje për integrimin e tyre. Personat që banojnë në mënyrë të paligjshme në Komunitetin Europian ose Shqipëri (qofshin këta shtetas të tyre ose të vendeve të treta) dhe që kanë kaluar tranzit nga territori i njëres palë në atë të palës tjetër, Komuniteti Europian dhe Shtetet Anëtare nga njëra anë, dhe Shqipëria nga ana tjetër, do t'i ripranojnë në territoret e tyre përkatëse.

<sup>20</sup>**Krimi i organizuar / Organised crime** – Në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Krimin e Organizuar Ndërkombëtar (2001), grupet kriminale të organizuara përkufizohen si grupe të strukturuar prej tre ose më shumë personash, që ekzistojnë përgjatë një kohe të caktuar dhe veprojnë në bashkërendim me njëri-tjetrin me qëllim kryerjen e një ose më shumë krimeve ose kundravajtjeve serioze, në mënyrë që të përfitojnë drejtpërsëdrejti ose jo, financiarisht ose materialisht.

Në nenin 78 të MSA-së, theksohet shprehimisht se Shqipëria dhe Komuniteti Europian do të bashkëpunojnë në luftën kundër krimin të organizuar. Për t'u përmendur është fakti se sëbashku me korrupsionin, krimi i organizuar është një nga faktorët pengues serioz të reformave që duhet të përmbushë një vend i cili do të anëtarësohet në BE.

<sup>21</sup>**Korrupsioni / Corruption** – Organizata e Kombeve të Bashkuara e përkufizon korrupsionin si abuzim të pushtetit për përfitime personale dhe një fenomen që përfshin si sektorin publik ashtu dhe atë privat. Megjithëse perceptohet në mënyra të ndryshme nga një vend në tjetrin, korrupsioni ka tendencën të përfshijë sjelljet e mëposhtme: konfliktin e interesave, përvetësimin, mashtrimin, mitmarrjen, korrupsionin politik dhe nepotizmin. Për luftën ndaj korrupsionit dhe suksesin apo dështimin ndaj tij, të dhëna mjaft të vlefshme ofrojnë mekanizma të tillë si Transparency International dhe Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit.

Neni 78 i MSA-së parashikon se Komuniteti European dhe Shqipëria do të bashkëpunojnë në parandalimin dhe luftën kundër fenomenit të korrupsionit, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat. Një nga kërkesat kryesore të luftës ndaj këtij fenomeni, është edhe transparencja e praktikave administrative. Kjo bën pjesë në Kapitullin mbi Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme, që zë një pjesë qendrore në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit. Për t'u përmendur është fakti se së bashku me krimin e organizuar, korrupsioni është një nga faktorët pengues serioz të reformave që duhet të përbushë një vend i cili do të anëtarësohet në BE.

<sup>22</sup>**Pastrimi i parave / Money laundering** – Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara (konkretisht Programit Global të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Pastrimit të Parave) në ekonominë e sotme globale, grupet e krimin të organizuar gjenerojnë shuma të mëdha parash nga trafikimi i drogës, kontrabanda e armëve dhe krimi financiar. “Paratë e pista”, megjithatë, nuk është e lehtë të përdoren nga krimi i organizuar për shkak të dyshimeve që mund të krijohen nga qarkullimi i tyre dhe gjurmëve të provave inkriminuese. Për këtë arsye, kriminelët që duan të përfitojnë nga këto të ardhura të paligjshme, tentojnë të fshehin burimet e të ardhurave dhe të legalizojnë përdorimin e tyre. Ky proces njihet si pastrim parash.

Në vitin 2000 nga ana e BE-së u morën disa masa që synonin luftimin e këtij fenomeni, ndër të cilat veçohen miratimi i Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komunitetit European dhe krijimi i një Zyre Europiane Kundër Mashtrimit si edhe programet e BE-së për luftën kundër drogave të paligjshme.

Sipas nenit 82 të MSA-së, Shqipëria dhe Komuniteti European do të bashkëpunojnë për të parandaluar që sistemet e tyre financiare të përdoren për riciklimin dhe legjitimimin e të ardhurave që mund të vijnë nga aktivitetet kriminale.

<sup>23</sup>**Trafikimi / Trafficking** – Sipas nenit 3 të Protokollit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, trafikim konsiderohet rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave përmes mënyrave të kundraligjshme të tilla si forca, rrëmbimi, mashtrimi ose detyrimi, që kanë për qëllim detyrimin për punësim, robërinë, skllavërinë ose shfrytëzimin seksual.

Në nenin 81 të MSA-së parashikohet ndër të tjera që Shqipëria dhe Komuniteti European do të bashkëpunojnë për parandalimin e të gjitha llojeve të trafikimit të paligjshëm.

## ■ NENI 5

<sup>24</sup>**Terrorizmi / Terrorism** – Në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Financimit të Terrorizmit (1999), terrorizmi përkufizohet si çdo akt që ka për qëllim të shkaktojë vdekjen ose dëmtimin e rëndë trupor të një civili ose çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktivisht në veprimet luftarake. Qëllimi i një akti të tillë, nga natyra

ose konteksti i tij, është të frikësojë popullatën, ose të detyrojë një qeveri apo një organizatë ndërkombëtare të bëjë ose të heqë dorë nga kryerja e një veprimi të caktuar.

Lufta kundër terrorizmit bën pjesë në mandatin e Zyrës Policore të BE-së, Europolit. Gjithashtu Këshilli ka adoptuar një vendim kuadër që synon përkufizimin e terrorizmit dhe vendosjen e sanksioneve të përbashkëta kundër tij.

Në nenin 84 të MSA-së nënvizohet se Shqipëria dhe Komuniteti European do të bashkëpunojnë për të parandaluar dhe luftuar terrorizmin dhe faktorët që mbështesin këtë fenomen të rrezikshëm.

## ■ NENI 6

<sup>25</sup>**Zbatimi i ligjit / Law enforcement** – Një nga kërkesat kryesore të shtetit të së drejtës. Është proces që mundëson bindjen dhe zbatimin e ligjit në realitetin e përditshëm. Aktivitetet në nivelin e BE-së trajtojnë lidhjen dhe koordinimin e agjencive kombëtare përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

Zbatimi i ligjit është një element thelbësor i MSA-së. Ky detyrim parashikohet shprehimisht në Titullin VI të Marrëveshjes.

<sup>26</sup>**Acquis / Acquis** – Gjithë legjislacioni i Komunitetit dhe Bashkimit European. Është tërësia e Traktateve të BE-së, akteve ligjore dhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Traktatet e BE-së konsiderohen njëkohësisht edhe si burime primare të së drejtës së Bashkimit European. Aktet legjislative të BE-së paraqiten në dy forma kryesore, Rregullore dhe Direktiva, të cilat përbëjnë të ashtuquajturën të drejtë sekondare të BE-së. Sipas një raporti të Komisionit European në maj 2009 ka rreth 11000 Rregullore dhe Direktiva që janë në fuqi dhe po rreth 11000 vendime të Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

Vendet që aplikojnë për anëtarësim, duhet të adoptojnë Acquis para se t'i bashkohen BE-së.

Në nenin 70 të MSA-së parashikohet që Shqipëria duhet të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me atë të Komunitetit European, duke nisur nga momenti që kjo Marrëveshje nënshkruhet nga palët. Ky është një proces i gjatë, i vështirë dhe i kushtueshëm, pasi kërkon angazhimin maksimal të kapaciteteve njerëzore të administratës shqiptare, bashkëpunim me ekspertë të fushave përkatëse, si dhe ngritjen e strukturave të reja shtetërore.

<sup>27</sup>**Këshilli i Stabilizim-Asociimit / Stabilisation and Association Council** – Është një organ që përbëhet nga anëtarë të Këshillit të Bashkimit European dhe Komisionit European nga njëra anë, dhe Qeverisë Shqiptare nga ana tjetër. Këshilli i Stabilizim-Asociimit është organi më i lartë vendimmarrës në kuadër të MSA-së. Vendimet e tij janë të detyrueshme. Këshilli merret me administrimin, zbatimin e përgjithshëm të MSA-së dhe zgjidhjen e konflikteve që lindin gjatë zbatimit të saj. Mënyra e funksionimit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit do të përcaktohet përmes një rregulloreje që do të miratohet prej tij. Për përbushjen e detyrave të tij, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të ketë ndihmën e Komitetit të Stabilizim-Asociimit. (neni 6, 116, etj. të MSA-së)

## ■ NENI 7

<sup>28</sup>**Marrëveshja e OBT-së / WTO Agreement** – Organizata e vetme ndërkombëtare që merret me hartimin dhe zbatimin e rregullave të tregëtisë ndërmjet shteteve, e krijuar me Traktatin e Marakeshit më 15 prill 1994. Selia e saj ndodhet në Gjenevë të Zvicrës. Është një forum ku qeveritë negociojnë marrëveshjet tregtare, duke diskutuar dhe zgjidhur problemet që ndeshen në këtë fushë bashkëpunimi me interes të ndërsjelltë. Pjesa më e madhe e çështjeve që mbulon OBT-ja burojnë

nga negociatat e viteve 1986-1994, të ashtuquajturat Raundi i Uruguajt, dhe më herët nga Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT). Në vitin 2001 OBT ka hapur një raund të ri negociatash, të quajtur "Akhenda e Zhvillimit Doha" (Doha Development Agenda).

Synimi i OBT-së është të nxisë dhe ndihmojë operatorët prodhues dhe tregtarë, të liberalizojë tregun, e tjerë.

BE-ja prezantohet në bisedimet e OBT-së nga Komisioni Europian dhe vendimet miratohen me shumicën e kualifikuar për marrëveshjet ndërkombëtare sipas Traktatit të Nisës. (neni 7 i MSA-së)

**<sup>29</sup>Marrëveshja e Përgjithshme për Tregtinë në Shërbime / General Agreement on Trade in Services GATS** – Është organizatë e rëndësishme ndërkombëtare e krijuar në vitin 1995. Ka për qëllim hartimin dhe zbatimin e rregullave që mbulojnë tregtinë ndërkombëtare në fushën e ofrimit të shërbimeve.

Kësaj marrëveshjeje i bashkëgjiten edhe specifikimet kombëtare ku renditen edhe angazhimet e vendeve të veçanta për aksesin e ofertave të huaja në tregun e tyre të brendshëm. (neni 7 i MSA-së)

*Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë / General Agreement on Trade and Tariff (GATT)* – Ka qenë organizata më e rëndësishme ndërshtetërore për bashkëpunimin në fushën e politikave tregtare. GATT u krijua në Gjenevë të Zvicrës në vitin 1947 nga 23 shtete anëtare. Ai është përfshirë ndër vite në raunde të ndryshme negociatash. Raundi më i gjatë dhe më i madh i GATT-së ishte Raundi i Uruguajt, i cili zgjati nga 1986 deri në 1994 (Marrëveshja e Marakeshit 15 prill 1994). Ky vit shënon edhe me transformimin e tij në OBT (Organizata Botërore e Tregtisë). Megjithatë duhet theksuar se ndërsa veprimtaria e GATT përqendrohej kryesisht në negociatat për tregtinë, OBT-ja, përveç kësaj mbulon edhe veprimtaritë tregtare në fushën e shërbimeve, shpikjeve, e tjerë.

Qëllimi i GATT-it ishte promovimi i tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet reduktimit të tarifave dhe masave të ngjashme kufizuese si dhe përmes eliminimit të trajtimeve diskriminuese në këtë fushë.

Shërbimi më i rëndësishëm i GATT-it ishte negociimi i shtrirjes më të gjerë të reduktimit të tarifave nëpërmjet zbatimit të klauzolës së kombit më të favorizuar. Në kuadër të mbrojtjes së industrive vendase, GATT zbatonte vendosjen e tarifave dhe jo vendosjen e masave kufizuese si kuotat e importit. Që prej vitit 1947 deri më 1994, GATT shërbeu si forumi kryesor për negociatat më të rëndësishme tarifore. Bashkimi Europian, si subjekt më vete i së drejtës ndërkombëtare, është anëtarë në GATT-OBT. (neni 7, etj. të MSA-së)

## ■ NENI 8

**<sup>30</sup>Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët / Common Foreign and Security Policy** – Përbën kolonën e dytë të Bashkimit Europian sipas Traktatit të Bashkimit Europian të nënshkruar në Maastricht në vitin 1992. Në kuadër të kësaj kolone, Traktati i Amsterdimit, hyrë në fuqi në 1999, ka krijuar Politikën e Mbrojtjes dhe Sigurisë së Përbashkët (CESDP). Këshilli Europian i Laeken mbajtur në 14-15 dhjetor 2001 miratoi një deklaratë mbi mundësitë operacionale të CESDP. Mbi këtë bazë, BE-së i krijohet mundësia të ndërmarrë masa për menaxhimin e krizave.

Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët do të drejtohen nga Përfaqësuesi i Lartë për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë e Përbashkët, i cili do të emërohet për këtë qëllim nga Këshilli Europian (me shumicë të cilësuar), në bashkëpunim me Presidentin e Komisionit Europian. Përfaqësuesi i Lartë do të drejtojë Këshillin për Çështjet e Jashtme dhe do të jetë njëkohësisht edhe një nga Zëvendës Presidentët e Komisionit. (shih nenin 9 të Traktatit të Lisbonës).



## ■ NENI 9

<sup>31</sup>**Dialog politik / Political Dialogue** – Është një nga elementët esenciale të marrëveshjeve të BE-së me vendet e treta. Si i tillë nënkuptohet një proces i tërë ndërveprimi për trajtimin e çështjeve me interes të përbashkët si dhe formulimi dhe administrimi i politikave që synojnë arritjen e objektivave të caktuara strategjike. Dialogu politik mes palëve që përmend neni 9 i MSA-së, ka si synim kryesor arritjen e një bashkëpunimi sa më të ngushtë, përfshirë këtu edhe anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Konkretisht, përmes këtij dialogu duhet të arrihet plotësimi i kriterëve të Kopenhagenit (forcimi i institucioneve demokratike, respektimi i parimeve të demokracisë, shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut, etjere), forcimi i bashkëpunimit rajonal, ndalimi i përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, lufta kundër terrorizmit dhe kimit të organizuar, trajtimi i çështjeve të migracionit, bashkëpunimi për çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë, etjere. Dialogu politik BE – Shqipëri do të zhvillohet kryesisht në kuadër të institucioneve të përbashkëta për zbatimin e MSA-së, ku rol qendror do të kenë Këshilli i Stabilizim-Asociimit, Komiteti i Stabilizim-Asociimit si dhe Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit. Megjithatë, përveç sa më sipër ky dialog mund të zhvillohet edhe përmes formave të tjera, si ndërmjet Zyrarëve më të lartë të shtetit shqiptar me Presidencën e Këshillit të Bashkimit Europian dhe Komisionin, në rrugë diplomatike dhe përmes bashkëpunimit në Organizata të tjera ndërkombëtare si OKB, OSBE, Këshilli i Europës, etjere.

<sup>32</sup>**Presidenca e Këshillit të Bashkimit Europian / Presidency of the Council of the European Union** – Kjo është kryesia e Bashkimit Europian. Secili vend i BE-së ka të drejtën ta mbajë Presidencën për gjashtë muaj. Presidenca drejton të gjitha Grupet e Punës, COREPER-in dhe takimet e Këshillit. Ajo luan një rol kryesor në organizimin e punës së Këshillit, përcaktimin e prioritetëve, organizimin dhe drejtimin e mbledhjeve. Sipas vendimit të Këshillit të BE-së datë 01.01.2007, Presidenca 6 mujore e Këshillit të BE-së do të jetë: 2010 Spanjë-Belgjikë; 2011 Hungari – Poloni; 2012 Danimarkë - Qipro; 2013 Irlandë - Lituani; 2014 Greqi – Itali; 2015 Letoni – Luksenburg, etj.

<sup>33</sup>**Komisioni / Commission** – Një nga institucionet kryesore të BE-së. Komisioni vepron si ekzekutiv i tij, si një kabinet qeveritar me 27 anëtar. Propozon aktet ligjore, zbaton vendimet, mbikëqyr zbatimin e traktateve dhe legjisllacionin respektiv, si edhe aktivitetet e përditshme të BE-së. Përfaqëson BE-në në tërësi dhe jo shtetet anëtare. Sipas Traktatit të Lisbonës, Këshilli Europian i propozon Parlamentit Presidentin e Komisionit, duke patur parasysh zgjedhjet më të fundit parlamentare. Pasi votohet në Parlament me shumicë të thjeshtë, Këshilli i Bashkimit Europian në bashkëpunim me Presidentin e Komisionit, propozojnë përbërjen e Komisionit dhe portofolet përkatëse. Pas kësaj, Komisioni si i tërë votohet (zgjidhet) nga Parlamenti Europian. Përgjegjësitë kryesore të Komisionit janë:

- Përcakton strategjitë afatmesme.
- Propozon aktet ligjore.
- Përfaqëson BE-në në bisedimet mbi çështjet tregtare.
- Harton buxhetin.

Presidenti i Komisionit përcakton drejtimet e punës së Komisionit, përcakton organizimin e brendshëm në mënyrë që Komisioni të punojë si një trupë e vetme, e tjerë.

Selia e Komisionit Europian është në Bruksel, por ai ka një numër zyrash në Luksemburg, përfaqësi në të gjitha shtetet anëtare të BE-së si dhe delegacione në disa prej kryeqyteteve të botës.

## ■ NENI 9

*Kombet e Bashkuara / United Nations* – Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) u krijua zyrtarisht më 24 tetor 1945. Aktualisht ka 192 vende anëtare. Nga vendet europiane, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar janë anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Qëllimi kryesor i OKB-së është ruajtja e paqes dhe e sigurisë ndërkombëtare. Në këtë kuadër, ajo nxit zhvillimin e marrëdhënieve miqësore mes shteteve bazuar në parimet e barazisë, bashkëpunimit, vetëvendosjes së popujve, respektimit të të drejtave të njeriut etj. Selia e OKB-së është në Nju Jork, por ka zyra gjithashtu edhe në Gjenevë dhe Vjenë.

<sup>34</sup>**Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE) / Organisation of Security and Cooperation in Europe (OSCE)** – OSBE-ja u krijua në vitin 1973 me emrin Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (KSBE). OSBE është organizata ndërqeveritare më e madhe në botë për çështjet e sigurisë. Trajton çështje mbi kontrollin e armatimit, të drejtat e njeriut, lirinë e shtypit, zgjedhjet e lira etj. Më 1 janar 1995 ndryshon emrin nga KSBE në OSBE, si rezultat i Konferencës së Budapestit të vitit 1994. OSBE ka një Sekretariat, Këshillin, Asamblenë Parlamentare, Qendrën për parandalimin e konflikteve dhe Zyrën për Zgjedhje të Lira që më vonë u shndërrua në Zyrën për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Drejtimi politik i kësaj organizate përcaktohet nga takimet e kryetarëve të shteteve apo qeverive të vendeve anëtare.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mbulon kryesisht çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe reformën e sistemit gjyqësor.

## ■ NENI 10

<sup>35</sup>**Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit / Stabilisation and Association Parliamentary Committee** – Ngritja e Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit parashikohet në nenin 121 të MSA-së. Ky Komitet do të përbëhet nga anëtarë të Parlamentit Shqiptar dhe të Parlamentit Europian. Qëllimi i ngritjes së këtij institucioni është që parlamentarët e të dyja palëve të takohen rregullisht për të shkëmbyer mendime dhe analizuar ecurinë e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit trajton probleme të përgjithshme dhe mund t'i paraqesë rekomandime Këshillit të Stabilizim-Asociimit për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me zbatimin e MSA-së.

## ■ NENI 12

<sup>36</sup>**Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë / Memorandum of Understanding on Trade Facilitation and Liberalisation** – Liberalizimi dhe lehtësimi i tregtisë në rajon përbën një nga objektivat kryesorë të Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore në fushën e tregtisë. Në këtë kuadër, më 27 qershor 2001 u nënshkrua në Bruksel Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë, i cili synon nxitjen e bashkëpunimit ekonomik në rajonin e Ballkanit, si dhe ndërmjet këtij Rajonit dhe vendeve të tjera të Europës dhe botës, duke përfshirë edhe krijimin e zonave të tregtisë së lirë.

## ■ NENI 13

<sup>37</sup>**Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme / Justice and Home Affairs** – Sipas Traktatit të Maastrichtit (1992) përbënte kolonën e tretë të BE-së. Traktati i Amsterdimit (1997) e riformuloi bashkëpunimin në drejtësi dhe çështjet e brendshme, duke e fokusuar atë në çështjet policore dhe gjyqësore në çështjet penale. Aktualisht kjo është edhe kolona e tretë e BE-së. Në këtë kuadër bashkëpunohet në fushën e zbatimit

të vendimeve penale, unifikimin e normave penale që kanë të bëjnë me luftën ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikut të drogës, trafikimit të qënieve njerëzore, luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit, e tjerë. Në aspektin gjyqësor, bashkëpunimi synon njohjen e vendimeve penale, lehtësimin e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare, transferimet për vuajtjen e mëtejshme të dënimit penal, harmonizimin dhe njohjen e procedimeve penale, e tjerë.

Ashtu si në fushën e politikës së jashtme dhe sigurisë së përbashkët, edhe bashkëpunimi policor dhe gjyqësor në çështjet penale zhvillohet jashtë kuadrit vendimmarrës të Komunitetit European.

#### ■ NENI 15

<sup>38</sup>**Vend kandidat / Candidate Country** – Status i veçantë që e vendos një vend të caktuar në situatë pritje për fillimin e bisedimeve që duhet të shpjen drejt një anëtarësimi të plotë në BE. Aktualisht këtë status e kanë Turqia dhe Kroacia, ndërsa Shqipëria dhe Mali i Zi kanë aplikuar për marrjen e këtij statusi. Vendimi për marrjen e statusit të vendit kandidat merret nga Këshilli mbi bazën e mendimit paraprak të dhënë nga Komisioni European.

#### ■ NENI 16

<sup>39</sup>**Lëvizja e lirë e mallrave / Free movement of goods** – Qëllimi kryesor për krijimin e Komuniteteve Europiane ishte zhvillimi ekonomik, rritja e qëndrueshmërisë ekonomike, standardeve të jetesës dhe marrëdhënieve më të ngushta midis shteteve anëtare. Mënyra kryesore për të arritur këtë objektiv ishte krijimi i një tregu të përbashkët, ku mallrat mund të lëvizin lirisht. Për arritjen e lëvizjes së lirë të mallrave është e nevojshme eliminimi i barrierave kufizuese, qofshin këto me karakter doganor, fizik, teknik, fiskal apo masa me efekt të njëjtë me to, të cilat krijojnë diskriminim apo kufizojnë tregtinë e mallrave midis shteteve. Në përputhje me këtë objektiv, vendet anëtare duhet të shmangin vendosjen e masave kufizuese mbi mallrat e importuara, të eksportuara apo mallrat tranzit në vendet e BE-së. Lëvizja e lirë e mallrave mundëson rritjen e efikasitetit prodhues pasi bën të mundur konkurrencën direkte midis prodhuesve në vende të ndryshme anëtare. Lëvizja e lirë e mallrave në Traktatin e Komunitetit European gjendet e shprehur në Titullin I nenet 23-31 dhe arrihet nëpërmjet bashkimit doganor dhe parandalimit të kufizimeve sasiore ndërmjet vendeve anëtare. (neni 16 e në vazhdim i MSA-së)

<sup>40</sup>**Zona e tregëtisë së lirë / Free trade area** – Lëvizja e lirë e mallrave është e lidhur ngushtë me zonën e tregëtisë së lirë, në të cilën mallrat qarkullojnë lirisht. Një zonë e tregëtisë së lirë përfshin të paktën dy territore doganore ndërmjet të cilave hiqen pengesat doganore dhe kufizimet me efekt të njëjtë. Shembuj të një zone tregtie të lirë janë Zona Europiane e Tregëtisë së Lirë (European Free Trade Area) në Europë, Zona e Tregëtisë së Lirë në Amerikën e Veriut (North America Free Trade Area), apo Mercosur-i në Amerikën e Jugut. Kuptimi i zonës së tregëtisë së lirë gjendet i shprehur dhe në nenit XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë dhe Tarifat (GATT).

Zona e tregëtisë së lirë ndryshon nga një bashkim doganor, pasi aty nuk zbatohet një tarifë e përbashkët doganore për vendet e treta jo anëtare në bashkimin doganor, që nënkupton se çdo vend anëtar në të zbaton tarifat përkatëse doganore mbi importet e vendeve të treta.

Në nenin 16 të MSA-së parashikohet vendosja progresivisht e një zone të tregëtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit për një periudhë që do të zgjasë maksimalisht deri në dhjetë vjet nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes.

**41****Nomeklatura e Kombinuar / Combined nomenclature** – Nomeklaturë e kombinuar quhet klasifikimi i përdorur brenda territorit të Bashkimit Europian për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi tregëtinë. Nomeklatura e Kombinuar u zbatua për herë të parë në vitin 1988. Që nga kjo periudhë, bëhet azhornimi vjetor dhe botimi i saj në Fletoren zyrtë të KE-së. Ky klasifikim bazohet në përshkrimin e njëjtë të produkteve dhe në sistemin e kodifikimit që mbulon të gjitha produktet që mund jenë subjekt të transaksioneve ndërkombëtare dhe që gëzojnë përmasa fizike.

Sipas nenit 16 të MSA-së, Shqipëria detyrohet që të klasifikojë mallrat sipas këtij sistemi.

*Kapitujt 25 – 26 të Nomeklaturës së Kombinuar* - Shërbejnë si dokument bazë për zbatimin e dispozitave të MSA-së Kapitulli IV, Kreu I ku janë listuar produktet industriale mbi të cilat veprojnë dispozitat e këtij Kreu.

*Kapitujt 72 – 73 të Nomeklaturës së Kombinuar* - Shërbejnë si dokument bazë për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mbi produktet e hekurit dhe çelikut, të cilët përjashtohen nga dispozitat e nenit 18 dhe 19 të MSA-së. Gjithashtu, në Nenin 23 të Marrëveshjes parashikohet Protokollin 1, i cili parashikon regjimin që zbatohet për produktet e hekurit dhe çelikut.

**42****Tarifat / Tariffs** – Si rregull tarifat janë taksa mbi mallrat e importuara dhe në raste më të pakta edhe mbi mallrat e eksportuara. Tarifat dallohen nga taksat e tjera, pasi qëllimi kryesor i tyre nuk është financiar, por ekonomik. Ato nuk synojnë të rrisin të ardhurat në buxhetin e shtetit, por mbrojtjen e industrisë së vendit nga konkurrenca e huaj.

Sipas nenit 16 të MSA-së, Shqipëria duhet të respektojë reduktimet tarifore që ekzistojnë deri në ditën para nënshkrimit të Marrëveshjes. Për këtë qëllim duhet krijuar një sistem nëpërmjet të cilit Shqipëria duhet të azhurnojë BE-në me informacion mbi tarifat ekzistuese që aplikohen deri ditën e nënshkrimit të Marrëveshjes si dhe gjatë zbatimit të saj.

## ■ NENI 17

**43****Produkte Industriale / Industrial products** – Nënkuptohen ato produkte të cilat janë prodhuar në territorin e një vendi dhe që bëjnë pjesë në Kapitujt 25-97 të Nomeklaturës së Kombinuar. (neni 17 i MSA-së)

**44****Marrëveshja për Bujqësinë miratuar në kuadër të GATT 1994 / Agreement on Agriculture GATT 1994** – Marrëveshja për Bujqësinë është pjesë përbërëse e marrëveshjeve të OBT-së, të cilat shpesh njihen dhe si “Akti Final përfshirës i rezultateve të Raundit të Uruguay-it për negociatat e tregëtisë shumëpalëshe”. Akti Final, është nënshkruar në 15 prill 1994 dhe përmban tekste ligjore që janë rezultat i bisedimeve të nisura në Uruguay në shtator të vitit 1986.

Marrëveshja për Bujqësinë shërben si pikë referimi për reformat afatgjata në fushën e tregëtisë së produkteve bujqësore. Synimi i saj është fuqizimi i normave në këtë fushë si edhe parashikueshmëria dhe stabiliteti i vendeve importuese dhe exportuese të produkteve bujqësore. Paketa bujqësore parashikon masa të tilla që nxisin përcaktimin e politikave të brendshme lidhur me tregëtinë shumëpalëshe dhe lejojnë veprime të cilat mundësojnë fleksibilitet në zbatimin e angazhimeve të marra.

Marrëveshja për Bujqësinë shërben si dokument bazë për zbatimin e dispozitave të MSA-së. Në Aneksin I. § I, (ii) të saj radhiten prodhimet mbi të cilat nuk zbatohen dispozitat e Titullit IV, Kapitulli I.(GATT 94, nenet 15, 16, 17, 24, 38 etj të MSA-së).

<sup>45</sup>**Traktati themelues i Komunitetit European të Energjisë Atomike (KKEA) / Treaty establishing the European Atomic Energy Community**

– Njihet ndryshe dhe si Traktati i Euroatomit. Është një nga katër traktatet themeluese në të cilat bazohet integrimi evropian. Traktati i Euroatomit u nënshkrua në Romë në 25 mars 1957 dhe ka hyrë në fuqi në 1 janar 1958, së bashku me Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian.

Synimi kryesor i krijimit të KEEA ka qenë dhe mbetet zhvillimi i kërkimit shkencor dhe përdorimi i energjisë bërthamore për qëllime paqësore. Pra më konkretisht detyra e tij kryesore është që brenda BE-së të kontrollojë, koordinojë dhe të nxisë zhvillimin teknik dhe kërkimin shkencor të industrisë bërthamore për përdorime civile. Në këtë kuadër, realizon programe zhvillimi duke lejuar lëvizjen e lirë të lëndëve të para nukleare, pajisjet, kapitalet investuese dhe të ekspertëve brenda Komunitetit. Për arritjen e objektivave të tij, Euroatom përfundon kontrata, bën sigurimin e lëndëve të para nukleare, vendos standardet për mbrojtjen e punonjësve dhe popullsisë nga rreziqet e rrezatimeve radioaktive etj.

Neni 17 i MSA-së parashikon se Traktati i Euroatom do të shërbejë si dokument për të rregulluar tregëtinë midis palëve lidhur me produktet që mbulohen prej tij.

■ **NENI 18**

<sup>46</sup>**Detyrime doganore / Customs duties** – Janë detyrime të importit ose eksportit apo taksa të tjera që kanë efekt të njëjtë me detyrimet doganore, të cilat duhet të paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave.

Detyrimet doganore paraqiten në dy forma, në trajtën e një **tarife specifike** dhe **tarifës ad valorem (në vlerë)**. Tarifa specifike vilet mbi sasinë e mallrave duke patur si kriter peshën, masën apo sasinë fizike të tyre. Këto tarifa zbatohen kryesisht për qëllime mbrojtëse, pasi niveli i tyre ndryshon në mënyrë të anasjelltë me çmimet e importit. Për shembull një import i taksuar me 5 EUR për ton, dhe që kushton 100 EUR për ton, mund të ketë një tarifë efektive prej 5%. Por në qoftë se çmimi i tij bie në 80 EUR për ton dhe përbën një kërcënim për prodhuesit vendas, tarifa efektive mund të rritet në më shumë se 6%. **Tarifa ad valorem** llogaritet “sipas vlerës”, ose si një përqindje e vlerës së mallrave të zhdoganuara. Për shembull 15 përqind *ad valorem* nënkupton 15 përqind të vlerës. Tarifa *ad valorem* konsiderohet si më e preferuar, por më e vështirë për t’u zbatuar, pasi përcaktimi i vlerës së mallrave kërkon procedura të ndërlikuara.

Neni 18 i MSA-së parashikon heqjen e detyrimeve doganore për mallrat me origjinë shqiptare në momentin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së përkohshme. Gjithashtu, siç parashikohet në nenin 19, kufizimet tarifore duhet të vendosen nga autoritetet shqiptare duke përdorur sistemin e shifrave të plota, pa presje dhjetore.

<sup>47</sup>**Kufizime sasiore / Quantitative restrictions** – Janë kufizime të qarta, ose kuota për sasinë fizike të një produkti të veçantë, i cili mund të eksportohet ose importohet gjatë një periudhe të caktuar kohore. Si rregull përlllogaritet nga vëllimi, dhe në raste më të rralla nga vlera.

Kuotat administrohen kryesisht nëpërmjet një sistemi liçensues. Sipas Nenit XI të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregëtinë dhe Tarifat (GATT), ndalohet vendosja e kufizimeve sasiore perveçse në rastet kur është përcaktuar ndryshe në nenet e tjera të GATT. Kështu, Neni XIX lejon kuotat për “mbrojtjen” e disa industrive, duke mos iu shkaktuar atyre dëme nga rritja e menjëhershme e importeve. Nenet XII dhe XVII parashikojnë se kuotat mund të vendosen për arsye të “bilancit të

pagesave”, në rrethana që parashikohen në Nenin XV. Neni XX i GATT-it parashikon mundësinë e marrjes së masave të veçanta (kufizimeve) për shkak të shëndetit publik, cënimit të rezervave valutore, për artikujt me interes historik ose arkeologjik, si dhe për disa kategori të tjera mallrash. Neni XXI parashikon si shkak të tillë edhe sigurinë kombëtare. Megjithatë duhet patur parasysh se në çdo rast, kufizimet sasiore nuk duhet të jenë diskriminuese.

Neni 18 i MSA-së parashikon heqjen nga ana e Komunitetit të kufizimeve sasiore dhe masave me efekt të njëjtë mbi importet me origjinë shqiptare në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

Nga ana tjetër, sipas nenit 26 të MSA-së, Shqipëria duhet të heqë kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë me to, të respektojë angazhimet e marra në OBT dhe të mos vendosë asnjë masë të re kufizuese mbi importin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit me origjinë komunitare.

## ■ NENI 19

<sup>48</sup>**Shtojcë / Annex** – Konsiderohen si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe si të tilla janë të detyrueshme për palët. MSA ka si pjesë integrale të saj IV Shtojca:

Shtojca I parashikon detyrimet doganore për mallrat me origjinë komunitare të importuara në Shqipëri, të cilat në bazë të nenit 19 të MSA-së nuk janë subjekt i shfuqizimeve doganore menjëherë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së përkohshme, dhe do të reduktohen në mënyrë progresive gjatë periudhës tranzitore.

Shtojca II (a) parashikon tarifat koncensionare shqiptare për prodhimet primare bujqësore të prodhuara në komunitet [neni 27(3)(a)]

Shtojca II (b) parashikon tarifat e koncesioneve shqiptare për produktet kryesore bujqësore të prodhuara në Komunitet [neni 27(3)(b)]

Shtojca II (c) parashikon tarifat koncensionare shqiptare për produktet bazë bujqësore të prodhuara në Komunitet [neni 27(3)(c)]

Shtojca III parashikon tarifat koncensionare të Komunitetit për peshkun dhe nënproduktet e peshkut shqiptar

Shtojca IV – (neni 49) – ka të bëjë me Vendosjen: Shërbimet financiare

Shtojca V (neni 73) – ka të bëjë me të drejtat e Pronësisë Intelektuale, Industriale dhe Tregtare

## ■ NENI 23

<sup>49</sup>**Protokollet / Protocols** – Janë pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe janë të detyrueshme për palët. MSA-ja ka 5 protokolle:

Protokolli 1 mbi prodhimet e hekurit dhe çelikut

Protokolli 2 mbi tregtinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit në sektorin e produkteve bujqësore të përpunuara

Protokolli 3 mbi konçensionet preferenciale reciproke për disa lloje vere, njohja reciproke dhe kontrolli i verërave, pijeve alkoolike dhe emrat e verërave të aromatizuara

Protokolli 4 përkufizimi i konceptit “produkte origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ

Protokolli 5 mbi transportin tokësor

Protokolli 6 mbi ndihmën e ndërsjelltë administrative në çështje doganore

■ **NENI 24**

<sup>50</sup>**Produkte bujqësore dhe të peshkimit / Agriculture and fisheries products** – Se çfarë përfshihet në termin “produkte”, përcaktohet në Shtojcën 1 të Marrëveshjes për Bujqësinë të OBT-së. Ky përkufizim mbulon jo vetëm produktet kryesore bujqësore si gruri, qumështi dhe gjënë e gjallë, por edhe produktet e përfuara prej tyre si buka, gjalpi dhe mishi, si dhe të gjithë produktet e përpunuara bujqësore si çokolllat apo llojet e sallameve. Gjithashtu, këtu përfshihen edhe verërat, pijet alkoolike dhe produktet e duhanit, fibra si pambuku, leshi e mëndafshi, si dhe lëkurat e papërpunuara të destinuara si lëndë e parë për prodhimin e lëkurës. (neni 24 i MSA-së)

■ **NENI 25**

<sup>51</sup>**Produkte bujqësore të përpunuara / Agricultural Processed Products** – Procesi i përpunimit nënkupton sasi të produkteve të përdorura për prodhimin e një artikulli ushqimor për të cilin ekziston një bilanc i veçantë. Një shembull i produkteve tërësore të përpunuara përfshin sasi të caktuara të drithërave për t’u përdorur në prodhimin e artikujve ushqimorë për të cilët ekziston një bilanc më vete. Tregtimi dhe rezervat e këtyre produkteve nuk përfshihen në bilancin e drithërave por në bilancin përkatës të këtyre produkteve, si misri i përdorur në vajin e misrit.

*Procesi i përpunimit nga prodhuesit* – Hyrjet nën këtë titull duhet të tregojnë sasi të prodhuara që nevojiten për përpunim të mëtejshëm nga prodhuesit bujqësorë (psh qumështi i përpunuar për të bërë gjalp ose djathë, mollët e përpunuara për të bërë verë ose musht molle) por vetëm në kuadër të aktiviteteve përpunuese të cilat janë të ndryshme nga aktiviteti kryesor bujqësor. Vetëm produktet e gjalla (psh qumështi, mollët) duhet të regjistrohen dhe jo produktet e përpunuara të prodhuara prej tyre. Me fjalë të tjera puna që bëhet gjatë procesit të përpunimit nuk merret parasysh nën këtë titull.

■ **NENI 27**

<sup>52</sup>**Kuotat tarifore / Tariff quotas** – Kuotat janë sasia e mallrave të caktuara që një vend mund të importojë në territorin e tij, pa vendosjen e masa kufizuese ose detyrimeve shtesë. Ato janë adoptuar gjatë Raundit të Uruguajit si një mënyrë për të siguruar më tepër akses në tregje me tarifa më të larta. Një vëllim i caktuar importesh lejohet me një tarifë të caktuar, kryesisht më të ulët ose pa barriera tarifore. Në momentin që plotësohet kuota, mbi importet zbatohet një tarifë më e lartë. Për shembull, një vend zëvendëson kuotën prej 10,000 ton me një kuotë tarifore prej 10,000 ton. Ndryshimi qëndron në faktin në rastin e një kuote “absolute” është e pamundur të importohet më tepër sesa sasia që përcaktohet prej saj, ndërsa në rastin e një kuote tarifore importet mund të tejkalojnë sasinë prej 10,000 ton, por tashmë duke aplikuar mbi të një tarifë.

Neni 27 i MSA-së, parashikon se do të eliminohen tarifat doganore për importin e disa produkteve bujqësore me origjinë nga Komuniteti të radhitura në Shtojcën II(c) brenda një kuote tarifore të përcaktuar, e cila do të rritet nga viti në vit.

■ **NENI 29**

<sup>53</sup>**Liberalizimi i tregtisë / Liberalisation of trade** – Reduktimi i tarifave dhe masave të tjera me efekt të njëjtë që kufizojnë tregëtinë në mënyrë të njëanshme apo shumëanshme. Liberalizimi i tregëtisë ka qënë objektivi i të gjithë raundeve të negociatave mbi tregëtinë në Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tregëtinë dhe Tarifat (GATT).

Sipas nenit 29 të MSA-së, palët angazhohen të monitorojnë tregun

e produkteve bujqësore dhe të peshkimit, me synim liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë me Komunitetin në këtë fushë. Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të shërbejë si një forum midis palëve për të diskutuar dhe shqyrtuar mundësinë e dhënies së konçesioneve të mëtejshme palëve për liberalizimin e produkteve bujqësore dhe të peshkut, duke marrë parasysh politikat e bujqësisë dhe peshkimit në Komunitet e në Shqipëri, si dhe rolin e këtyre produkteve në ekonominë shqiptare.

### ■ NENI 33

<sup>54</sup>**Pezullimi / Standstill** – Nënkupton angazhimin për të mos vendosur apo imponuar detyrime doganore ose masa me efekt të njëjtë mbi importet dhe eksportet, të cilat do të ishin më kufizuese apo diskriminuese krahasuar me masat ekzistuese. Kjo klauzolë përdoret gjithashtu edhe kur palët në marrëveshje bien dakort për të mos vënë masa të reja kufizuese mbi tregtinë.

Sipas nenit 33, nga hyrja në fuqi e MSA-së Shqipëria angazhohet të eliminojë detyrimet doganore të reja për importet dhe eksportet, ose tarifat e reja me efekt të njëjtë me to.

<sup>55</sup>**Regjimi i importit / Import regime** – Konsiderohet hyrja e mallrave dhe shërbimeve për konsum në tregun e një vendi. Një vend përmirëson mirëqënien e tij duke importuar një sërë shërbimesh dhe mallrash me cilësi më të lartë dhe me kosto më të ulët sesa mund të prodhoheshin në vend. Importet në një vend anëtar mund të jenë a) mallra të cilët hyjnë në territorin e shtetit anëtar nga një vend jo anëtar dhe janë vendosur në procedurat doganore për t'u vënë në qarkullim menjëherë apo pas një qëndrimi në magazinat doganore, apo pas një përpunimi të brendshëm, dhe b) lëvizje të mallrave të përfshira në statistikën e Eurostatit (Zyra e Statistikës së Bashkimit Europian).

Sipas nenit 33 të MSA-së Shqipëria dhe Komuniteti në ndjekjen e politikave bujqësore respektive duhet të respektojnë edhe regjimin e importeve të vendosura në Shtojcat II, III dhe IV.

### ■ NENI 34

<sup>56</sup>**Diskriminimi fiskal / Fiscal discrimination** – Nënkupton çdo masë ose praktikë të një natyre fiskale që krijon në mënyrë direkte ose indirekte diskriminim midis produkteve të ngjashme.

Neni 34 i MSA-së detyron palët të shfuqizojnë praktikën me natyrë fiskale që mund të krijojnë në mënyrë direkte apo indirekte diskriminim mes produkteve të njëjës palë dhe produkteve të ngjashme që kanë origjinën në territorin e palës tjetër.

<sup>57</sup>**Tatim i tërthortë / Indirect taxation** – Tatimi i tërthortë vilet mbi të mirat dhe shërbimet, në formën e taksave të shitjes apo si tatim mbi fitimin e shtuar, në ndryshim nga tatimi direkt, i cili vilet drejtpërdrejtë nga qeveria mbi individët ose organizatat në formën e tatimit mbi të ardhurat apo taksat e shoqërive tregtare. Tatimi i tërthortë zbatohet mbi produkte të tilla si karburanti, pijet alkoolike, cigaret, e tjerë. Në këtë mënyrë rritet çmimi i tyre, duke bërë që të jenë konsumatorët ata që do të paguajnë tatimin e tërthortë në formën e një pagese më të lartë për blerjen e produktit.

Konkretisht në Komunitetin Europian tatimi i tërthortë trajtohet në nenin 92 dhe 93 të Kapitullit 2 "Dispozitat Fiskale" të Traktatit të Komunitetit Europian.

Në nenin 34 të MSA-së parashikohet se produktet e eksportuara në territorin e njëjës palë mund të mos përfitojnë nga rimbursimi i tatimeve të brendshme të tërthorta lidhur me shumën që e kalon tatimin e tërthortë të paguar për ato produkte.



### ■ NENI 36

<sup>58</sup>**Bashkim doganor / Custom union** – Një bashkim doganor mund të përcaktohet si liberalizimi i plotë i tregtisë midis dy vendeve/rajoneve, të cilat zbatojnë një taksë të përbashkët doganore me vendet e treta.

Bashkimi doganor është një nga elementët kryesorë të Bashkimit European, ku vendet jo anëtare të BE-së taksohen me të njëjtën tarifë, pavarësisht se cili shtet i BE-së importon mallin. Në këtë mënyrë thjeshtohet shumë puna dhe volumi i dokumentave që duhet të plotësohen në këto raste. BE-ja ka përfunduar gjithashtu një bashkim doganor me Turqinë në vitin 1995, me qëllim realizimin e qarkullimit të lirë të mallrave industriale ndërmjet BE-së dhe Turqisë.

Neni 36 i MSA-së parashikon lejimin e krijimit të bashkimeve doganore në qoftë se këto të fundit nuk ndryshojnë rregullat tregtare të parashikuara në këtë Marrëveshje.

### ■ NENI 37

<sup>59</sup>**Dumping / Dumping** – Është shitja e mallrave në tregun e brendshëm me çmime më të ulta se sa çmimet e mallrave të njëjtë apo të ngjashëm. Shitja e mallrave me anë të praktikës së dumpingut, kryesisht si eksporte në tregtinë ndërkombëtare, ka si qëllim fitimin e tregut ndërkombëtar, duke shfrytëzuar konkurrencën e pandershme. Në rast se vendi importues njoftohet për ekzistencën e një praktike të tillë, neni VI i Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë dhe Tarifat (GATT) lejon vendosjen e masave anti-dumping mbi mallrat që shiten në këtë mënyrë. Këto masa mund të jenë (a) në formën e taksave të barabarta me diferencën midis çmimit të importit dhe vlerës normale të të njëjtit produkt në vendin eksportues dhe (b) në formën e çmimeve anti-dumping që iu ofrohen eksportuesve për të mënjeluar vendosjen e taksave. (neni 37 i MSA-së)

*Anti-dumping* – Masa që merren si reagim ndaj importimit dhe shitjes së mallrave të prodhuar jashtë, çmimi i të cilave vendoset nën koston e prodhimit të mallrave të njëjtë nga industritë vendase.

Në nenin 133 të Traktatit të Komunitetit European parashikohet marrja e masave në raste kur ekzistojnë praktika të dumpingut.

Në kuadër të nenit 37 të MSA-së, Shqipëria duhet të ndërmarrë veprime në mbrojtje të tregëtisë, në rast se konstatohet një praktikë dumpingu në tregtinë me palën tjetër, por duke njoftuar më parë Këshillin e Stabilizim-Asociimit. Kjo do të arrihet nëpërmjet forcimit të kuadrit ligjor në fushën e dumpingut, në përputhje me rregullat e GATT. Gjithashtu, neni 71 i MSA-së lejon vendosjen e masave anti-dumping në përputhje me nenin VI të GATT-it të 1994.

<sup>60</sup>**Subvencion / Subsidy** – Dhënia e ndihmës financiare nga një qeveri apo fondacion për një person ose shoqëri, me qëllim promovimin e një sipërmarrjeje, e cila konsiderohet si e dobishme për mirëqënien publike. Qeveritë ofrojnë shpesh këtë mbështetje, me qëllim që të nxitet rritja e eksporteve. Subvencionet të cilat janë të mundshme në rastin e eksporteve, mund të marrin formën e pagesave në kesh, shitjen e stoqeve qeveritare me çmime nën kosto, etjërë.

Trajtimi i rasteve të subvencionit, ashtu si rastet e dumpingut, parashikohet në nenin 133 të Traktatit të Komunitetit European dhe pasqyrohen edhe në nenin 37 të MSA-së, në të cilin kërkohet forcimi i kuadrit ligjor në këtë fushë dhe marrja e masave të nevojshme në përputhje me Marrëveshjen e OBT-së për zbatimin e nenit VI të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë GATT të vitit 1994, si edhe Marrëveshjen e OBT-së "Mbi Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese".

### ■ NENI 38

<sup>61</sup>**Klauzola e përgjithshme mbrojtëse / General safeguard clause** – Një situatë ku pala importuese merr masat e nevojshme mbrojtëse kur importet e njëjës palë janë produkte direkt konkurruese që shkaktojnë

dëme në industrinë e brendshme, shqetësime apo vështirësi në një sektor të ekonomisë, i cili sjell rënie të gjendjes ekonomike të një rajoni të palës importuese. Kjo klauzolë gjendet e shprehur dhe në nenin 95 (10) dhe nenin 174 (2) të Traktatit të Komunitetit Europian.

Në nenin 38 të MSA-së parashikohet marrja e masave mbrojtëse bilaterale nga palët mbi importet. Këto nuk duhet t'i tejkalojnë masat e nevojshme dhe do të konsistojnë në pezullimin e reduktimeve të mëtejshme të tarifës së zbatueshme sipas MSA-së, ose rritjen e saj deri në limitin maksimal të tarifës së kombit më të favorizuar që i korrespondon të njëjtit produkt. Këto masa do të merren në përputhje me procedurat dhe periudhat e parashikuara në nenin 38, dhe duhet t'i njoftohen dhe të konsultohen me Këshillin e Stabilizim-Asociimit. Në rast vonese, kur kalohen afatet kohore të negociuara, pala importuese merr masa për të zgjidhur situatën.

**62Neni XIX i GATT / Article XIX GATT 1994** – Është dispozitë e Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat (GATT) dhe Tregëtinë, që parashikon mundësinë e marrjes së masave të menjëherëshme (psh masa kufizuese të ndryshme nga tarifat normale) kundër importeve të cilat dëmtojnë prodhuesit vendas. Ky nen shërben si dokument bazë për zbatimin e klauzolave mbrojtëse midis palëve kontraktuese në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ashtu siç parashikohet dhe në nenin 38 të MSA-së.

**63Marrëveshja e OBT-së për Mbrojtjen / WTO Agreement on Safeguard** – Është pjesë përbërëse e marrëveshjeve të OBT-së. Përmes saj vendosen rregulla për zbatimin e masave mbrojtëse në përputhje me Nenin XIX të GATT 1994. Masat mbrojtëse përcaktohen si veprime “emergjence”, në përgjigje të rritjes së importimit të prodhimeve të veçanta, kur këto importe shkaktojnë ose rrezikojnë të shkaktojnë dëmtime serioze në industrinë e vendeve importuese. Masa të tilla, të cilat marrin formën e pezullimit të konçesioneve ose detyrimeve, mund të konsistojnë në kufizime sasiore të importit ose rritje të taksave doganore sipër tavanit maksimal.

Sipas Marrëveshjes, masat mbrojtëse duhet të jenë të përkohshme; të vendosen vetëm atëherë kur konstatohet se importet shkaktojnë ose kërcënojnë dëmtimin e industrive vendase konkurruese. Masat mbrojtëse nuk duhet të jenë selektive. Ato duhet të kijnë mundësi të liberalizohen progresivisht. Vendet anëtare të cilat i vendosin masat mbrojtëse, duhet të kompesojnë vendet e tjera në rast se ato ndikojnë negativisht në tregtinë e tyre.

Negocimi i Marrëveshjes së OBT-së për Mbrojtjen është kryer pasi shumë vende anëtare të GATT-it kishin zbatuar të ashtuquajturat masa “të zonës gri” (kufizime dypalëshe vullnetare të eksportit, marrëveshje marketingu të organizuara, dhe masa të ngjashme), të cilat kufizonin eksportin e produkteve të veçanta. Marrëveshja ndalon vendosjen e masave të tilla, dhe parashikon dispozita të veçanta të cilat do të zbatohen në mënyrë të njëjtë në të gjithë vendet anëtare me synim: a) qartësimin dhe rforcimin e disiplinave të GATT-it, sidomos të Nenit XIX; b) ri-vendosjen e kontrollit shumëpalësh mbi masat mbrojtëse dhe eliminimin e masave që i shmangen këtij kontrolli; c) inkurajimin e strukturimit të pjesëve të industrisë të dëmtuara nga rritja e importeve, duke shtuar kështu konkurrencën në tregjet ndërkombëtare.

Në rastin e Shqipërisë, Marrëveshja e OBT-së për mbrojtjen shërben si dokument bazë për zbatimin e klauzolës së përgjithshme mbrojtëse midis palëve kontraktuese në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. (neni 38 i MSA-së)

### ■ NENI 39

<sup>64</sup>**Klauzola e pamjaftueshmërisë / Shortage clause** – Kjo klauzolë zbatohet në një situatë kur ekziston një pamjaftueshmëri e mallrave ushqimorë ose produkteve thelbësore, apo kur ndodh një rieksporim i një produkti në një vend të tretë, për të cilin pala eksportuese ka kufizime sasiore, tarifa mbi eksportet ose masa me të njëjtin efekt, si dhe kur këto situata ka mundësi të shkaktojnë vështirësi të mëdha për palën eksportuese.

Në bazë të nenit 39 të MSA-së, Shqipëria duhet të marrë masa të tilla që të mos përbëjnë një diskriminim arbitrar apo të pajustificuar. Në këtë nen parashikohet se në një situatë kritike, palët mund të marrin masa parandaluese në mënyrë të menjëhershme, por gjithnjë duke njoftuar palët respektive dhe Këshillin e Stabilizim-Asociimit. Në këtë organ, këto masa i nënshtrohen konsultimeve periodike në bazë të një kalendarit veprimesh, me synim eliminimin e tyre, sapo të krijohen kushtet e nevojshme.

### ■ NENI 40

<sup>65</sup>**Monopol shtetëror / State monopolies** – Neni 40 i MSA-së kërkon që Shqipëria të rregullojë progresivisht situatat monopol me natyrë tregtare, në mënyrë që 4 vjet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes të jetë arritur liberalizimi i tregut dhe mosdiskriminimi i operatorëve ekonomikë.

Këshilli i Stabilizim-Asociimit duhet të informohet rregullisht mbi masat e miratuara për arritjen e këtij objekti.

Dispozitat lidhur me kufizimin e pozitës dominuese të ndërmarrjeve publike në Komunitet gjenden të shprehura në nenin 86 të Traktatit të Komunitetit Europian, ku ndalohej abuzimi i pozitës dominuese të ndërmarrjeve publike brenda tregut unik, të tilla që mund të shtrembërojnë konkurrencën e ndershme dhe tregtinë.

Sipas nenit 72 të MSA-së, Shqipëria angazhohet të marrë masa që pas një periudhe tre vjeçare pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes të zbatojë për ndërmarrjet publike dispozitat e shprehura në Traktatin e Komunitetit Europian.

### ■ NENI 41

<sup>66</sup>**Rregulla origjine / Rules of origin** – Nocioni i rregullave të origjinës ka në thelb bazën ligjore, rregulloret dhe procedurat administrative të cilat përcaktojnë vendin e origjinës së një produkti, në të cilin ai konsiderohet si i prodhuar, me qëllim të zbatimit të taksave dhe detyrimeve të tjera doganore.

Neni 41 përcakton se këto rregulla të origjinës të nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje gjenden të shprehura në Protokollin 4. Në vijë të përgjithshme produktet konsiderohen me origjinë në Shqipëri ose Komunitet atëherë kur a) ato janë siguruar plotësisht në territorin shqiptar ose atë komunitar si psh produktet minerale të nxjerra në tokën ose shtratin e detit shqiptar ose atij komunitar, perimet ose gjëja e gjallë e lindur dhe e rritur në këto territore etj. b) prodhuesit në Shqipëri ose Komunitet mund të përdorin materiale dhe përbërës me origjinë nga vendi tjetër, sikur të ishin nga vendi i tyre, dhe veprimet e kryera në njërin vend partner mund t'i shtohen veprimeve të bëra në vendin tjetër partner, me qëllim dhënien e statusit të origjinës mallrave të tregtuara mes tyre. Protokollin 4 përmban ndër të tjera edhe listën e veprimeve përpunuese të cilat konsiderohen si të nevojshme në mënyrë që produkte të caktuara të përpunuara në vendet respektive, të marrin statusin e produktit të origjinës.

## ■ NENI 46

**<sup>67</sup>Lëvizja e punonjësve / Movement of workers** – E drejta e lëvizjes së punonjësve gjendet e shprehur në nenin 39 të Traktatit të Komunitetit Europian dhe ka si qëllim zhdukjen e diskriminimit midis punonjësve lidhur me punësimin, pagesat dhe kushtet e tjera të punësimit. Punonjësit gëzojnë të drejtat për të pranuar oferta punësimi, të lëvizin lirisht dhe të qëndrojnë në territorin e vendeve të Komunitetit në përputhje me dispozitat që rregullojnë praktikatat e punësimit në këto vende.

Ruajtja dhe përmirësimi i lehtësive lidhur me lëvizjen e lirë të punëtorëve shqiptarë dhe rritja e aksesit të tyre në tregjet e vendeve të Komunitetit parashikohet në nenin 47 të MSA-së dhe do të arrihet përmes zbatimit dhe përfundimit të marrëveshjeve dypalëshe dhe inkurajimit të shteteve të tjera që nuk kanë përfunduar Marrëveshje të tilla. Nga ana e tyre, palët duhet t'iu akordojë trajtim të njëjtë me shtetasit e tyre shtetasve shqiptarë/komunitarë dhe familjeve të tyre, kur ata janë të punësuar ligjërisht në shtetet anëtare (neni 46, 47 i MSA-së).

**<sup>68</sup>Treg pune / Labour market** – Një zonë e shkëmbimeve ekonomike, në të cilën punonjësit kërkojnë punë dhe punëdhënësit kërkojnë krah pune.(neni 46 i MSA-së)

## ■ NENI 49

**<sup>69</sup>Vendosja / Establishment** – Nocioni i vendosjes nënkupton të drejtën e shoqërive tregtare për të çelur një seli apo degë tregtare në një vend të huaj. Përveç kësaj, me këtë nocion nënkuptohet edhe sigurimi i shërbimeve që ato mund të ofrojnë, pa qenë nevoja për tu vendosur në një vend të caktuar.

Në lidhje me shtetasit e Komunitetit apo të Shqipërisë, vendosja nënkupton të drejtën për të nisur aktivitete ekonomike si përsona të vetë-punësuar, si edhe themelimin e shoqërive të kontrolluara prej tyre.

Neni 49 (d) i MSA-së parashikon se vetë-punësimi dhe sipërmarrja nga ana e shtetasve të palëve, nuk përfshin kërkimin dhe punësimin në tregun e punës apo dhënien e të drejtës për të hyrë në tregun e punës së palës tjetër.

**<sup>70</sup>Shoqëri komunitare/shqiptare // Community/Albanian company** – Shoqëri e cila është ngritur në përputhje me legjislacionin e vendeve anëtare në BE, apo në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka zyrën, administratën qendrore ose vendin kryesor të biznesit të regjistruar respektivisht në territorin e Komunitetit apo të Shqipërisë. Një shoqëri e krijuar në përputhje me legjislacionin e vendeve komunitare apo Shqipërisë do të konsiderohet si një shoqëri komunitare/shqiptare në qoftë se veprimet e saj gëzojnë një lidhje reale dhe të vazhdueshme me ekonominë e vendeve respektive.

**<sup>71</sup>Filial / Subsidiary** – Nënkupton një shoqëri e cila kontrollohet efektivisht nga shoqëria e parë.

Neni 50 i MSA-së parashikon që Shqipëria duhet të lehtësojë fillimin e veprimtarive të filialeve dhe degëve, si dhe nuk duhet të adoptojë rregulla të tilla që sjellin diskriminim lidhur me vendosjen e tyre në territorin e njëres palë. Gjithashtu, filialet dhe degët e të gjitha shoqërive komunitare duhet të kenë të drejtën që nga momenti i hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, të përdorin dhe marrin me qira pasuri të patundëshme si edhe të drejtën e pronësisë, aty ku këto të drejta konsiderohen të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve ekonomike për të cilat ato janë vendosur. Në kategorinë e fundit përjashtohen pasuritë natyrore, tokat bujqësore, pyjet, livadhet dhe kullotat.

<sup>72</sup>**Degë / Branch** – Degë e një shoqërie konsiderohet një vend biznesi, i cili nuk gëzon personalitet juridik, si një zgjatim i kompanisë mëmë. Një degë shoqërie ka një sistem drejtues dhe është e aftë për të negociuar çështje biznesi me palët e treta, të cilat megjithëse janë në dijeni se një lidhje juridike ekziston me shoqërinë mëmë, zyrat qendrore të së cilës ndodhen jashtë, nuk e shohin të nevojshme të hyjnë në bisedime direkte me të (shoqërinë mëmë).

<sup>73</sup>**Veprimtari ekonomike / Economic activities** – Aktivitetet ekonomike në parim do të përfshijnë aktivitetet me një karakter industrial, tregtar e profesional, artizanal si edhe aktivitetet bujqësore.

<sup>74</sup>**Shtetas komunitar/shqiptar // Community/Albanian nationals** – Çdo person fizik i cili është shtetas i një prej vendeve anëtare të BE-së apo shtetas i Republikës së Shqipërisë.

<sup>75</sup>**Shërbim financiar / Financial services** – Shërbim i ofruar nga operatorë financiar të palëve. Shërbimet financiare përfshijnë tërësinë e aktiviteteve që përshkruhen në Aneksin V të MSA-së. Si të tilla janë shërbimet e sigurimit, veprimet bankare dhe shërbimet e tjera financiare (depozitat, huatë, shërbimi i të gjitha llojeve të pagesave, e tjerë).

Sipas nenit 51 të MSA-së, palët nuk ndalohen të marrin masa paraprake që kanë të bëjnë me mbrojtjen e investitorëve, depozituesve, ose edhe për të siguruar integritetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Megjithatë këto masa nuk duhen të përdoren për të shmangur detyrimet e tyre sipas Marrëveshjes.

## ■ NENI 57

<sup>76</sup>**Ofrimi i shërbimeve / Supply of services** – Sipas Nenet 50 të Traktatit të Komunitetit Europian, konsiderohen shërbime ato veprimtari që ofrohen me shpërblim dhe që nuk rregullohen nga dispozitat që kanë të bëjnë me qarkullimin e lirë të mallrave, kapitaleve dhe personave. Termi "shërbime" përfshin si rregull veprimtaritë me karakter industrial, tregtar, artizanal apo profesionet e lira.

Neni 57 i MSA-së parashikon se ofrimi i shërbimeve nga shoqëritë ose shtetasit e Komunitetit/Shqipërisë, të vendosur në një territor të ndryshëm nga marrësi i shërbimit, do të lejohet progresivisht pas marrjes së masave të nevojshme nga Këshilli i Stabilizim-Asociimit, duke filluar nga faza e dytë e periudhës tranzitore pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

## ■ NENI 60

<sup>77</sup>**Lëvizja e lirë e kapitalit / Free movement of capital** – Veprimtari financiare që ka për qëllim transferim apo investim kapitali. Lëvizja e lirë e kapitalit së bashku me lëvizjen e lirë të mallrave, personave dhe shërbimeve, qëndron në themelet e Tregut të Përbashkët Europian. Dispozitat lidhur me lëvizjen e lirë të kapitalit gjenden të shprehura në Titullin III të Traktatit të Komunitetit Europian. Neni 56 parashikon shprehimisht ndalimin e të gjithë kufizimeve në lëvizjen e lirë të kapitalit ndërmjet vendeve anëtare, si edhe ndërmjet vendeve anëtare dhe vendeve të treta.

Në kapitullin IV të MSA-së (nenet 60-62), përkufizimi i lëvizjes së lirë të kapitalit përfshin më tepër se pagesat dhe transfertat e parave përtej kufijve. Pjesë e acquis në këtë fushë përbëjnë edhe transaksione të tjera që lejojnë transferimin e pronësisë së aseteve dhe borxheve, si psh. investimin në shoqëri dhe pasuri të paluajtshme apo dhe investimet

e portofolit. Si rregull, vendet kandidate kërkojnë një periudhë trazitore, para se t'iu akordojnë shtetasve komunitare të drejtën për të investuar lirisht në pasuri të paluajtshme.

<sup>78</sup>**Llogari rrjedhëse / Current account** – Është një llogari e cila ofron mundësinë që mbajtësit e tyre të kryejnë veprime në çdo moment pa asnjë kufizim. Nëpërmjet saj mund të bëhen të gjitha llojet e pagesave, qoftë brenda ashtu edhe jashtë vendit, mund të kryhen pa asnjë komision pagesa në të gjitha qytetet ku ka degën e saj një bankë e caktuar. Gjithashtu përmes llogarisë rrjedhëse mund të bëhen edhe pagesa të detyrimeve ndaj institucioneve shtetërore si tatim-taksat, sigurimet shoqërore, e tjerë. Njëkohësisht Llogaria Rrjedhëse mundëson gjithashtu pranimin e pagesave, transfertave apo derdhjeve nga palët e treta në emrin e mbajtësit të saj. (neni 60 i MSA-së)

## ■ NENI 61

<sup>79</sup>**Investimet e portofolit, investimet direkte / Portfolio Investment, direkt investment** – Sipas “Teorisë moderne të portofolit” (Harry Markowitz, çmim Nobël për ekonominë), portofoli optimal është gjithnjë ai i diversifikuar, sepse krijon një mekanizëm mbrojtës ndaj situatave të paparashikuara që mund të ndodhin në të ardhmen. Kjo teori studion procesin që gjeneron kërkesën dhe ofertën e një aseti financiar në funksion të raportit risk/rendiment. Hapi kryesor për ndërtimin e një portofoli eficient, konsiston pikërisht në përcaktimin e një kombinimi titujsh të tillë që redukton rrezikun dhe normalizon performancën e përgjithshme. Për shembull, në një periudhë gjatë së cilës aksionet japin rendimente më të ulta se norma, investimet e portofolit sigurojnë rendimente të sigurta dhe rezervat (si p.sh. metalet e çmuara, ari, argjendi) shënojnë rritje cmimesh, duke kompensuar performancën e përgjithshme të portofolit të diversifikuar. Pra, duke balancuar kuotat e një portofoli sipas qëndrimit ndaj rrezikut, do të kemi një optimizim të rendimenteve dhe një ulje të rrezikut të përgjithshëm.

<sup>80</sup>**Bilanci i pagesave / Balance of payments** – Sipas Eurostatit, bilanci i pagesave është një regjistër i transaksioneve ndërkombëtare të ekonomisë së një vendi me vende të tjera. Pra bilanci pasqyron në shifra të gjitha hyrjet (të ardhurat) e një vendi nga jashtë dhe të gjitha pagesat (daljet) e tij në raport me vendet e tjera. Bilanci i pagesave ndahet në llogari rrjedhëse, investime dhe transaksione kapitali. Këto të fundit regjistrohen në një sistem të dyfishtë, dhe përfshijnë mallrat, shërbimet, transfertat, huatë, letrat me vlerë, valutën e huaj, e tjerë.

Bilanci i pagesave ka rëndësi në kontekstin e MSA-së, pasi asnjë prej palëve nuk duhet të vendosë masa kufizuese të tilla që mund të ndikojnë në të. (nenet 61, 67 e tjerë të MSA-së).

## ■ NENI 63

<sup>81</sup>**Politika publike, siguria publike dhe shëndeti publik / Public policy, public security, public health** – Politikat publike kanë të bëjnë me politikat që prekin çështjet mbi kushtet sociale në të cilat jetojnë qytetarët europianë. Studjuesit i përcaktojnë politikat publike si veprimtari të qeverisë, e cila ka autoritetin politik dhe financiar për t'i hartuar dhe zbatuar ato.

Në legjisllacionin komunitar politikat publike trajtohen në nenet 46, 58 dhe 186 të Traktatit të Komunitetit Europian, më konkretisht në kapitujt për të drejtën e vendosjes, lëvizjes së lirë të kapitalit dhe pagesat si dhe në kapitullin që flet për lidhjet me vendet dhe territoret përtej detit. Në kuadër të eliminimit të masave kufizuese, Shtetet Anëtare duhet të respektojnë rregulloret e brendshme ose aktet administrative shtetërore në fushën e politikave publike, të sigurisë publike dhe shëndetit publik.

## ■ NENI 66

### <sup>82</sup>Trajtimi i Kombit më të Favorizuar / **Most-Favored-Nation treatment**

– Zbatohet në tregëtinë midis vendeve anëtare të OBT-së dhe synon mosdiskriminimin midis partnerëve tregtarë, duke parashikuar trajtim tarifor dhe doganor të njëjtë për një kategori të caktuar shtetesh. Në bazë të marrëveshjes së kombit më të favorizuar, një vend mund të zbatojë për një ose disa vende vlera më të ulta tarifore që zbaton normalisht për pjesën më të madhe të shteteve të tjera. Një vend nuk detyrohet t'i ofrojë një vendi tjetër të njejtin trajtim, nëse ata nuk janë anëtarë të OBT-së, ose nuk parashikohet shprehimisht në marrëveshje ndërmjet tyre.(neni 66 i MSA-së)

## ■ NENI 71

<sup>83</sup>**Konkurrenca / Competition** – Element kryesor i ekonomisë së tregut dhe atij të Tregut të Përbashkët European. Konkurrenca i krijon mundësinë konsumatorit të ketë një ofertë më të gjerë përzgjedhje në çmim dhe cilësi mes mallrave e shërbimeve të ndryshme të tregut. Bazat e politikës së BE për Konsumatorin parashikohen në nenet 81-89 (ish nenet 85-94) të Traktatit të Komunitetit European, ku respektimi i tyre siguron mbarëvajtjen e tregtisë ndërmjet shteteve anëtare. Këto konsistojnë në ndalimin e marrëveshjeve që mund të çenojnë tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare si dhe ndalimin e çdo abuzimi nga ana e një ose disa ndërmarrjeve të pozicioneve të tyre dominuese. Gjithashtu duhet të mbikqyret ndihma e dhënë nga Shtetet Anëtare që favorizojnë disa ndërmarrje ose prodhimeve si dhe kontrolli i kompromiseve të fshehta për fiksimin e çmimeve për mallra ose shërbime të njëjta në treg mes shoqërive të ndryshme konkurruese.

Nga rregullat e konkurrencës bëjnë përjashtim skemat e ndihmës shtetërore që subvencionojnë trashëgimitë kulturore dhe shtetërore. Qëllimi kryesor i Komunitetit qëndron në mundësimin e një konkurrence të ndershme në tregun e brendshëm, në mënyrë që operatorët europianë të përgatiten në përballjen me tregun botëror.

Në bazë të nenit 71 të MSA-së, Shqipëria angazhohet të respektojë parimet bazë të konkurrencës dhe mundësojë ngritjen e një institucioni publik të pavarur, i cili do të ushtrojë kompetencat për zbatimin sa më të plotë të këtyre standarteve.

### <sup>84</sup>**Abuzimi i pozicionit dominues / Abuse with dominant position** –

Termi abuzim me pozicionin dominues i referohet praktikave të biznesit antikonkurrues në të cilin një shoqëri e fuqishme angazhohet për të mbajtur dhe forcuar pozicionin e saj në treg. Këto praktika biznesi të shoqërisë, mund të konsiderohen si kontroll monopolist i tregut.(neni 71 i MSA-së)

### <sup>85</sup>**Ndihmë shtetërore / State aid** –

Në nenin 87 të Traktatit të Komunitetit European theksohet se çdo ndihmë e dhënë nga ana e Shteteve Anëtare ose nga burimet shtetërore, nuk duhet të çenojë konkurrencën e lirë, gjë që pengon edhe tregtinë mes Shteteve Anëtare. Në nenin 88 të këtij Traktati theksohet se, çdo ndihmë shtetërore, para zbatimit të saj duhet t'i paraqitet Komisionit European dhe të aprovohet prej tij. Komisioni duhet të garantojë dhe sigurojë mbarëvajtjen e ndihmave shtetërore, sidomos ndihmat për zhvillimin rajonal, për mbrojtjen e mjedisit, etj.

Në nenin 71 të MSA-së ndër të tjera theksohet detyrimi që çdo ndihmë shtetërore duhet të jepet në përputhje me parimet e konkurrencës së ndershme.

### <sup>86</sup>**Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistika / Nomenclature of Territorial Units for Statistics (NUTS)** –

Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat është krijuar nga Eurostat për të dhënë

informacione mbi ndarjen në njësi të territorit të BE-së. Nomenklatura e NUTS-it shërben si referencë a) për mbledhjen, zhvillimin dhe harmonizimin e statistikave rajonale të Komunitetit; b) për analiza social-ekonomike të rajonit si dhe c) për hartimin e politikave rajonale të Komunitetit.

NUTS është një klasifikim hierarkik me pesë nivele: tri nivele rajonale dhe dy nivele lokale. Tri nivelet e para janë nivele të cilat gjejnë përdorim më të shpeshtë. Nivelet e dyta dhe të treta janë nëndarje të niveleve të parë dhe të dytë respektivisht. Niveli 1 përfshin territoret me përmasat e njësisve administrative me popullsi nga 3 deri në 7 milion banorë. Në nivelin 2 përfshihen territoret me popullsi nga 800000 deri në 3 milion banorë, në nivelin 3 territoret me popullsi nga 150000 deri në 800000 banorë. Niveli 4 përfshin kryesisht rrethet dhe niveli 5 komunat. Përfitues të politikave rajonale të Komunitetit janë kryesisht rajonet e klasifikuara si NUTS 2. (neni 71 i MSA-së)

## ■ NENI 72

<sup>87</sup>**Sipërmarrje publike / Public undertaking** – Nënkupton një sipërmarrje mbi të cilën autoritetet publike kanë një ndikim përcaktues në mënyrë direkte ose indirekte, për shkak të zotërimit të saj, pjesëmarrjes financiare, apo për shkak të rregullave mbi drejtimin e kësaj sipërmarrjeje. Një ndikim dominues i autoriteteve publike ndodh në rastet kur këto autoritete: a) zotërojnë pjesën më të madhe të kapitalit të ndërmarrjes, b) kontrollojnë shumicën e votave në aksionet e ndërmarrjes ose c) gjenden në një pozicion të tillë që mund të emërojnë më tepër se gjysmën e posteve administrative, manaxhuese apo mbikqyrëse në ndërmarrje.

Dispozitat lidhur me kufizimin e pozitës dominuese të ndërmarrjeve publike në Komunitet gjenden të shprehura në nenin 86 të Traktatit të Komunitetit European, ku ndalohet abuzimi i pozitës dominuese të ndërmarrjeve publike brenda tregut unik, të tilla që mund të shtrembërojnë konkurrencën e ndershme dhe tregtinë.

Sipas nenit 72 të MSA-së, Shqipëria angazhohet të marrë masa që pas një periudhe tre vjeçare pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes të zbatojë për ndërmarrjet publike dispozitat e shprehura në Traktatin e Komunitetit European.

## ■ NENI 73

<sup>88</sup>**Pronësia Intelektuale / Intellectual property** – Sipas Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, pronësia intelektuale është pronësi që rrjedh nga krijimtaria njerëzore si: shpikjet, punimet letrare dhe artistike, simbolet, emrat, imazhet dhe disenjt e përdorura në tregti. Pronësia intelektuale ndahet në dy kategori: a) pronësi industriale ku përfshihen shpikjet (patentat), markat tregtare, dizenjot industriale, dhe treguesit gjeografikë të origjinës dhe b) të drejtat e autorit (copyright) ku përfshihen punimet letrare si poema, romani, filmi, krijimtaritë muzikore, apo punimet artistike si vizatimi, piktura, fotografi, skulpturë dhe disenjt arkitekturorë.

Të drejtat që rrjedhin nga pronësia intelektuale i lejojnë pronarëve respektiv të ushtrojnë të drejtën e monopolit mbi pronësinë e tyre dhe përdorimin e kësaj të drejte për një periudhë të caktuar kohore. Në këtë mënyrë, pronarët e punëve krijuese letrare dhe artistike janë të mbrojtur nga e drejta e autorit, shpikjet janë të mbrojtura nga patentat, dhe markat që bëjnë dallimin ndërmjet prodhimeve të firmave në tregun ndërkombëtar janë të mbrojtura nga markat e tregut.

Në Bashkimin European mbrojtja e pronësisë intelektuale është e lidhur ngushtë me funksionimin e tregut unik european, kërkimin, zhvillimin, konkurrencën dhe punësimin në nivel komunitar. Neni 73 i MSA-së



detyron palën shqiptare të sigurojë mbrojtjen dhe zbatimin efektiv të të drejtave mbi pronësinë intelektuale, industriale dhe tregtare.

#### ■ NENI 74

<sup>89</sup>**Kontratë Publike / Public contract** – Akti i prokurimit ka të bëjë me blerjen, dhënien me qera, shitjen e materialeve, shërbimeve, pajisjeve, ose ndërtimeve nga ana e autoriteteve publike dhe institucioneve shtetërore, sidomos në sektorë të tillë të rëndësishëm si uji, energjia, transporti, telekomunikacioni, e tjerë.

Zëri i prokurimeve publike në buxhetin e Bashkimit European arrin rreth 15% të GDP-së së BE-së, duke variuar nga 11%-20% të GDP në shtete të veçanta. Hapja e prokurimeve publike, brenda Tregut të Përbashkët ka rritur konkurrencën ndërkufitare dhe ka përmirësuar çmimet e paguara nga autoritetet publike. Proçedurat e prokurimit publik duhet të jenë transparente dhe të sigurojnë konkurrencë të ndershme.

Neni 74 i MSA-së lejon shoqëritë shqiptare të marrin pjesë në procedurat komunitare të tenderimit nga momenti i hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, ndërkohë që një trajtim të tillë do përfitojnë dhe shoqëritë komunitare të vendosura në Shqipëri, në përputhje me parimet e mos-diskriminimit dhe mbi baza të ndërsjellta. Përsa i përket shoqërive komunitare jashtë territorit shqiptar, ato do të përfitojnë nga proçedurat e tenderimit sipas legjislacionit shqiptar jo më vonë se katër vjet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes. Në përmbushje të këtyre objektivave, nevojitet rishikimi i kuadrit ligjor dhe institucional ekzistues, i cili duhet të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e ndershme.

#### ■ NENI 75

<sup>90</sup>**Standartizim / Standardisation** – Nënkupton një veprimtari tekniko-ekonomike që lidhet me percaktimin shkencor e të kontrollueshem të llojit, të parametrave e të niveleve të karakteristikave të produkteve të ndryshme, të shpenzimeve, të proceseve të punës dhe në përgjithësi të llojeve të ndryshme të standarteve sasiore e cilësore, që ndihmojnë kompanitë për kontrollin e cdo pune si edhe rritjen e stabilitetit të tyre.

Standartizimi është një proces i bazuar në konsensusin e aktorëve të ndryshëm ekonomikë (industrisë, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, konsumatorëve, organizatave jo-qeveritare ambientaliste, autoriteteve publike etj.) Proces i standartizimit kryet nga organizma standartzues të pavarur që veprojnë në nivel kombëtar, europian dhe ndërkombëtar.

Që prej mesit të viteve '80, gjithnjë e më tepër KE ka përdoruar standardet në mbështetje të politikave dhe legjislacionit komunitar. Për më tepër, standartizimi mbështet politikat komunitare në fushat e konkurrencës, teknologjisë së informimit dhe komunikimit, prokurimit publik, mjedisit, transportit, energjisë, mbrojtjes së konsumatorit etj. Organizatat Europiane të Standartit janë CEN, CENELEC dhe ETSI.

Në termin “standarte të harmonizuara” përfshihen standartet europiane, të adoptuara nga CEN (Komiteti European për Normalitetin), CENELEC (Komiteti Ekonomik për standartizimet elektro-teknike) apo ETSI (Instituti European për standartet e tele-komunikimit), të cilat kanë marrë autorizimin nga Komisioni European. Standartet europiane arrihen nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent, me konsensusin e gjithë palëve të interesuara dhe numrat e tyre të referencës publikohen në Fletoren Zyrtare të Komunitetit.

Sipas nenit 75 të MSA-së Shqipëria duhet të marrë masa për t'u përafruar gradualisht me rregullat teknike të Komunitetit ashtu si dhe proçedurat e standartizimit, metrologjisë, akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit.

<sup>91</sup>**Metrologjia / Metrology** – Shkenca që merret me matjet dhe luan një rol thelbësor në sektorin industrial dhe tregtinë ndërkombëtare. Matjet e kujdeshme sigurojnë një produkt cilësor dhe ndikojnë në mbrojtjen e ambientit dhe shëndetit. (neni 75 i MSA-së)

<sup>92</sup>**Bashkëpunimi European për Metrologjinë Ligjore / WELMEC** – Themeluar në Zvicër në vitin 1990 nga 18 autoritete të metrologjisë ligjore të Komunitetit European dhe EFTA-s (Shoqata Europiane e Tregtisë së lirë). Synim kryesor i kesaj organizate është të harmonizojë aktet ligjore te vendeve pjesmarrëse në këtë organizatë me Metrologjinë Ligjore Europiane dhe të zhvillojë bashkëpunimin reciprok mes tyre. Aktualisht WELMEC shtrihet dhe ushtron veprimtarinë e tij edhe në disa vende të Europës Qëndrore dhe Lindore. (neni 75 i MSA-së)

<sup>93</sup>**Bashkëpunimi European për Standartet Matëse / EUROMET** – Organizatë vullnetare bashkëpunimi mes instituteve kombëtare të metrologjisë në Komunitetin European, EFTA dhe shtetet anëtare. Ka si qëllim të nxisë koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve për të arritur cilësinë dhe efektshmerinë e sektorit të metrologjisë. (neni 75 i MSA-së)

<sup>94</sup>**Protokollet Europiane të Vlerësimit të Përputhshmërisë / European Conformity Assessment Protocols** – Janë instrumentet kryesorë të strategjisë së para-aderimit në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Kanë karakter të përkohshëm dhe zbatohen në kuadër të politikës së zgjerimit të Bashkimit European deri në momentin e anëtarësimit të plotë të vendit kandidat.

Protokollet e Vlerësimit të Konformitetit European krijojnë një treg të brendshëm të zgjeruar për prodhimet e disa sektorëve të caktuar para aderimit, tashmë të përafuar me *acquis*. Në këtë kontekst, qëllimi i tyre është eliminimi i barrierave teknike që pengojnë tregtinë e prodhimeve industriale duke realizuar a) pranimin e dyanshëm të produkteve industriale të cilat plotësojnë kërkesat për t'u vendosur ligjërisht në tregun e njëjës palë dhe b) njohjen reciproke të rezultateve të vlerësimit të konformitetit të prodhimeve industriale. Gjithashtu, protokollet synojnë të shmangin dublikimet e çertifikatave nga operatorët ekonomikë; nxitjen e eksporteve, punësimin, konkurrencën dhe investimet; uljen e kostove, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si edhe për konsumatorët; sigurimin e një veprimtarie efektive të tregut të brendshëm në sektorë të veçantë para aderimit të vendit kandidat.

Neni 75 i MSA-së mbështet përfundimin e marrëveshjeve mbi njohjen reciproke në fushën e standarteve industriale dhe vlerësimit të konformitetit, me synim përshtatjen e tregut shqiptar me rregullat teknike, procedurat e standartizimit dhe vlerësimin e konformitetit që ekzistojnë në kuadër të Bashkimit European.

## ■ NENI 76

<sup>95</sup>**Mbrojtja e konsumatorit / Consumer protection** – Në bazë të nenit 153 të Traktatit të Komunitetit European, vendet Anëtare duhet të marrin masa për të mbrojtur shëndetin dhe interesin ekonomik të konsumatorit. Këto masa, kërkojnë ndër të tjera përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare me atë të Komunitetit, kërkesë e cila rezultoi në shprehur edhe në nenin 95 të Traktatit. Për mbrojtjen e konsumatorit ka një sërë direktivash e masash të BE-së, të cilat nuk ishin parashikuar shprehimisht si politika për mbrojtjen e konsumatorit në kohën kur u krijua Komuniteti Ekonomik European, pra më 1957. Në vitin 1975, për herë të parë u miratua një Plan me 5 objektiva kryesore: a) mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së konsumatorit; b) mbrojtja e interesave ekonomike të konsumatorit; c)

edukimi dhe informimi i konsumatorit; d) mbrojtja ligjore e konsumatorit në rast të shkakimit të dëmit dhe e) garantimi i interesave të konsumatorit. Në vijim, politika për mbrojtjen e konsumatorit është zhvilluar dhe përsosur më tej. Përfaqësimi i interesave të tyre duhet të bëhet jo vetëm në nivel evropian, por edhe atë kombëtar. Në këtë kuadër është ngritur edhe Zyra Europiane e Shoqatave të Konsumatorëve. Dispozitat e BE-së garantojnë një nivel minimal të të drejtave në këtë fushë.

Pala shqiptare duhet të vlerësojë rëndësinë e përafrimit të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit si dhe zbatimin e tij. Sipas nenit 70 të MSA-së, përafrimi duhet të synojë mbrojtjen sa më të mirë të konsumatorit, elementët e tregut të brendshëm, konkurrencën, punësimin dhe sigurinë në punë, mundësi të barabarta për punësim, të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, prokurimin publik, mbrojtjen e të dhënave, etj.

## ■ NENI 80

<sup>96</sup>**Politika e Vizave / Visa Policy** – Politika e vizave e Bashkimit Europian mbështetet në Nenet 62 dhe 63 të Traktatit të Amsterdimit (1997), Kartën e të Drejtave Themelore (2000), dhe Marrëveshjen e Shengenit (2000). Sipas të drejtës komunitare ka një listë vendesh të treta, qytetarët e të cilëve duhet të jenë të pajisur me vizë kur kalojnë kufijtë e BE-së, si dhe të tjera vende të treta, qytetarëve të të cilëve nuk u kërkohet vizë. Ka gjithashtu një sërë kushtesh dhe procedurash të përcaktuara për dhënien e vizave nga Shtetet Anëtare. Vizat janë të një formati uniform, për të cilin ka gjithashtu rregulla të veçanta. Ndërkohë qytetarët e Shteteve Anëtare nuk kanë nevojë për vizë për të udhëtuar në territoret e shteteve të tjera anëtare. Marrëveshja e Shengenit ka bërë të mundur që edhe shtetasit e vendeve të treta që pajisen me vizë prej njërit nga Shtetet Anëtare të mund të lëvizin lirisht në vendet e tjera të zonës Shengen pa pasur nevojë për një vize tjetër.

Programi i Hagës i paraqitur nga Komisioni Europian, ka krijuar një Sistem Informativ për Vizat. Synimi kryesor i këtij Sistemi është shkëmbimi i informacionit ndërmjet shteteve anëtare mbi të dhënat e vizave, duke përmirësuar kështu procesin e vlerësimit të aplikimeve dhe verifikimin e identifikimin e kërkuësve.

Sipas nenit 80 të MSA-së, Shqipëria dhe Komuniteti angazhohen të bashkëpunojnë për ta kontrolluar më mirë lëvizjen e njerëzve për në vendet përkatëse, në mënyrë që të minimizohen sa më shumë aktivitetet e paligjshme dhe të rrezikshme.

<sup>97</sup>**Kufi / Border** - Që nga viti 1995 kontrollet dhe mbikqyrja në kufijtë e jashtëm të BE-së realizohen në bazë të Marrëveshjes së Shengenit. Rregulla më të detajuara për këtë qëllim përcaktohen në Manualin e Përbashkët të Kufijve të Jashtëm (2002).

Marrëveshja e Shengenit përmban ndër të tjera dhe disa dispozita të përgjithshme lidhur me hyrjen për një qëndrim që nuk i kalon tre muajt, detyrimet e Shteteve Anëtare për sa u përket kontrolleve dhe mbikqyrjes, përgjegjësinë e transportuesve dhe Sistemin e Informacionit Shengen.

Në përputhje me Marrëveshjen e Shengenit, Shtetet Anëtare janë të lira t'i përcaktojnë vetë autoritetet që do të kryejnë kontrollet dhe mbikqyrjen në kufijtë e jashtëm. Menaxhimi financiar i kontrolleve dhe mbikqyrjes së kufijve të jashtëm ka një kosto të lartë, që nuk mund të përballohet nga disa Shtete Anëtare. Bashkimi Europian i ndihmon Shtetet Anëtare për këtë qëllim nëpërmjet programeve të ndryshme të asistencës komunitare.

<sup>98</sup>**Azil / Asylum** – Sipas Konventës së OKB-së të vitit 1951 "Mbi statusin e Refugjatit", azili është një formë mbrojtje dhënë nga një shtet në territorin

e tij ndaj personave, për të cilët ekziston një frikë e mirëbazuar se do të persekutohen për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo për shkak të bindjeve politike. Azili bazohet në parimin “Non-refoulement” (parimi i moskthimit) dhe në të drejtat e refugjatëve të njohura dhe pranuar nga aktet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Politika europiane e azilit bazohet në nenin 63 të Traktatit të Amsterdimit (1997), konkluzionet e Këshillit Europian të Tamperes (1999), Këshillin Europian të Laekenit (2001), Konventën e Gjenevës (1951), nenet 18 dhe 19 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së, Planit të Veprimit të Vjenës (1998), e tjerë.

Synimet kryesore të kësaj politike janë: vendosja e kriterëve dhe mekanizmave për të përcaktuar se cili Shtet Anëtar është përgjegjës për të marrë në konsideratë një kërkesë për azil të dorëzuar nga një shtetas i vendit të tretë në një prej Shteteve Anëtare, vendosjen e standarteve minimale për pritjen e azilkërkuesve, përcaktimin e kriterëve për kualifikimin e azilkërkuesve, si edhe vendosjen e standarteve minimale për procedurat e dhënies ose heqjes së statusit të refugjatit nga ana e Shteteve Anëtare.

Në terma afatgjatë Programet e Mbrojtjes Rajonale pritet të realizojnë një sërë qëllimesh: vendet e treta që përfitojnë ndihmë do të adoptojnë ose ndryshojnë legjislacionin kombëtar të azilit në përputhje me standartet ndërkombëtare, do të arrihen standartet e dëshiruara në procesin e pritjes dhe pranimit të azilkërkuesve, do të përmirësohet infrastruktura lokale, si dhe do të japin ndihmë për kthimin e azilantëve në vendet e origjinës dhe rivendosjen e tyre në këto territore.

Në kuadër të MSA-së dhe veçanërisht nenit 80 të saj, Shqipëria dhe Komuniteti Europian do të bashkëpunojnë për të siguruar respektimin e të drejtave të refugjatëve dhe azilkërkuesve.

<sup>99</sup>**Migrimi / Migration** – Lëvizje e personave që kërkojnë një standart më të mirë jetese. Politika e migrimit u vendos nën përgjegjësinë e plotë të Komunitetit Europian me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit në 1 maj 1999. Baza ligjore dhe politike e politikës europiane të migrimit janë Traktati Themelues i Komunitetit Europian, Plani i Veprimit i Vjenës (1998), Këshilli Europian i Tamperes (1999), Këshilli Europian i Laekenit (2001), dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian.

Politika europiane e migrimit përfshin elementët e mëposhtëm: kushtet e hyrjes, standartet për procedurat e dhënies së vizave afatgjata dhe lejeve të qëndrimit, përfshirë edhe ato mbi bashkimin familjar; masat kundër migrimit dhe qëndrimit të paligjshëm, duke përfshirë dhe riatdhesimin e migrantëve të paligjshëm; masat që përcaktojnë të drejtat dhe kushtet për banim që shtetasit e vendeve të treta, rezidentë të ligjshëm në një Shtet Anëtar, të mund të banojnë në Shtetet e tjera Anëtare, etj.

Në nenin 80 të MSA-së, Shqipëria dhe Komuniteti Europian do të bashkëpunojnë për të siguruar respektimin e të drejtave të migrantëve, siç përcaktohet në të drejtën ndërkombëtare.

<sup>100</sup>**Konventa e Gjenevës 1951 / 1951 Geneva Convention** – Është Konveta e OKB-së “Mbi Statusin e Refugjatit”. Për herë të parë në këtë konventë përkufizohet termi “refugjat”, duke kontribuar në këtë mënyrë në përcaktimin e statusit të tij. Konventa u garanton refugjatëve një sërë të drejtash dhe detyrimesh.

<sup>101</sup>**Protokolli i Nju-Jorkut 1967 / 1967 New York Protocol** – Është Protokolli shtesë që zgjeron dhe plotëson Konventën e OKB-së “Mbi Statusin e Refugjatit”. Ndër të tjera, në këtë dokument parashikohen

masa lidhur me bashkëpunimin e autoriteteve kombëtare me ato të OKB-së, si edhe detyrimin për informim të Sekretarit të Kombeve të Bashkuara lidhur me zhvillimet dhe ndryshimet në legjislacionin kombëtar mbi refugjatët.

<sup>102</sup>**Parimi “non-refoulement” / Principle of non-refoulement** – Parimi non-refoulement ose i moskthimit konsiderohet si një nga parimet kryesore të të drejtës ndërkombëtare për refugjatët. Sipas tij, asnjë Shtet në asnjë mënyrë nuk duhet të kthejë mbrapsht një refugjat në territoret ku jeta ose liria e tij mund të rrezikohet seriozisht për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo për shkak të bindjeve politike. Ky parim duhet të zbatohet gjithashtu edhe për azilkërkuessve. Parimi “Non-refoulement” përmendet shprehimisht në nenin 33 të Konventës “Mbi Statusin e Refugjatit” të vitit 1951 dhe formon bazën ligjore të detyrimit të Shteteve për t’u siguruar mbrojtje ndërkombëtare atyre që kanë nevojë për të. Neni 33 (1) parashikon si vijon: “Asnjë Shtet Kontraktues nuk duhet të dëbojë ose kthejë një refugjat në ndonjë lloj mënyrë në kufijtë e territoreve ku jeta ose liria e tij do të kërcënohet për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup et caktuar shoqëror ose për shkak të bindjeve politike”. Ai pasqyrohet edhe në konkluzionet e Këshillit Europian të Tamperës të tetorit 1999. Neni 3 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe neni 3 i Konventës së OKB-së kundër Torturës, Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Degraduese, imponojnë gjithashtu zbatimin e parimit “Non-refoulement”.

Neni 80 i MSA-së i detyron Shqipërinë dhe Komunitetin që të respektojnë parimin “Non-refoulement” në kuadër të lëvizjes së lirë të personave.

<sup>103</sup>**Refugjat / Refugee** – Person që plotëson kërkesat e nenit 1(A) të Konventës “Mbi Statusin e Refugjatit” (1951). Faktori përcaktues për dhënien e statusit të refugjatit sipas Konventës së Gjenevës është ekzistenca e një frike të mirëbazuara se personi në fjalë mund të persekutohet për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup social të veçantë ose për shkak të bindjeve politike.

## ■ NENI 81

<sup>104</sup>**Ripranimi / Readmission** – Rikthimi i një shtetasi të një vendi të tretë në vendin e tij të origjinës ose të tranzitit. Baza ligjore për ripranimin vjen nga Këshilli Europian i Tamperes (1999) dhe Marrëveshja e Shengenit (2000). Këshilli Europian ka kërkuar që t’u ofrohet ndihmë vendeve të origjinës dhe të tranzitit në mënyrë që të promovohet kthimi vullnetar dhe të ndihmohen autoritetet e atyre vendeve për të rritur aftësinë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në këtë mënyrë ato do të jenë në gjendje të përmbushin detyrimet e ripranimit ndaj Bashkimit Europian dhe Shteteve Anëtare.

Traktati i Amsterdimit (1997) i kaloi çështjet e ripranimit si kompetenca të Komunitetit. Me propozim të Këshillit Europian, Këshilli përfundon marrëveshje ripranimi ose vendos klauzola standarte në marrëveshje të tjera ndërmjet Komunitetit Europian dhe vendeve ose grupeve të vendeve të treta përkatëse.

Sipas nenit 81 të MSA-së, Shqipëria dhe Komuniteti duhet të parandalojnë dhe kontrollojnë migrimin e paligjshëm, si dhe të ripranojnë shtetasit shqiptarë dhe komunitarë, ose ata të vendeve të treta, që kanë kaluar tranzit në territorin e palës tjetër dhe qëndrojnë në atë territor në mënyrë të paligjshme. Për arritjen e këtij objektiv, Shqipëria (përkatësisht Komuniteti) angazhohet të pajisë shtetasit e saj me dokumenta të përshtatshëm identifikimi, të nënshkruajë Marrëveshje Ripranimi me Komunitetin Europian (përkatësisht Shqipërinë) dhe me vendet e

procesit të Stabilizim-Asociimit. Shqipëria e ka nënshkruar tashmë Marrëveshjen e Ripranimit me Komunitetin Europian (në prill 2005). Kjo marrëveshje e detyron Shqipërinë të ripranojë shtetasit shqiptarë që gjenden në mënyrë të paligjshme në territorin e Komunitetit, si dhe të ripranojë shtetasit e vendeve të treta (as shqiptarë, as komunitarë) dhe personat pa shtetësi, të cilët kanë hyrë në territorin e Bashkimit Europian nëpërmjet Shqipërisë.

<sup>105</sup>**Shtetasit / Citizens** – Shtetësia e Bashkimit është shtetësi e dytë, e cila nuk zëvendëson shtetësinë e shteteve anëtare. Shtetësinë Europiane (të BE-së) e ka çdo person që ka shtetësinë e një prej shteteve anëtare. Njihet dhe vendoset si koncept në Traktatin e Maastrichtit (1992). Kjo shtetësi është burim i disa të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në traktate, si e drejta e votës, e udhëtimit, e punës, e mbrojtjes diplomatike, e tjerë.

<sup>106</sup>**Shtetas të vendeve të treta / Third country citizens** – Shtetas të çdo vendi tjetër përveç Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian. Sipas nenit 81 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, lidhur me lëvizjen e lirë të njerëzve në territoret e palëve përkatëse, shtetasve të vendeve të treta nuk u akordohet i njëjti trajtim si shtetasve të BE-së dhe Shqipërisë.

## ■ NENI 82

<sup>107</sup>**Veprimtari kriminale / Criminal activity** – Veprime dhe sjellje në kundërshtim të hapur me ligjin dhe rendin publik. Edhe Bashkimi Europian koordinon luftën kundër aktiviteteve kriminale, veçanërisht kundër kimit të organizuar, i cili operon përmes kufijve. Që prej Traktatit të Amsterdimit, BE ka marrë një rol më të madh në koordinimin e forcave kombëtare për të luftuar veprimtaritë kriminale.

Sipas nenit 82 të MSA-së, palët duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht për parandalimin edhe të veprimtarive kriminale në përgjithësi.

<sup>108</sup>**Grupi i Përbashkët për Veprimin Financiar / Financial Action Task Force** – Ndaj fenomenit të pastrimit të parave, në Samitin e Grupit të Të Shtatëve (SHBA, Japonia, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Italia dhe Kanadaja) të mbajtur në Paris në 1989 u vendos krijimi i Grupit të Përbashkët për Veprimin Financiar (FATF).

Grupi i Përbashkët për Veprimin Financiar është një mekanizëm ndërqeveritar, që synon zhvillimin dhe promovimin e politikave, në nivelin kombëtar ashtu dhe ndërkombëtar, për të luftuar fenomenin e pastrimit të parave dhe financimin e terroristëve. Pra FATF është një “mekanizëm politikë-bërës”, i cili synon të gjenerojë vullnetin politik të nevojshëm për të bërë të mundur reformat kombëtare legjislative dhe rregullatore në këto fusha. Grupi i Përbashkët për Veprimin Financiar përmendet në nenin 82 të MSA-së.

## ■ NENI 83

<sup>109</sup>**Strategjia e BE-së për Drogën / EU Drug Strategy** – Kjo strategji synon të mbrojë dhe përmirësojë mirëqënien e shoqërisë dhe të individit, të mbrojë shëndetin publik, të ofrojë një nivel të lartë sigurie për publikun e gjerë dhe të ndërmarrë një qasje të balancuar e të integruar për problemin e drogave. Dëmtimi i shëndetit publik për shkak të përdorimit të drogës trajtohet në nenin 152 të Traktatit të Komunitetit Europian. Gjithashtu lufta kundër shitjes së paligjshme ndërkufitare të drogës bën pjesë në bashkëpunimin policor të Europolit.

Në nenin 83 të MSA-së parashikohet që Shqipëria dhe Komuniteti të

ndërmarrin masa për të kontrolluar drogën dhe për të minimizuar sa më shumë që të jetë e mundur ofertën, trafikimin dhe kërkesën për drogat e paligjshme, në përputhje me Strategjinë e BE-së për

#### ■ NENI 84

**<sup>110</sup>Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1373 / Security Council Resolution 1373** – Rezolutë që dënon sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përmes saj kërkohet të merren masa për të parandaluar dhe luftuar aktet terroriste, ndër të cilat rëndësi të veçantë paraqesin parandalimi i financimit të këtyre akteve, ngrirja e fondeve dhe asetëve të personave të lidhur drejtpërsëdrejti ose jo me aktet terroriste, parandalimi i lëvizjes së individëve dhe grupeve terroriste nëpërmjet forcimit të kontrollit kufitar dhe i dokumentave të identifikimit e udhëtimit, e tjerë.

Sipas nenit 84 të MSA-së, palët angazhohen që në zbatim të Rezolutës së mësipërme, të bashkëpunojnë për të parandaluar dhe eliminuar aktet terroriste.

#### ■ NENI 85

**<sup>111</sup>Kontrabanda / Smuggling** – Transport i paligjshëm në territorin e një shteti ose përtej kufijve shtetërorë të mallrave që duhet t'u nënshtrohen tarifave doganore, ose që nuk lejohen. Baza ligjore për luftën ndaj kontrabandës vjen nga Traktati i Bashkimit Europian, Plani i Veprimit i Vjenës (1998), Këshilli Europian i Ferias (2000), Këshilli Europian i Tamperes (1999) dhe Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, e tjerë.

Policia e BE-së dhe zyrtarët e doganave bashkëpunojnë ngushtësisht për të parandaluar kontrabandën e drogës, armëve të zjarrit, materialeve nukleare, pornografisë dhe mallrave që u nënshtrohen taksave indirekte.

Sipas nenit 85 të MSA-së, Komuniteti dhe Shqipëria do të bashkëpunojnë për të parandaluar dhe luftuar fenomenin e kontrabandës.

**<sup>112</sup>Falsifikimi i monedhave / Counterfeiting of currencies** – Futja e një monedhe të re krijon mundësi për mashtrim dhe falsifikim. Parandalimi i këtyre fenomeneve është një përparësi në luftën e BE-së kundër krimit financiar.

Sipas nenit 85 të MSA-së, Komuniteti dhe Shqipëria do të bashkëpunojnë për të parandaluar dhe luftuar fenomenin e falsifikimit të monedhave.

**<sup>113</sup>Produktet e falsifikuara / Counterfeit products** – Produkte që imitojnë ose kopjojnë në mënyrë të paligjshme produktet origjinale. Në kuadër të BE-së, mekanizmat kryesorë për parandalimin e falsifikimit janë Konventa për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve Europiane dhe ngritja e Zyrës Europiane Anti-Mashtrim.

Në nenin 85 të MSA-së parashikohet që Komuniteti dhe Shqipëria do të bashkëpunojnë për të parandaluar dhe luftuar fenomenin e prodhimit të produkteve të paligjshme ose të falsifikuara.

#### ■ NENI 86

**<sup>114</sup>Politikat e bashkëpunimit / Co-operation policies** – Komuniteti dhe Shqipëria duhet të bashkëpunojnë për të zhvilluar politikat ekonomike dhe sociale me synim forcimin e lidhjeve ekzistuese me vendet anëtare dhe zhvillimin ekonomik e social të shtetit shqiptar.

Në nenin 177 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian theksohet rëndësia e zhvillimit të politikave të bashkëpunimit, të afta për të nxitur

një zhvillim social dhe ekonomik të qëndrueshem në luftë kundër varfërisë, në integrimin gradual të vendeve më të pafavorizuara, si dhe luftës kundër varfërisë. Komuniteti duhet të mbështesë këto vende në arritjen e objektivave për forcimin e demokracisë, forcimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Në nenin 86 të MSA-së, vihet në dukje nevoja e thellimit të bashkëpunimit me vendet e rajonit, me qëllim përfitimin reciprok dhe stabilitetin rajonal.

## ■ NENI 87

### <sup>115</sup>**Bashkimi ekonomik dhe monetar / Economic and Monetary Union**

- Një nga objektivat kryesore që duhet të arrihet nga Komuniteti. Parashikohet shprehimisht në nenin 2 të Traktatit të Komunitetit Europian (TKE). Qëllimi është të zhvillojë më tej procesin integrues europian. Kushtet dhe afatet për zbatimin e këtij objektiivi janë përcaktuar shprehimisht në Traktatin e Maastrichtit të vitit 1992. Faza e parë e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar filloi në vitin 1990, qëllimi i së cilës ishte përafrimi i standarteve ekonomike të shteteve anëtare. Faza e dytë ka filluar në vitin 1994, gjatë së cilës shtetet anëtare kanë synuar kryesisht stabilitetin e monedhave kombëtare, unifikimin e interesave bankare, kontrollin efektiv dhe disiplinimin e buxhetit shtetëror e tjerë. Gjatë kësaj faze u krijua gjithashtu edhe Instituti Monetar Europian, qëllimi i të cilit ishte marrja e masave paraprake për krijimin e Bankës Qendrore Europiane. Faza e tretë filloi në vitin 1999 dhe shënon njëkohësisht edhe fazën e fundit të këtij procesi. Si zhvillime më të rëndësishme të kësaj faze veçohet krijimi i Bankës Qendrore Europiane me qendër në Frankfurt, veprimtaria e së cilës ka filluar që nga 1 qershori 1998. Element tjetër i rëndësishëm është edhe futja në përdorim e Euros, nga 1 Janari 2002. Traktati i Lisbonës (neni 9) e parashikon për herë të parë Bankën Qendrore Europiane si institucion i veçantë i BE-së.

Sistemi i Euro menaxhohet dhe administrohet nga Banka Qendrore Europiane (BQE), e cila ka autoritetin për të përcaktuar politikën monetare të Bashkimit Europian. Një shtet anëtar i BE-së, mund të fusë në qarkullimin e saj kombëtar monedhën e përbashkët europiane, pasi të përmbushë disa standarte dhe nivele ekonomike të përcaktuara më përpara.

Në nenin 87 të MSA-së kërkohet të zbatohen politika ekonomike në përputhje me objektivat e mësipërme si dhe marrjen e masave për shkëmbim të informacionit në lidhje me parimet dhe funksionimin e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar të Bashkimit Europian.

## ■ NENI 88

### <sup>116</sup>**Bashkëpunimi statistikor / Statistical co-operation**

– Sipas nenit 285 të Traktatit të Komunitetit Europian, kërkohet marrja e masave për krijimin e statistikave që do të ndihmojnë mbarëvajtjen e aktiviteteve të Komunitetit në bazë të të dhënave reale, të pavarura dhe objektive, pa cënuar veprimtarinë ekonomike e sociale të Komunitetit. Ndërsa sipas nenit 117 të këtij Traktati, përcaktohet si detyrë e Institutit Monetar Europian harmonizimi i shpërndarjes së të dhënave që janë në kompetencën e tij.

Duke u bazuar në acquis, statistika është një nga fushat kryesore ku kërkohet një bashkëpunim i mirëfilltë mes palëve. Në rastin e Shqipërisë, këto objektiva realizohen përmes forcimit të kompetencave të Institutit të Statistikave (INSTAT).

Sipas nenit 88 të MSA-së, sistemi statistikor shqiptar duhet të respektojë parimet bazë të statistikave që kërkohen nga Kombet e Bashkuara dhe ato të ligjit Europian të Statistikave, me qëllim sigurimin e një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm statistikor, të aftë për të ofruar të dhëna objektive e të sakta, për të planifikuar e ndjekur procesin e reformave.



### ■ NENI 89

<sup>117</sup>**Sektori i sigurimeve / Insurance services sector** – Sistemi i sigurimit për jetën, pronën ose biznesin bazohet në kontratën respektive lidhur mes palëve, e cila përfundohet sipas ligjit dhe shërben si garanci për të mbrojtur klientin nga rreziqet. Thelbi i kontratës është përfitimi i dyanshëm, ku përfaqësuesi i kompanisë së siguracionit mund të marrë në konsideratë rrezikun fizik, psikologjik dhe moral në raport me të siguruarin.

Ne nenin 89 të MSA-së, palës shqiptare i kërkohet të bashkëpunojë në fushat e shërbimeve bankare, sigurimeve dhe sektorin financiar, me qëllim zhvillimin e tyre në të ardhmen.

### ■ NENI 90

<sup>118</sup>**Auditim / Audit** – Është kontrolli që ushtrohet mbi bilancin dhe veprimet kontabël të një shoqërie nga ana e eksperteve kontabël të autorizuar, me qëllim të verifikimit të të dhënave të tyre, respektimit të rregullave të regjistrimit e të vlerësimeve kontabël. Këto hartojnë raportin e tyre të veçantë, në të cilin bëjnë vlerësimet dhe vërejtjet e tyre në lidhje me bilancin kontabël të kontrolluar.

Në nenin 90 të MSA-së, bashkëpunimi Shqipëri – BE duhet të përqendrohet në zhvillimin e një sistemi kontrolli kontabël në përputhje me metodat dhe procedurat e Komunitetit.

<sup>119</sup>**Kontrolli financiar / Financial control** – Quhet kontrolli që ushtron çdo shoqëri për sigurimin e përdorimit më të mirë të mjeteve financiare dhe uljen maksimale të shpenzimeve në çdo sektor. Ka për qëllim arkëtimin e një shume më të madhe e në kohën e duhur të të ardhurave, si dhe për koordinimin optimal të shumës së arkëtimeve e të pagesave sipas afateve.

Në nenin 90 të MSA së kërkohet bashkëpunimi për zhvillim të sistemit të kontrollit financiar në përputhje me metodat dhe procedurat e Komunitetit.

### ■ NENI 92

<sup>120</sup>**Bashkëpunimi në fushën e industrisë / Industrial co-operation** – Sipas nenit 157 të Traktatit të Komunitetit European, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë kushtet e nevojshme për nxitjen e aftësive konkurruese dhe zhvillimin e industrisë së Komunitetit. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar hartimit dhe zbatimit të politikave që nxisin kërkimin shkencor dhe zbatimin e teknologjive bashkëkohore.

Sipas nenit 92 të MSA-së, institucionet përgjegjëse shqiptare duhet të arrijnë standartet bashkëkohore në këtë fushë. Për këtë qëllim duhet bërë ristrukturimi i industrisë shqiptare, të garantohet bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik më qëllim forcimin e sektorit privat, të sigurohet mbrojtja sa më e mirë e mjedisit, e tjerë. Ky bashkëpunim duhet bërë në bazë të Acquis së Komunitetit në fushën e politikave industriale.

### ■ NENI 93

<sup>121</sup>**Karta Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla / European Charter for Small Enterprises** – Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme janë shtylla të ekonomisë Evropiane. Ato janë burim kryesor i punësimit dhe mund të konsiderohen si nxitësit e parë të integrimit social dhe ekonomik. Europa do të zhvillohet si duhet ekonomikisht vetëm nëse i jepet rëndësia dhe i kushtohet kujdesi i duhur këtyre ndërmarrjeve. Për këtë qëllim, në Traktatin e Lisbonës u përcaktua si një nga synimet kryesore të BE-së, zhvillimi i një tregu më konkurrues dhe të ndjeshëm për të gjitha bizneset.

Në nenin 93 të MSA-së kërkohet mbështetja e sektorit privat, ndërmarrjet e vogla e të mesme dhe të zbatohen parimet e dala në Kartën Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla.

#### ■ NENI 94

<sup>122</sup>**Turizmi / Tourism** – Në dekadat e fundit ka qenë dhe mbetet një nga fenomenet sociale dhe ekonomike më të rëndësishme. Turizmi konsiderohet si “lëvizja e njerëzve, në kohë dhe në hapësirë, larg vendbanimeve të tyre, për qëllime argëtimi apo biznesi”. Një turist përkufizohet nga Organizata Botërore e Turizmit (OBT) si një “vizitor që qëndron më shumë se 24 orë në një vend të vizituar për qëllime argëtimi apo biznesi”.

Sipas nenit 94 të MSA-së, Shteti shqiptar duhet të punojë për të përafuar legjislacionin shqiptar me atë Komunitar si dhe duhet t'i japi rëndësi bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit në këtë fushë.

#### ■ NENI 99

<sup>123</sup>**Sistemi i sigurisë sociale / Social security system** – Komuniteti bazohet në të drejtat sociale themelore që burojnë nga Karta Sociale Evropiane e 18 tetorit 1961 dhe Karta e Komunitetit për të Drejtat Themelore të Punonjësve. Në këtë fushë, Komuniteti ka si objektiv nxitjen e punësimit, përmirësimin e kushteve të punës, luftës kundër përjashtimit social, informimin dhe konsultimin e punonjësve, objektiva të cilat shprehen qartë në nenet 136 dhe 137 të Traktatit të Komunitetit Evropian.

Sipas nenit 99 të MSA-së, pala shqiptare në bashkëpunim me atë Komunitare duhet të marrë masa efektive për të përshtatur sistemin social dhe shëndetësor të punonjësve duke ju referuar për këtë qëllim nivelit mbrojtës të Komunitetit.

#### ■ NENI 100

<sup>124</sup>**Arsimi dhe kualifikimi / Education and training** – Ndër detyrimet prioritare të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Sipas nenit 149-150 të Traktatit të Komunitetit Evropian, Komuniteti kontribuon në zhvillimin e një sistemi arsimor cilësor në bazë të bashkëpunimit dhe mbështetjes midis shteteve anëtare. Synim kryesor është zhvillimi tërësor i arsimit dhe nxitja e bashkëpunimit midis shkollave të ndryshme evropiane, universiteteve (në kuadër të sistemit Erasmus) dhe shkollave për formim profesional (në kuadër të programit Leonardo da Vinci). Fondacioni Evropian i Trajnimit mbështet dhe koordinon reformën në sistemin e kualifikimit profesional, si Programi FP7 etj.

Sipas nenit 100 të MSA-së, Shqipërisë i kërkohet të rrisë nivelin e arsimit të përgjithshëm dhe kualifikimit profesional, një akses arsimor pa diskriminim dhe në sistemin e lartë arsimor të përmbushen objektivat e Deklaratës së Bolonjës. Programi Tempus do të kontribuojë në zhvillimin e burimeve njerëzore, shoqërinë civile duke forcuar bashkëpunimin mes palëve në fushën e arsimit të lartë, me fokus kryesor në forcimin institucional, manaxhimin e universiteteve, zhvillimin e nivelit profesional të individit, e tjerë. Fondacioni i Trajnimit Evropian do të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin e strukturave të kualifikimit dhe aktiviteteve të tjera në Shqipëri. Bashkëpunimi do të marrë parasysh fushat prioritare lidhur me legjislacionin komunitar në këtë fushë.

#### ■ NENI 101

<sup>125</sup>**Bashkëpunimi kulturor / Cultural co-operation** – Që prej vitit 1970 janë marrë shumë iniciativa kulturore evropiane, por BE e ka trajtuar zyrtarisht fushën e bashkëpunimit evropian në vitin 1992 në Traktatin e

Maastrichtit. Në nenin 151 të Traktatit të Komunitetit Europian, theksohet se Komuniteti kontribuon në zhvillimin e plotë të kulturave të shteteve anëtare, por gjithnjë duke respektuar karakteristikat e tyre kombëtare e rajonale, dhe duke vënë në dukje në të njëjtën kohë trashëgiminë e përbashkët kulturore. Ky bashkëpunim inkurajohet nga Programi Kulturor 2000 dhe përmes veprimtarive të ndryshme kulturore të financuara nga programe të tjera europiane. Në këto programe përfitojnë si vendet anëtare ashtu edhe ato aplikante. Rezoluta e Parlamentit Europian e 5 shtatorit 2001, inkurajon krijimin e një "zone të kulturës europiane" të bashkëpunimit mes vendeve anëtare.

Sipas nenit 101 të MSA-së palët, Shqipëria dhe Komuniteti Europian marrin përsipër të nxisin bashkëpunimin kulturor. Ky bashkëpunim do t'i shërbejë ndër të tjera edhe rritjes së mirëkuptimit të ndërsjellë dhe vlerësimit midis individëve, komuniteteve dhe popujve. Gjithashtu, palët marrin përsipër të nxisin diversitetin kulturor, veçanërisht në kuadër të Konventës së UNESCO-s "Për mbrojtjen dhe nxitjen e larmisë kulturore".

## ■ NENI 102

<sup>126</sup>**Bashkëpunimi në fushën audiovizuale / Co-operation in the audio-visual field** – Aktiviteti i Komunitetit në fushën audio-vizuale është zhvilluar në dy drejtime.

1) Në drejtimin industrial, për të cilin në vitin 1986 është miratuar një direktivë "Mbi programet kabllore dhe satelitore". Në vitin 1989 u miratua një direktivë tjetër për zhvillimin e televizionit.

Që nga viti 1991, Programi i Medias Komunitare, ka mbështetur industrinë audiovizuale duke inkurajuar shpërndarjen e prodhimeve europiane, dhe

2) Në drejtimin ligjor ku duhet veçuar Direktiva për një Televizion pa Kufi, e miratuar në vitin 1989 dhe e amenduar më pas në vitin 1997. Kjo direktivë ka ndikuar pozitivisht në lëvizjen e lirë të prodhimeve televizive dhe shpërndarjen e programeve televizive europiane.

Politikat audio-vizuale të Komunitetit respektojnë interesat dhe rregullat e konkurrencës, parimet e shërbimit publik dhe të drejtat e autorit.

Bashkëpunimi mes vendeve europiane synon zhvillimin e kësaj industrie, sidomos në fushën televizive dhe të kinematografisë.

Sipas nenit 102 të MSA-së, Shqipëria duhet të bashkëpunojë për të zhvilluar industrinë audio-vizive në përputhje me standartet dhe acquis e Bashkimit Europian.

## ■ NENI 103

<sup>127</sup>**Shoqëria e informacionit / Information Society** – Shoqëria e Informacionit është sinonim i "teknologjive të reja të informimit dhe komunikimit, TIK", që ka njohur një zhvillim tepër të madh pas viteve '90. Shkëmbimi universal i informacionit dhe interneti kanë fuqizuar së tepërmi tregun e telekomunikacionit. Shoqëria e informacionit ka evoluuar shumë fusha të jetës së përditshme. Në këtë kuadër, BE-ja e konsideron atë si zëmren e strategjisë së shekullit të XXI. Mes shumë iniciativave, janë marrë masa për të mbështetur Planin e Veprimit të eEurope (eEurope Action Plan), duke nxitur përdorimin e sigurtë të internetit dhe duke përgatitur shoqërinë për erën dixhitale.

Sipas nenit 103 të MSA-së, bashkëpunimi midis palëve do të përqendrohet në fushat prioritare lidhur me përafrimin e legjislationit komunitar mbi shoqërinë e informacionit. Ai do të mbështesë kryesisht përafrimin gradual të Shqipërisë në politikat dhe legjislationin në këtë sektor me ato të Komunitetit. Palët gjithashtu do të bashkëpunojnë me synim zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë së informacionit në Shqipëri. Objektivat globale do të përgatisin të gjithë shoqërinë për erën dixhitale,

duke terhequr investimet dhe siguruar ndërveprimin e rrjeteve dhe shërbimeve.

#### ■ NENI 104

<sup>128</sup>**Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik / Electronic communications infrastructures** – Liberalizimit të telekomunikacionit iu dha përparësi në vitin 1987 nga Komuniteti Europian.

Një udhëzim i miratuar në vitin 1990 liberalizoi shërbimet e telekomunikacionit. Në vitin 1994, ajo u zgjerua për komunikimet satelitore dhe më pas në vitin 1996 për rrjetet e televizionit kabllor dhe për telefoninë celulare. Në vitin 1999, Komisioni Europian nisi detyrën e riformulimit të kuadrit rregullator europian për telekomunikacionet. Qëllimi i përgjithshëm ishte përmirësimi i të drejtës për përdorim në shoqërinë e informacionit, duke vendosur një ekuilibër ndërmjet rregullores së sektorit dhe rregullave të Europës për konkurrencën.

Sipas nenit 104 të MSA-së, pala shqiptare duhet të bashkëpunojë në forcimin e infrastrukturës së telekomunikacionit elektronik dhe shërbimet e përbashkëta, me objektivi primar adoptimin e legjislacionit komunitar në këta sektorë.

#### ■ NENI 105

<sup>129</sup>**Informacioni dhe komunikimi / Information and Communication**

– Në nenin 137 të Traktatit të Komunitetit Europian përmendet ndër të tjera edhe rëndësia e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare. Në këtë kuadër ato duhet të marrin masat e nevojshme për përmirësimin e informacionit reciprok në fusha të ndryshme të zhvillimit, veçanërisht atë të punësimit, arsimit, shëndetit publik, financës, e tjerë.

Sipas nenit 105 të MSA-së, pala shqiptare duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të stimuluar shkëmbimin reciprok të informacionit. Prioritet do t'i jepet programeve që synojnë transmetimin e informacioneve mbi Komunitetin për publikun e gjerë dhe informacione më të detajuara për rrethe të caktuara profesionale.

#### ■ NENI 106

<sup>130</sup>**Transporti / Transport** – Në nenet 70 – 80 të Traktatit të Komunitetit

Europian, sektorit të transporteve i kushtohet një rëndësi e veçantë, sidomos krijimit të një rrjeti transporti të përbashkët (rrjetet trans-europiane) dhe vendosjes së rregullave europiane në përputhje me ato ndërkombëtare. Synohet krijimi i kushteve lehtësuese për një transport të sigurtë tokësor, detar e tokësor (lehtësirat e transportit) dhe mundësi shërbimi e mbështetje për kompanitë jo-rezidente. Masat që duhen marrë për përmirësimin e kushteve të transportit duhet të kenë një impakt pozitiv në kushtet e jetesës, punësimit etj.

Sipas nenit 106 të MSA-së, kërkohet bashkëpunim ndërmjet palëve, i cili do të synojë ristrukturimin dhe modernizimin e transportit shqiptar, duke përmirësuar lëvizjen e lirë të mallrave dhe pasagjerëve, duke rritur aksesin në tregjet dhe lehtësirat e transportit, duke përfshirë portet dhe aeroportet, për të mbështetur zhvillimin e një infrastrukture të shumëllojshme në lidhje me rrjetet më të rëndësishme Trans-Europiane, kryesisht për të forcuar lidhjet rajonale, për të arritur standarte operative të njëjta me ato komunitare, duke zhvilluar një sistem të përshtatshëm transporti në Shqipëri, të përafërt me atë komunitar dhe me synim përmirësimin dhe mbrojtjen e ambientit të transportit.

#### ■ NENI 107

<sup>131</sup>**Energjia / Energy** – Rreth 80% e konsumatorëve evropianë përdorin naftën, gazin natyror dhe qymyrin si burime energjie. Një pjesë e madhe

e kësaj lënde të parë vjen nga jashtë Europës. Energjia dhe burimet e saj përbëjnë sot një nga shqetësimet më të mëdha në planin global dhe atë evropian.

Zhvillimi i qëndrueshëm nënkupton përdorimin e burimeve që prodhojnë energji në mënyrë inteligjente. Nga ana e Shteteve Anëtare janë marrë masa strategjike për të reduktuar problemet që lidhen me shpërdorimin, ndotjen e ambientit si dhe luhatjen e çmimeve për energjinë në tregun botëror. Dialog i rëndësishëm zhvillohet më Rusinë, si një nga vendet me potencial të lartë prodhues të energjisë. Një treg konkurrues ndihmon përdorimin eficient të energjisë edhe nëpërmjet politikave mbrojtëse.

Sipas nenit 107 të MSA-së, kërkohet të reflektohen parimet e ekonomisë së tregut dhe të Kartës Europiane të Energjisë, duke përfshirë këtu edhe çështjet e sigurisë bërthamore.

## ■ NENI 108

<sup>132</sup>**Mjedisi / Environment** – Mbrojtja e mjedisit është thelbësore për të përmirësuar cilësinë e jetesës së gjeneratës aktuale dhe të brezave që do të vijnë. Politikat evropiane besojnë se niveli i lartë i standarteve mjedisore, stimulon rritjen dhe mundësitë për zhvillimin e biznesit, duke i kombinuar këto me rritjen e qëndrueshme ekonomike. Politikat sociale, ekonomike dhe ato të mjedisit shihen si të integruara me njëra-tjetrën.

Shtetet Anëtare kanë si detyrë të sigurojnë mbrojtjen e mjedisit, siç përcaktohet edhe në nenin 174 të Traktatit të Komunitetit Evropian. Kërkesat për mbrojtjen e mjedisit kanë fituar peshë më të madhe në politikat e tjera të Komunitetit duke synuar ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut, përdorimin e matur dhe me kriter të burimeve natyrore, mbrojtjen nga degradimi mjedisor etj. Gjithashtu, kjo politikë synon të nxisë marrjen e masave në nivel ndërkombëtar për të përballuar problemet rajonale dhe botërore mbi çështjet e mjedisit. Në këtë kuadër kërkohet edhe bashkëpunimi mes palëve për të krijuar klimën e duhur për një mjedis të qëndrueshëm.

Më konkretisht, në Programin Evropian të Veprimit për Mjedisin, të quajtur “Mjedisi 2010-e ardhmja jonë, zgjedhja jonë”, theksohet nevoja e marrjes së masave të nevojshme për të përballuar me efektivitet ndryshimet e klimës dhe ngrohjen globale, mbrojtja e florës dhe faunës, përballimi i çështjeve të ambientit dhe shëndetit, mbrojtjes së burimeve natyrore, e tjerë.

Sipas nenit 108 të MSA-së, Shqipërisë i kërkohet të fokusohet në përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë komunitar në fushën e mjedisit dhe të fuqizojë bashkëpunimin në luftën kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

<sup>133</sup>**Degradimi mjedisor / Environmental degradation** – Degradimi mjedisor ka të bëjë me përkeqësimin e cilësisë së mjedisit nga ndotësit e ambientit si dhe nga aktivitete e procese që e dëmtojnë atë, si keqpërdorimi i tokës, fatkeqësitë natyrore, e tjerë.(neni 108 i MSA-së)

## ■ NENI 109

<sup>134</sup>**Kërkimi shkencor / Scientific research** – Politikat për kërkim shkencor dhe zhvillim teknologjik zënë një vend të rëndësishëm në Traktatin Themelues të Komunitetit Evropian. Ato synojnë mbështetjen e konkurrencës në industrinë evropiane dhe nxitjen e zhvillimit të teknologjive bashkëkohore. Koordinimi i iniciativave për kërkim shkencor dhe zhvillim teknologjik bazohet në instrumenta të ndryshëm, mes të cilëve mund të veçohen: a) Programet Kuadër, që i kushtohen teknologjisë së komunikimit, ambientit, biologjisë, energjisë, transportit

dhe kërkimeve shkencore, dhe b) Aktivitetet e Qendrës së Përbashkët Kërkimore (JRC), e përbërë nga 8 institute kërkimore të shpërndara në vende të ndryshme evropiane.

Në nenin 163 të Traktatit të Komunitetit Europian, inkurajohet forcimi i bazave shkencore dhe teknologjike të industrisë evropiane në mënyrë që të rritet aftësia konkurruese e saj në nivel ndërkombëtar. Në këtë kuadër rëndësi paraqet edhe inkurajimi i sipërmarrjeve të vogla e të mesme, të cilat i kushtohen fushës së kërkimeve si dhe rritjes së potencialit tregtar kombëtar, nëpërmjet hapjes së kontratave publike, për arritjen e standarteve të përbashkëta dhe heqjen e barrierave fiskale.

Në nenin 109 të MSA-së, nxitet bashkëpunimi në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik, duke marrë parasysh burimet ekzistuese, aksesin e mjaftueshëm në programet respektive, etj.

## ■ NENI 111

<sup>135</sup>**Administrata Publike/Public Administrations**—Formëveve primtarisë shtetërore, krahas asaj ligjvënëse e gjyqësore, për të ushtruar pushtetin shtetëror nëpërmjet organizimit të drejtpërdrejtë të funksioneve të shtetit e të veprimtarisë ekzekutive-urdhërdhënëse. Administrata publike ka të bëjë me institucionet publike, me strukturat administrative që përbëjnë bazën e marrjes dhe të zbatimit të vendimeve, si dhe rregullat sipas të cilave kryhen shërbimet publike. Nocioni “administratë publike” është më i gjerë se sa nocioni administratë shtetërore, sepse ai përfshin në vete përveç veprimtarisë së administratës shtetërore edhe veprimtarinë e institucioneve përkatëse të cilat nuk kanë karakter shprehimor të organeve shtetërore, por ushtrojnë punë të karakterit publik.

Sipas nenit 111 të MSA-së, synohet zhvillimi i një administrate publike efektive dhe të përgjegjshme në kuadër të respektimit të parimit të shtetit të së drejtës dhe funksionimit normal të institucioneve shtetërore.

## ■ NENI 112

<sup>136</sup>**Banka Europiane e Investimeve / European Investment Bank** – Është krijuar në vitin 1958 nga Traktati i Romës si Banka e Bashkimit Europian për huadhëniet afatgjata. Aksionerët e Bankës janë shtetet anëtare. Bordi Drejtues (Këshilli i Guvernatorëve) i Bankës Europiane të Investimeve përbëhet nga ministrat e Financave të këtyre shteteve. Misioni i Bankës është zhvillimi i ekuilibruar dhe kohezioni ekonomik e social i shteteve anëtare të BE-së. Banka rrit volumin e fondeve themelore në tregun e kapitaleve, të cilat i jep në kushte të favorshme për projekte që zhvillojnë më tej objektivat e politikave të BE-së. Banka Europiane e Investimeve gëzon personalitet juridik dhe ka autonomi financiare në BE.

Politikat e Bankës Europiane të Investimeve mbështeten në bashkëpunimin dhe koordinimin e ngushtë mes shteteve anëtare dhe institucioneve të tjera të BE-së. Ajo bashkëpunon gjithashtu ngushtë me sektorët e biznesit dhe të bankave si edhe organizatat kryesore ndërkombëtare në këtë fushë. Selia e Bankës është në Luksenburg.

Sipas nenit 112 të MSA-së, Shqipëria mund të marrë ndihmë financiare nga Komuniteti në formë granti dhe huaje, duke përfshirë këtu edhe hua nga Banka Europiane e Investimeve. Ndihma Komunitare varet nga përmbushja e parimeve dhe kushteve të parashikuara në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, duke marrë parasysh rezultatet e raporteve vjetore të vendeve në Procesin e Stabilizim-Asociimit, Partneriteteve Europiane, dhe të konkluzioneve të tjera të Këshillit. (shih edhe nenin 117 të MSA-së)

■ **NENI 113**

<sup>137</sup>**Asistenca financiare / Financial assistance** – Një nga mekanizmat që jep ndihmë financiare në kuadër të Komunitetit, është Banka Europiane e Investimeve. Kjo ndihmë jepet në formën e granteve dhe huave. Ndhima lidhet ngushtë me respektimin e parimeve dhe përmbushjen e kriterëve që duhet të plotësohen respektivisht për shkak të Anëtarësimit ose Asociimit.(neni 113 i MSA-së)

■ **NENI 114**

